
Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

ASPEKTET JURIDIKE TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

prof. dr. Ylber Sela

mr. Llazo Matovski



Shkup, 2022

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

81`272:34(497.7)
342.725:34(497.7)
342.725:341.24

SELA, Ylber
Aspektet juridike të përdorimit të gjuhëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut / Ylber Sela, Llazo Matovski. - Shkup : Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV-së, 2022. - 241 стр. : илустр. ; 25

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 220-239

ISBN 978-608-4915-10-2

1. Matovski, Llazo [автор]
а) Употреба на јазици -- Правен систем -- Македонија б) Употреба на јазици -- Меѓународно-правна регулатива

COBISS.MK-ID 56744197

Botues:
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Autorë:
prof. dr. Ylber Sela
mr. Llazo Matovski

Redaktor:
Ahmet Selmani

Bashkëpunëtore:
Daniela Jaqimovska

Përktheu:
Ekipi i AZGJ-së

Recensentë:
prof. dr. Jeton Shasivari
prof. dr. Afet Mamuti

Lektorë:
Nebi Bilalli

Rregullimi teknik:
mr. Llazo Matovski

Shtypi:
GRAFO PROM SHKPNJP – Manastir

Tirazhi: 500 copë

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....14
2. Kronologjia 17
3. Aspektet procedurale-juridike të përdorimit të gjuhëve sipas Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale.....19

3.1. Përdorimi i gjuhëve në procedurat penale dhe kundërvajtëse 21
3.2. Përdorimi i gjuhëve në procedurën kontestimore 22
3.3. Përdorimi i gjuhëve në procedurën e përgjithshme administrative 24
3.4. Përdorimi i gjuhëve në procedurën e ekzekutimit të sanksioneve 26

4. Rregullimi normativ i përdorimit të gjuhëve sipas ligjit aktual për përdorimin e gjuhëve 27

4.1. Gjuhët e shkruara 30
4.2. Përkthimi me shkrim dhe ai simultan 31
4.3. Emrat e institucioneve 32
4.4. Shpenzimet e përkthimit 35
4.5. Procedurat para noterit 38
4.6. Procedurat para përmbaruesit 41
4.7. Ekzekutimi i sanksioneve 45

5. Rregullimi normativ i përdorimit të gjuhëve në legjislacionin material dhe procedural në Republikën e Maqedonisë së Veriut 46

5.1. Ligji i Gjykatave.....47
5.2. Ligji i Procedurës Kontestimore 48

5.3. Ligji i Procedurës Jashtëkontestimore 50
5.4. Ligji i Kundërvajtjeve 51
5.5. Ligji i Familjes 52
5.6. Ligji i Trashëgimisë 52
5.7. Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative 53
5.8. Ligji i Noterisë 54
5.9. Ligji i Shqiptimit 56
5.10. Ligji i Ekzekutimit të Sanksioneve 56
5.11. Ligji i Procedurës Penale 56
5.12. Ligji i Kontabilitetit të Buxhetit dhe të Shfrytëzuesve Buxhetorë 60
5.13. Ligji i Dhënies së Pullave Administrative dhe Gjyqësore 61
5.14. Ligji i Realizimit të Vendimeve të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut 61
5.15. Ligji i Avokatit të Popullit 62
5.16. Kodi Zgjedhor 63
5.17. Ligji i Evidencës së Amzës 68
5.18. Ligji i Policisë Financiare 68
5.19. Ligji i Policisë 69
5.20. Ligji i Shërbimit në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut 69
5.21. Ligji i të Punësuarve në Sektorin Publik 70
5.22. Ligji i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut 70
5.23. Ligji i Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore 71
5.24. Ligji i Dokumenteve të Udhëtimit të Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut 74
5.25. Ligji i Mbrojtjes së të Dhënave Personale 75
5.26. Ligji i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut 76
5.27. Ligji i të Drejtave të Bashkësive që Janë më Pak se 20% e Popullsisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut 77
5.28. Ligji i Sigurisë në Komunikacionin Rrugor 78
5.29. Ligji i Pronësisë Industriale 81
5.30. Ligji i Sigurimit Shëndetësor 87

5.31. Ligji i Mbikëqyrjes së Sigurimit 87
5.32. Ligji i Evidencave në Sferën e Punës 88
5.33. Ligji i Inspektimit Administrativ 88
5.34. Ligji i Sigurisë dhe i Shëndetit gjatë Punës 89
5.35. Ligji i Sigurisë së Produkteve Kozmetike 90
5.36. Ligji i Sigurisë së Produkteve 90
5.37. Ligji i Sigurisë së Ushqimit 91
5.38. Ligji i Sigurisë së Ushqimit për Kafshë 93
5.39. Ligji i Cilësisë dhe i Sigurisë së Plehrave, të Biostimulantëve dhe të Përmirësuesve të Vetive të Tokës 95
5.40. Ligji i Automjeteve 96
5.41. Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale 97
5.42. Ligji i Dhënies së Shërbimeve Financiare në Distancë 98
5.43. Ligji i Kulturës 98
5.44. Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit 99
5.45. Ligji i Arsimit të Lartë 99
5.46. Ligji i Arsimit të të Moshuarve 102
5.47. Ligji i Arsimit Fillor 102
5.48. Ligji i Arsimit të Mesëm 109
5.49. Ligji i Librave të Arsimit Fillor dhe të Mesëm 111
5.50. Ligji i Prokurorisë Publike 112
5.51. Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve 113
5.52. Ligji i Mbrojtjes së Konsumatorëve 114
5.53. Ligji i Bankave 116
5.54. Ligji i Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Çështjet Penale 116
5.55. Ligji i Letërnjoftimit 118
5.56. Ligji i Regjistrimit të Bujqësisë në Republikën e Maqedonisë, 2006 119
5.57. Ligji i Regjistrimit të Popullsisë, të Amvisërive dhe të Banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021 120
5.58. Ligji i Duhanit, i Prodhimeve të Duhanit dhe i Prodhimeve të Ngjashme 121
5.59. Ligji i Referendumit dhe i Formave të Tjera

të Deklarimit të Drejtpërdrejtë të Qytetarëve 124
5.60. Ligji i Muzeve 125
5.61. Ligji i të Huajve 126
5.62. Ligji i Standardizimit 128
5.63. Ligji i Standardit të Studentëve 128
5.64. Ligji i Standardit të Nxënësve 129
5.65. Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut 130
5.66. Ligji i Shoqërive Tregtare 131
5.67. Ligji i Letrave me Vlerë 132
5.68. Ligji i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi 133
5.69. Ligji i të Drejtave të Fëmijëve 133
5.70. Ligji i Arbitrazhit Tregtar Ndërkombëtar të Republikës së Maqedonisë 135
5.71. Ligji i Vulës së Republikës së Maqedonisë dhe i Vulave të Organeve Shtetërore në Republikën e Maqedonisë 136
5.72. Ligji i Përdorimit të Gjuhës Maqedonase 136
5.73. Ligji i Përdorimit të Gjuhës së Shenjave 137
5.74. Ligji i Kimikateve 138
5.75. Ligji i Bibliotekave 140
5.76. Ligji i Ndërtimit 140
5.77. Ligji i Shpalljes së Ligjeve dhe të Dispozitave dhe të Akteve të Tjera në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" 141
5.78. Ligji i Përmendoreve Memoriale dhe i Monumenteve 142
5.79. Ligji i Fitofarmacisë 143
5.80. Ligji i Armëve 144
5.81. Ligji i Prepareteve Veterinare dhe Mjekësore 144
5.82. Ligji i Emërtimeve të Rrugëve, të Shesheve, të Urave dhe të Objekteve të Tjera Infrastrukturore 145
5.83. Ligji Kushtetues i Zbatimit të Amendamenteve XXXIII deri në XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë 145
5.84. Ligji i Kambialeve 146
5.85. Ligji i Çeqeve 146

5.86. Ligji i Lundrimit të Brendshëm 147
5.87. Ligji i Kryerjes së Veprimtarisë Bujqësore 147
5.88. Ligji i Veprimtarisë Filmike 148
5.89. Ligji i Mbrojtjes Ndërkombëtare dhe të Përkohshme 148
5.90. Ligji i Ndërmjetësimit 150
5.91. Ligji i Sistemit Njësportelor dhe i Mbajtjes së Regjistrit Tregtar dhe të Regjistrit të Personave të Tjerë Juridikë 151
5.92. Ligji i Sistemit Hekurudhor 152
5.93. Ligji i Sigurisë në Sistemin Hekurudhor 153
5.94. Ligji i Kontratave të Transportit në Komunikacionin Hekurudhor 154
5.95. Ligji i Transportit të Komunikacionit Rrugor 155
5.96. Ligji i Transportit të Materieve të Rrezikshme në Komunikacionin Rrugor dhe Hekurudhor 156
5.97. Ligji i Veprimtarisë Botuese 156
5.98. Ligji i Sigurisë së Përgjithshme të Produkteve 157
5.99. Ligji i Sigurimit të Detyrueshëm në Komunikacion 158
5.100. Ligji i Ekzemplarit të Detyrueshëm 158
5.101. Ligji i Medieve 159
5.102. Ligji i Provës 159
5.103. Ligji i Verës 160
5.104. Ligji i Kornizës Nacionale të Kualifikimeve 160
5.105. Ligji i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë 161
5.106. Ligji i Shërbimeve 161
5.107. Ligji i Mbrojtjes së të Drejtave të Pacientëve 162
5.108. Ligji i Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare për Ndjekjen e Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Ndërkombëtare Humanitare të Kryera në Territorin e ish-Jugosllavisë.....163
5.109. Ligji i Shëndetësisë Veterinare 163
5.110. Ligji i Cilësisë së Prodhimeve Bujqësore 164
5.111. Ligji i Prodhimeve të Ndërtimit 165
5.112. Ligji i Procedurës së Tatimit 166

5.113. Ligji i Prokurimeve Publike në Fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë 167
5.114. Ligji i Aviacionit 168
5.115. Ligji i Inspektimit Arsimor 168

6. Dokumente të rëndësishme ndërkombëtare në lidhje me përdorimin e gjuhëve 169

6.1. Karta e Kombeve të Bashkuara 169
6.2. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut 171
6.3. Konventa e Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore 172
6.4. Deklarata e të Drejtave të Personave që u Përkasin Pakicave Nacionale ose Etnike, Fetare dhe Gjuhësore 174
6.5. Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian 176
6.6. Deklarata e të Drejtave të Popujve Vendës 177

7. Hulumtimi anketues 179

8. Fotodokumentacion/formularë 192

9. Rekomandime 220

10. BIBLIOGRAFIA 224

1. Hyrje

Njëra nga shenjat e shoqërisë moderne demokratike është shkalla e lartë e respektit ndaj identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar të çdo qytetari në suaza të shtetit, si dhe mundësimi i një mjedisi të favorshëm për ta shprehur, ruajtur dhe zhvilluar atë identitet. Shumëllojshmëria gjuhësore, si një nga elementet që i karakterizon shoqëritë shumëgjuhëshe, kontribuon në pasurimin e bashkësisë shoqërore.

Rendi juridik, si pjesë e rendit shoqëror, është segment tejet i rëndësishëm në realizimin e angazhimeve të çdo shteti demokratik për gëzimin real të të drejtave dhe të lirive të garantuara të individit. Sektori gjyqësor i përbërë nga institucione të ndryshme është segment jetik i kuadrit institucional të çdo vendi. Krijimi i sistemit gjyqësor dhe i institucioneve efikase dhe funksionale që gravitojnë drejt realizimit të funksionit të tij në vendosjen e drejtësisë efektive, cilësore dhe të barabartë, është postulat qendror i parimit të sundimit të ligjit dhe të zhvillimit human e të qëndrueshëm të shoqërisë, si komunitet i bazuar në respektimin e vlerave bashkëkohore civilizuese.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka legjislacion të avancuar, me të cilin rregullohet përdorimi i gjuhëve në institucionet e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal. Megjithatë, në zbatimin real dhe praktik të tij ka një sërë vështirësish dhe sfidash që tregojnë nevojën për angazhim të vazhdueshëm me përpjekje dhe punë të përbashkëta për të arritur një sistem efektiv.

Ky punim përqendrohet në aspektet materiale dhe procedurale-juridike të përdorimit të gjuhëve në sistemin juridik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me referencë të veçantë në rregullimin e tyre juridik dhe përdorimin në organet gjyqësore, duke iu referuar akteve më të rëndësishme ndërkombëtare që

kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve dhe të drejtën e mosdiskriminimit gjuhësor.

Gjuha si shenjë kulturore e një komuniteti është përcaktuar në Ligjin e Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore [1] si trashëgimi kulturore jomateriale dhe paraqet gjuhën letrare, respektivisht atë standarde dhe alfabetin e saj, si dhe të folmen lokale në të njëjtën gjuhë (në dialekte).

Përdorimi i gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka qenë objekt i rregullimit me zgjidhje të posaçme ligjore deri në vitin 2008, kur u miratua Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 101/2008 dhe 100/2011). Ky ligj ka hyrë në fuqi më 21.8.2008 dhe, ditën e hyrjes së tij në fuqi, janë shfuqizuar dispozitat e ligjeve dhe të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në lidhje me përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% qytetarët në Republikën e Maqedonisë.

Ligji i Përdorimit të Gjuhëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 07/2019) është miratuar nga ana e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë më 14 mars 2018 dhe ka hyrë në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë, gjegjësisht më 14 janar 2019. Zgjidhja e re ligjore e zëvendëson ligjin e vlefshëm deri tani për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Ky ligj e rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare në sistemin juridik, proces ky që në këndvështrimin e sotëm kërkon tejkalimin e një sërë sfidash,

[1] Neni 25, paragrafi (1) i Ligjit të Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 20/2004, 115/2007, 18/2011, 148/2011, 23/2013, 137/2013, 164/2013, 38/2014, 44/2014, 199/2014, 104/2015, 154/2015, 192/2015, 39/2016, 11/2018 dhe 20/2019).

vullnetin e aktorëve përkatës socialë, si dhe burime financiare, njerëzore dhe teknike për zbatimin e plotë të dispozitave të ligjit që ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve zyrtare, me qëllim të ushtrimit të të drejtave dhe të lirive të qytetarëve në procedurat e organeve gjyqësore dhe të organeve të tjera.

2. Kronologjia

Më 16.11.2001, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë mori vendim për shpalljen e amendamentit V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, me të cilin u zëvendësua neni 7 i saj. Normëzimi kushtetues i përdorimit të gjuhëve gjendet në nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas të cilit në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuha tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu është gjuhë zyrtare me alfabetin e saj, siç është përcaktuar në nenin 7 të kushtetutës.

Dokumentet personale të qytetarëve që flasin gjuhë tjetër zyrtare nga maqedonishtja, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe në alfabetin e saj në pajtim me ligjin.

Çdo qytetar që jeton në njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë tjetër zyrtare nga maqedonishtja, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund ta përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj. Njësitë rajonale, të cilat janë përgjegjëse për ato njësi të vetëqeverisjes lokale, përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin e saj që e përdor qytetari. Në komunikim me ministritë secili qytetar mund ta përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërkaq ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdor qytetari.

Në organet shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me ligjin mund të përdoret gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj

cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe të alfabeteve, që i flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes locale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Fotografia 1. Fragment nga Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ku është publikuar Vendimi për shpalljen e amendamenteve IV-XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë



СЛУЖБЕН ВЕСНИК
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

"Службен весник на Република Македонија" излегува по потреба. Рок за рекламации 15 дена. | Вторник, 20 ноември 2001 Скопје Број 91 Год. LVII | Претплатата за 2001 година изнесува 8.000 денари. Овој број чини 120 денари.Жиро сметка 300000000188798

1575.

Врз основа на член 131 став 4 од Уставот на Република Македонија, Собранието на Република Македонија, на седницата одржана на 16 ноември 2001 година, донесе

ОДЛУКА
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА АМАНДМАНИТЕ IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII и XVIII НА УСТАВОТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Се прогласуваат амандманите IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII и XVIII на Уставот на Република Македонија,

што ги усвои Собранието на Република Македонија, на седницата одржана на 16 ноември 2001 година.

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Бр. 07-3793/1
16 ноември 2001 година
Скопје

Претседател
на Собранието на Република Македонија,
Стојан Андов, с.р.

АМАНДМАНИ
IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII и XVIII НА УСТАВОТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Овие амандмани се составен дел на Уставот на Република Македонија и влегуваат во сила со денот на нивното прогласување.

АМАНДМАН IV

1. Граѓаните на Република Македонија, Македонскиот народ, како и граѓаните кои живеат во нејзините граници кои се дел од албанскиот народ, турскиот народ, влашкиот народ, српскиот народ, ромскиот народ, бошњачкиот народ и другите, преземајќи ја одговорноста за сегашноста и иднината на нивната татковина, свесни и благодарни на своите предци за жртвите и посветеноста во нивните заложби и борба за создавање самостојна и суверена држава Македонија и одговорни пред идните генерации за зачувување и развој на сé што е вредно од богатото културно наследство и соживот во Македонија, еднакви во своите права и обврски кон заедничкото добро - Република Македонија - во согласност со традицијата на Крушевската Република и одлуките на АСНОМ и на Референдумот од 8 септември 1991 година, одлучија да ја конституираат Република Македонија како самостојна, суверена држава, со намера да се воспостави и зацврсти владеењето на правото, да се гарантираат човековите права и граѓанските слободи, да се обезбеди мир и соживот, социјална правда, економска благосостојба и напредок на личниот и заедничкиот живот, преку своите претставници во Собранието на Република Македонија, избрани на слободни и демократски избори, го донесуваат овој

2. Со точката 1 на овој амандман се заменува Преамбулата од Уставот на Република Македонија.

АМАНДМАН V

1. На целата територија во Република Македонија и во нејзините меѓународни односи службен јазик е македонскиот јазик и неговото кирилско писмо.

Друг јазик што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните, исто така, е службен јазик и неговото писмо, како што е определено со овој член.

Личните документи на граѓаните кои зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, се издаваат на македонски јазик и неговото писмо, како и на тој јазик и неговото писмо во согласност со закон.

Кој било граѓанин кој живее во единиците на локалната самоуправа во која најмалку 20% од граѓаните зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, во комуникацијата со подрачните единици на министерствата, може да употреби кој било од службените јазици и неговото писмо. Подрачните единици надлежни за тие единици на локална самоуправа одговараат на македонски јазик и неговото кирилско писмо, како и на службениот јазик и писмо што го употребува граѓанинот. Секој граѓанин во комуникација со министерствата може да употребува еден од службените јазици и неговото писмо, а министерствата одговараат на македонски јазик и неговото кирилско писмо, како и на службениот јазик и писмото што го употребува граѓанинот.

Во органите на државната власт во Република Македонија службен јазик различен од македонскиот јазик, може да се користи во согласност со закон.

Во единиците на локалната самоуправа јазикот и писмото што го користат најмалку 20% од граѓаните е службен јазик, покрај македонскиот јазик и неговото кирилско писмо. За употребата на јазиците и писмата на кои зборуваат помалку од 20% од граѓаните во единиците на локалната самоуправа, одлучуваат органите на единиците на локалната самоуправа.

2. Со овој амандман се заменува членот 7 од Уставот на Република Македонија.

АМАНДМАН VI


1. Соодветна и правична застапеност на граѓаните кои припаѓаат на сите заедници во органите на државната власт и другите јавни институции на сите нивоа.

2. Со точката 1 на овој амандман се дополнува алинејата 2 на членот 8 од Уставот на Република Македонија.

3. Aspektet procedurale-juridike të përdorimit të gjuhëve sipas Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale.

Sipas Ligjit të mëparshëm të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, në pjesën IV (nenet 5-17) dhe pjesën V (nenet 18 dhe 19) ishte kodifikuar se gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë përdoret nga aspekti procedural-juridik, ndër të tjerat, edhe në procedurat gjyqësore, në procedurat administrative dhe në procedurat e ekzekutimit të sanksioneve.

Fotografia 2. Fragment nga Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë"ku është publikuar Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale



Стр. 2 - Бр. 101 СЛУЖБЕН ВЕСНИК НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА 13 август 2008

З А К О Н
ЗА УПОТРЕБА НА ЈАЗИК ШТО ГО ЗБОРУВААТ НАЈМАЛКУ 20% ОД ГРАЃАНИТЕ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА И ВО ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА

I. ОПШТИ ОДРЕДБИ

Член 1

Со овој закон се уредува употребата на јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија и во единиците на локалната самоуправа.

Член 2

Во органите на државната власт во Република Македонија може да се користи и службениот јазик различен од македонскиот јазик во согласност со овој закон.

Јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија се употребува во Собранието на Република Македонија; комуникација на граѓаните со министерствата, судските постапки; управната постапка; извршување на санкции; народен правобранител; изборниот процес; при непосредно изјаснување на граѓаните; при издавањето на личните документи на граѓаните; при водењето на матичната евиденција; примена на полициски овластувања; во радиодифузната дејност; инфраструктурни објекти; локалната самоуправа; финансиите; економијата; образованието и науката; културата и во други области и институции согласно со овој закон.

II. УПОТРЕБА НА ЈАЗИКОТ ВО СОБРАНИЕТО

Член 3

Во работата на Собранието службен јазик е македонскиот јазик и неговото кирилско писмо.

Пратеник кој зборува јазик различен од македонскиот јазик, а кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија, може на седница на Собранието и на седница на работното тело да зборува на тој јазик.

Пратеник кој зборува јазик различен од македонскиот јазик, а кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија, кога претседава со седница на работно тело на Собранието може да зборува и на тој јазик.

Пратеник кој зборува јазик различен од македонскиот јазик, а кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија, собраниските материјали може да ги добие и на неговиот јазик и писмо.

III. КОМУНИКАЦИЈА МЕЃУ ГРАЃАНИТЕ И МИНИСТЕРСТВАТА

Член 4

Кој било граѓанин кој живее во единиците на локалната самоуправа во која најмалку 20% од граѓаните зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, во комуникацијата со подрачните единици на министерствата во таа единица на локалната самоуправа, може да го употреби тој службен јазик и неговото писмо.

Подрачните единици надлежни за тие единици на локалната самоуправа одговараат на македонски јазик и неговото кирилско писмо, како и на службениот јазик и писмо што го употребува граѓанинот.

Кој било граѓанин кој живее во единиците на локалната самоуправа во која најмалку 20% од граѓаните зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, во комуникација со министерствата може да го употребува тој службен јазик и неговото писмо.

Министерствата одговараат на македонски јазик и неговото кирилско писмо, како и на службениот јазик и писмото што го употребува граѓанинот кој живее во единиците на локалната самоуправа во која најмалку 20% од граѓаните зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик.

IV. УПОТРЕБА НА ЈАЗИКОТ ВО СУДСКИТЕ ПОСТАПКИ

1. Кривична и прекршочна постапка

Член 5

Во кривичната постапка службен јазик е македонскиот јазик и неговото кирилско писмо.

Во кривичната постапка друг службен јазик што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните и неговото писмо, се користи во согласност со овој закон.

Член 6

Обвинетиот, оштетениот, приватниот тужител, сведоците и другите лица кои учествуваат во кривичната постапка, а кои зборуваат службен јазик различен од македонскиот, имаат право при изведувањето на предистражните, истражните и другите судски дејствија и на главниот претрес, како и во постапката по жалба да го употребуваат својот јазик и писмо. Судот ќе обезбеди усно преведување на тоа што лицето, односно другите го изнесуваат, како и на исправите и другиот пишан доказен материјал. Судот ќе обезбеди писмено да се преведе пишаниот материјал кој е од значење за постапката или за одбраната на обвинетиот.

Другите странки, сведоци и учесници во постапката пред судот имаат право на бесплатна помош на преведувач, ако не го разбираат или зборуваат јазикот на кој се води постапката.

За правото на преведувач лицето ќе се поучи. Во записникот ќе се забележи дека е дадена поука и изјавата на лицето.

Преведувањето го врши судски преведувач.

Член 7

Тужбите, жалбите и другите поднесоци се упатуваат до судот на јазикот на кој се води постапката.

Граѓаните кои зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, можат поднесоците да ги упатуваат на својот јазик и писмо, кои поднесоци судот ги преведува и ги доставува до другите странки во постапката.

На обвинетиот кој не го разбира јазикот на кој се води постапката му се доставува превод од обвинението на јазик на којшто се служел во постапката.

Член 8

Поканите, одлуките и другите писмена судот ги упатува на јазикот на кој се води постапката.

На граѓаните кои зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, поканите, одлуките и другите писмена ќе им се достават и на тој јазик.

На обвинетиот кој е во притвор, на издржување казна или на задолжително психијатриско лекување и чување во здравствена установа, превод од поднесоците од ставот 1 на овој член ќе му достават на јазикот на којшто се служел во постапката.

На обвинетиот кој не го разбира јазикот на кој се води постапката, превод од пресудата се доставува на јазик на кој се служел во постапката.

Член 9

Одредбите на овој закон кои се однесуваат на употребата на јазиците во кривичната постапка се применуваат и во прекршочната постапка.

евиденција и основниот каталог на библиотечниот фонд ги водат на македонски јазик и неговото кирилско писмо и на јазикот и писмото што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија на подрачјето на таа единица на локалната самоуправа.

16. Слободен пристап до информации

Член 57

Барателот, согласно со Законот за слободен пристап до информации од јавен карактер, го доставува барањето до имателот на информацијата на македонски јазик и неговото кирилско писмо, а барателот кој зборува службен јазик различен од македонскиот јазик и писмо, барањето може да го достави и на службениот јазик и писмо што го употребува во согласност со закон.

17. Објавување на акти

Член 58

Законите се објавуваат и на друг службен јазик и писмо што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните кои припаѓаат на заедниците во Република Македонија.

VI. ПРЕОДНА И ЗАВРШНА ОДРЕДБА

Член 59

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престануваат да важат одредбите од законите и Деловникот на Собранието на Република Македонија што се однесуваат на употребата на јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија.

Член 60

Овој закон влегува во сила осмиот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

L I G J
PËR PËRDORIMIN E GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20% E QYTETARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE NË NJËSITË E VETADMINISTRIMIT LOKAL

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet përdorimi i gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal.

Neni 2

Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë mund të përdoret edhe gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase në pajtim me këtë ligj.

Gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë përdoret në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë; komunikimin e qytetarëve me ministritë; procedurat gjyqësore; procedurën administrative; zbatimin e sanksioneve; Avokatin e Popullit; procesin zgjedhor; gjatë deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve; gjatë lëshimit të dokumenteve personale të qytetarëve; gjatë mbajtjes të evidencës së amzës; zbatimit të autorizimeve policore; në veprimtarinë radiodifuzive; objektet e infrastrukturës; vetadministrimin lokal; financat; ekonomi; arsim dhe shkencë; në kulturë; dhe në sfera dhe institucione të tjera në pajtim me këtë ligj.

II. PËRDORIMI I GJUHËS NË KUVEND

Neni 3

Në punën e Kuvendit gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Deputeti i cili flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e Kuvendit dhe në mbledhjen e trupit punues mund të flasë në këtë gjuhë.

Deputeti i cili flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, kur kryeson me mbledhjen e trupit punues të Kuvendit, mund të flasë edhe në këtë gjuhë.

Deputeti i cili flet gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase, e të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, materialet e Kuvendit mund t'i marrë edhe në gjuhën dhe në alfabetin e tij.

III. KOMUNIKIMI NDËRMJET QYTETARËVE DHE MINISTRIVE

Neni 4

Çdo qytetar që jeton në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikimin me njësitë rajonale të ministrive në këtë njësi të vetadministrimit lokal, mund ta përdorë këtë gjuhë zyrtare dhe alfabetin e saj.

Njësitë rajonale kompetente për këto njësi të vetadministrimit lokal përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin zyrtar që e përdor qytetari.

Çdo qytetar që jeton në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, në komunikimin me ministritë mund ta përdorë këtë gjuhë zyrtare dhe alfabetin e saj.

Ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdor qytetari që jeton në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

IV. PËRDORIMI I GJUHËS NË PROCEDURAT GJYQËSORE

1. Procedura penale dhe për kundërvajtje

Neni 5

Në procedurën penale gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Në procedurën penale gjuhë tjetër zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj, përdoret në pajtim me këtë ligj.

Neni 6

I akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, dëshmitarët dhe personat e tjerë që marrin pjesë në procedurën penale, e që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, gjatë ndërmarrjes së veprimeve parahetimore, hetimore dhe ndërmarrjes së veprimeve tjera gjyqësore dhe në seancën gjyqësore kryesore, si dhe në procedurën ndaj ankesës ka të drejtë ta përdorë gjuhën dhe alfabetin e saj. Gjykata do të sigurojë përkthim gojor të asaj që personi, respektivisht të tjerët e paraqesin, si dhe të dokumenteve dhe materialit tjetër të shkruar dëshmues. Gjykata do të sigurojë që me shkrim të përkthehet materiali i shkruar që është me rëndësi për procedurën ose për mbrojtjen e të akuzuarit.

3.1. Përdorimi i gjuhëve në procedurën penale dhe atë kundërvajtëse

Në nenin 5 të ligjit është përcaktuar se në procedurën penale, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër zyrtare të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, përdoret në përputhje me këtë ligj.

Neni 6 i ligjit parashihte se i pandehuri, i dëmtuari, paditësi privat, dëshmitarët dhe personat e tjerë pjesëmarrës në procedurë penale, të cilët flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, kanë të drejtë për realizimin e veprimeve gjyqësore parahetimore dhe hetimore edhe në bastisjen kryesore, si në procedurën e ankimimit ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre. Gjykata do të sigurojë përkthim me gojë të asaj që personi, përkatësisht të tjerët e theksojnë, si dhe të dokumenteve dhe provave të tjera me shkrim. Gjykata do të sigurojë që materiali që ka lidhje me procedurën ose me mbrojtjen e të pandehurit të përkthehet me shkrim. Palët e tjera, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit në procedurën para gjykatës kishin të drejtën e ndihmës falas të ndonjë përkthyesi nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Personi do të udhëzohet për të drejtën e përkthyesit. Në procesverbal shënohet se është dhënë këshilla dhe deklarata e personit. Përkthimin e kryen përkthyesi gjyqësor.

Neni 7 i ligjit në mënyrë normative e rregullonte pjesën me parashtresat gjyqësore në kontekstin se paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera i drejtohen gjykatës në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonuishtja, parashtresat mund t'i dorëzojnë në gjuhën dhe në alfabetin e tyre, të cilat gjykata i përkthen dhe ua dorëzon palëve të tjera në procedurë. I pandehuri që nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedimi, ka pasur të drejtë që akuza të përkthehet në gjuhën që e ka përdorur gjatë procedurës.

Në pajtim me nenin 8 të ligjit, fletëthirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjykata i dërgonte në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare ndryshe nga maqedonishtja, fletëthirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera u dorëzoheshin edhe në atë gjuhë. Të pandehurit, i cili është në paraburgim, në vuajtje të dënimit ose në trajtim të detyrueshëm psikiatrik dhe në mbajtje në institucionin shëndetësor, përkthimi i parashtresave sipas paragrafit 1 të këtij neni, i jepet në gjuhën që e ka përdorur në procedurë. I pandehuri që nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, përkthimi nga aktgjykimit i dorëzohej në gjuhën që e ka përdorur në procedurë.

Neni 9 i Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë edhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale parashihte se dispozitat e ligjit që kishin të bënin me përdorimin e gjuhëve në procedurë penale, ishin të zbatueshme edhe në procedurën kundërvajtëse.

3.2. Përdorimi i gjuhëve në procedurë kontestimore

Në pajtim me nenin 10 të ligjit, palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë që flasin gjuhë tjetër zyrtare, e cila, gjithashtu është gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë, në procedurë kishin të drejtë që, gjatë pjesëmarrjes në seanca dhe gjatë veprimeve të tjera procedurale me gojë para gjykatës, ta përdorin gjuhën e tyre. Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë sipas paragrafit 1 të këtij neni në procedurë kishin të drejtë që në seancë t'u sigurohet përkthim me gojë në gjuhën e tyre, si dhe përkthim me gojë dhe me shkrim nga përkthyes gjyqësorë të dokumenteve të përdorura në seancë për dëshmim.

Fletëthirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore dorëzoheshin te palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, në pajtim me

nenin 11 të ligjit. Palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë qytetarë të Republikës së Maqedonisë, gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja, fletëthirrjet, vendimet dhe shkresat e tjera gjyqësore u dorëzoheshin në atë gjuhë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën kontestimore, paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera ia dorëzonin gjykatës në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik. Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë, shtetas të Republikës së Maqedonisë, gjuha e të cilëve është gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik, paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera në gjykatë mund t'i dorëzonin në gjuhën dhe në alfabetin e tyre. Këto parashtresa gjykata i përkthen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe ua dorëzon palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë. Kjo ishte rregulluar në nenin 12 të ligjit.

Sa u përket shpenzimeve të përkthimit, neni 13 parashihte se shpenzimet e përkthimit për palët dhe pjesëmarrësit në procedurë, shtetas të Republikës së Maqedonisë, që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji për të drejtën e përdorimit të gjuhës dhe të alfabetit të tyre, i takojnë gjykatës.

Dispozitat e ligjit që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve në procedurë kontestimore, zbatohen edhe në procedurë jashtëkontestimore dhe në procedurë për kontestet administrative, në pajtim me nenin 14 të ligjit.

Neni 15 i ligjit parashihte që gjatë zgjedhjes së gjykatësit dhe gjykatësit-porotë në gjykatën që gjendet në zonën e njësisë së vetëqeverisjes locale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, gjykatësi dhe gjykatësi-porotë i asaj bashkësie, deklaratën solemne e jepnin në gjuhën maqedonase, ndërkaq e nënshkruanin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin e asaj bashkësie.

Në gjykatat, selia e të cilave është në zonën e njësive të vetëqeverisjes lokale, ku përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj është që që e flasin së paku 20% e qytetarëve, vula e gjykatës, emri dhe selia e gjykatës duhet të jenë të shkruara, respektivisht të theksuara edhe në atë gjuhë dhe në alfabetin e saj.

Në pajtim me nenin 16 të ligjit, Prokuroria Publike në kryerjen e funksionit të saj zbaton në mënyrë adekuate dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, ndërkaq sipas nenit 17, anëtarët e zgjedhur të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë, pjesëtarët e bashkësive që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, së paku 20% e qytetarëve, deklaratën solemne sipas nenit 28 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë e jepnin në gjuhën maqedonase, ndërkaq e nënshkruanin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe në alfabetin e asaj bashkësie.

3.3. Përdorimi i gjuhëve në procedurën e përgjithshme administrative

Me nenin 18 të ligjit, qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme maqedonishtja, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në procedurën administrative që zhvillohet në organet e administratës shtetërore, organet e tjera shtetërore, organet komunale, të Qytetit të Shkupit dhe në komunat e qytetit të Shkupit, personat juridikë dhe personat e tjerë, të cilëve me ligj u është besuar ushtrimi i autorizimeve publike, kishin të drejtë ta përdorin atë gjuhë. Të drejtën sipas paragrafit 1 të këtij neni mund ta shfrytëzonte çdo qytetar që jeton në njësinë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja dhe në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, qytetari

kishte të drejtë të përdorte çdo gjuhë zyrtare dhe alfabetin e saj. Njësitë rajonale që janë përgjegjëse për ato njësi të vetëqeverisjes lokale përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin e saj të përdorur nga qytetari. Çdo qytetar në komunikim me ministritë mund të përdorte njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërkaq ministritë përgjigjeshin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin e saj që e përdor qytetari.

Palët në procedurë që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, e cila është edhe gjuhë zyrtare, parashtresat mund t'i parashtrojnë në atë gjuhë dhe në atë alfabet. Parashtresat e tilla organet para të cilave kryhej procedura i përkthenin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe vepronin sipas tyre. Organet para të cilave zhvillohet procedura administrative kur vendosin në çështjet administrative, korrespondonin në gjuhën zyrtare maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin e përdorur nga pala. Nëse në procedurën administrative dëshmitari nuk e njeh gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, kontrollohej nga përkthyesi dhe nëse ndonjë seancë në procedurën administrative kryhet nëpërmjet përkthyesit, në procesverbal do të shënohej se në cilën gjuhë është marrë në pyetje dhe kush ka qenë përkthyesi.


3.4. Përdorimi i gjuhëve në procedurën e ekzekutimit të sanksioneve

Neni 19 i ligjit parashihte se e drejta e përdorimit të gjuhës së personave të dënuar, në komunikim me Drejtorinë e Ekzekutimit të Sanksioneve, institucionin për ekzekutimin e sanksioneve apo organet e tjera shtetërore, shfrytëzohet në përputhje me dispozitat e ligjit që kishin të bënin me përdorimin e gjuhës në procedurën e përgjithshme administrative.

4. Rregullimi normativ i përdorimit të gjuhëve në sistemin juridik sipas ligjit në fuqi të përdorimit të gjuhëve

Kjo pjesë nuk e trajton plotësisht pjesën normative të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, por pjesërisht trajton rregullimin ligjor të përdorimit të gjuhëve në institucionet gjyqësore, si dhe në pjesën e shërbimeve publike të pavarura, gjegjësisht personave që ushtrojnë autorizime publike siç janë noterët dhe përmbaruesit.

Fotografia 3. Fragment nga Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë ku është publikuar Ligji i Përdorimit të Gjuhëve



Стр. 10 - Бр. 7 Службен весник на Република Македонија 14 јануари 2019

108.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

за прогласување на Законот за употреба на јазиците

Се прогласува Законот за употреба на јазиците,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 14 март 2018 година.

Број 08 - 263/1
14 март 2018 година
С к о п ј е

ПРЕТСЕДАТЕЛ
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
д-р Ѓорге Иванов[1]

ПРЕТСЕДАТЕЛ
НА СОБРАНИЕТО НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
м-р Талат Џафери

Дека преписот е верен на оригиналот тврди:

ЗАМЕНИК НА ГЕНЕРАЛНИОТ СЕКРЕТАР
НА СОБРАНИЕТО НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
Нешбедин Ибраими

[1] Указот за прогласување на Законот за употреба на јазиците се објавува без потпис на Претседателот на Република Македонија, д-р Ѓорге Иванов од следниве причини:

- Секој е должен да ги почитува Уставот и Законите (Член 51, став 2 од Уставот на Република Македонија)
- Претседателот на Републиката е должен да го потпише указот за прогласување на законите ако истите повторно се усвоени со мнозинство гласови од вкупниот број пратеници (член 75, став 3 од Уставот на Република Македонија). Законот за употреба на јазиците е повторно усвоен со мнозинство гласови од вкупниот број пратеници на 32-та седница на Собранието на Република Македонија на ден 14.03.2018 година.
- Поради неизвршување на горенаведените обврски од страна на Претседателот на Републиката, д-р Ѓорге Иванов, а поради обврската од член 52 од Уставот на Република Македонија, Претседателот на Собранието е должен да го достави Законот за употреба на јазиците, до Службен весник на Република Македонија за негово објавување.

од граѓаните на Република Македонија и неговото писмо со помошни тела за поддршка на институциите од член 1 став (3) и член 2 став (3) од овој закон, како и сите други институции.

(2) Директорот на Агенцијата го избира Владата на Република Македонија по претходно објавен јавен повик со мандат од 4 години со право на реизбор.

(3) Во Агенцијата покрај овластени судски преведувачи се вработуваат и лингвисти и дипломирани филолози по албански јазик, како и лиценцирани лектори.

(4) Директорот ја претставува Агенцијата, раководи со нејзината работа, ги врши работите определени со овој закон и донесува годишна програма за работа на Агенцијата. Директорот поднесува извештај за работата на Агенцијата до Владата на Република Македонија најмалку еднаш годишно до 31 март во тековната година за претходната година.

(5) Средствата за работа и функционирање на Агенцијата се обезбедуваат од Буџетот на Република Македонија.

Член 19

Агенцијата е надлежна за:

- поддршка на институциите во остварувањето на обврските од овој закон вклучувајќи превод и лекторирање на документи;
- лекторирање на сите акти што се објавуваат во Службен весник на Република Македонија;
- промовира и презема мерки за унапредување на употребата на јазикот кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на Република Македонија;
- изготвување на извештаи за информирање на Владата на Република Македонија за спроведување на нејзините надлежности;
- за потребите на Владата на Република Македонија да подготвува стручно-аналитички материјали од своја надлежност;
- дава стручни мислења по материјалите кои се во функција на спроведување и унапредување на употребата на јазикот кој го зборуваат најмалку 20% од граѓаните на Република Македонија;
- други работи поврзани со спроведувањето на целите утврдени во овој закон.

Член 20

(1) За надзорот над целосно и доследно спроведување на одредбите на овој закон кои се однесуваат на употребата на јазиците, се формира Инспекторат за употреба на јазиците (во натамошниот текст: Инспекторатот), во состав на Министерството за правда со својство на правно лице.

(2) Начелата, надлежноста, организацијата на инспекција и постапките на инспекцискиот надзор на Инспекторатот за употреба на јазиците се уредуваат со посебен закон.

Член 21

Владата на Република Македонија и сите институции надлежни за спроведување на одредбите од овој закон, ќе донесат мерки за промовирање на применета на сите службени јазици, како и за гарантирање на заштитата на јазиците на другите заедници чиј мајчин јазик не е службен јазик.

Член 22

(1) Глоба во износ од 4.000 до 5.000 евра во денарска противвредност за прекршок ќе се изрече на органите наведени во член 1 став (3), член 2 (став 3), како и сите други институции за непочитување на одредбите од овој закон.

(2) Глоба во износ од 30% од одмерената глоба ќе му се изрече на службеното лице и одговорното лице во органите од став 1 на овој член.

Член 23

(1) Во рок од една година од денот на влегувањето на сила на овој закон сите надлежни институции се обврзани да ги донесат подзаконските акти за спроведување на овој закон.

(2) Во рок од шест месеци од денот на влегување во сила на овој закон, институциите се обврзани да ги спроведуваат обврските наведени во член 7 од овој закон.

(3) Владата на Република Македонија еднаш по влегувањето во сила на овој закон ќе развие програма за покренување на јавната свест за примената на овој закон.

(4) Во рок од една година одредбите од другите закони се усогласуваат со одредбите на овој закон.

(5) Во случај на неусогласеност на одредбите на овој закон со јазичните одредби на друг закон, органите се должни да ги применуваат одредбите од овој закон.

Член 24

Со донесувањето на овој закон престанува да важи Законот за употреба на јазикот што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија и во единиците на локалната самоуправа („Службен весник на Република Македонија“ бр. 101/08 и 100/11).

Член 25

Овој закон влегува во сила со денот на објавување во „Службен весник на Република Македонија“.

L I GJ
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Neni 1

(1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, në pajtim me këtë ligj.

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet tjera, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të përcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Në nenin 9, paragrafët (1-8), të ligjit është rregulluar përdorimi i gjuhëve në procedurat gjyqësore, administrative, ekzekutive, procedurën e ekzekutimit të sanksioneve, procedurën parahetimore dhe hetimore, procedurën penale dhe kundërvajtëse, procedura kontestimore dhe jashtëkontestimore, si dhe procedurat e tjera para gjykatave, prokurorive publike, si dhe të gjitha organeve, trupave dhe institucioneve.

Në procedurat e theksuara, zbatohet gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj. Të gjitha procedurat zhvillohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj nëse gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person i cili e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Normëzimi i tillë ligjor i referohet dygjuhësisë së detyrueshme të procedurës nëse plotësohet kushti që njëri nga pjesëmarrësit në procedurë (gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë, i cili si term është i përgjithësuar dhe mund të përfshijë kategori të ndryshme të pjesëmarrësve - i autorizuari, përfaqësuesi ligjor, i akuzuari, i dëmtuari, paditësi, i pandehuri, kujdestari, ndërmjetësi, eksperti ligjor, këshilltari teknik etj.) ta flasë gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuhën shqip) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

4.1. Gjuhët e shkruara

Në nenin 9, paragrafi (3) të ligjit është përcaktuar se të gjitha vendimet, shkresat dhe aktet e tjera që rrjedhin nga procedura para institucioneve sipas paragrafit (1) të të njëjtit nen, do të miratohen dhe do të jepen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, nëse gjykatësi, prokurori publik, pala apo pjesëmarrësi tjetër në procedurë është personi që e flet gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Fotografia 4. Formular idygjuhësh me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë



Република Северна Македонија
Republika e Maqedonisë së Veriut
МИНИСТЕРСТВО ЗА ПРАВДА
MINISTRIA E DREJTËSISË
СКОПЈЕ
SHKUP

Постои опција за плаќање со ПОС терминал.

Примено/E pranuar:			
Орган. ед./Njësia organizative	Број/Numër	Прилог/ Shtojcë	Вредност/Vlera
08 -	2/		

Издавање на документот во/ Dhënia e dokumentit në ora _____часот

Тел. за контакт /Tel. për kontakt_____

Апостил-Обична
Apostill – E thjeshtë

БАРАЊЕ/KËRKESË

1. Од/Nga _____
(име, презиме или фирма од документите/emri dhe mbiemri ose firma nga dokumentet)

место на живеење (село-град)/Vendi i banimit (fshati – qyteti)_____
_____
(впишете го само населеното место во кое живеете без адреса)/shënoni vetëm vendin e banimit ku jetoni, pa adresë)

Број 2 го пополнувате ако сте овластеник од сопственикот на документот
Numrin 2 e plotësoni vetëm nëse jeni të autorizuar nga pronari i dokumentit)

2. Барањето го поднесува/Kërkesën e parashtron
_____
(лице кое го поднесува барањето/personi i cili e parashtron kërkesën)

Од/Nga _____ тел. бр./nr. Tel._____

Барам да ми се изврши над заверка на долу приложените документи кои ми се потребни за употреба во странство (држава)/kërkoj legalizimin e dokumenteve të bashkëngjitura, të cilat më nevojiten për përdorim jashtë vendit (shtetit)
_____
(впишете ја државата за каде ви е потребна заверката/shënoni shtetin për ku ju duhet legalizimi)

Прилог/Bashkëlidhur:_____

Скопје/Shkup, ___.___._____

БАРАТЕЛ/KËRKUES,
_____

Dokumentet i ka pranuar më ___.___._____

4.2. Përkthimi me shkrim dhe simultan

Në nenin 9, paragrafi (4) të ligjit thuhet se institucionet janë të obliguara të ofrojnë përkthim të të gjitha dokumenteve dhe të materialeve të nevojshme, si dhe përkthim simultan të prononcimeve, deklaratave dhe seancave dëgjimore në punën apo në procedurat që zhvillohen. Paragrafi 5 i të njëjtit nen thotë se mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve dhe materialet e nevojshme, gjegjësisht mossigurimi i përkthimit simultan gjatë tërë rrjedhës së procedurës, përbën shkelje esenciale të procedurës.





4.3. Emrat e institucioneve

Mënyra e shënimit të emrave të institucioneve në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja është e rregulluar në nenin 9, paragrafi (6) të ligjit sipas të cilit shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilike, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.



Fotografia 5. Tabela e vjetër e Gjykatës së Apelit - Shkup



Fotografia 6. Tabela e re e Gjykatës së Apelit - Shkup

Në paragrafin (7) të të njëjtit nen parashihet se në institucionet me seli në zonën e cila përfshin disa gjykata themelore, prej të cilave së paku njëra prej tyre gjendet në njësinë e vetëqeverisjes lokale ku flitet gjuha zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja, e që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, emrat do të shkruhen edhe në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Për shembull, në pajtim me nenin 29, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit të Gjykatave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/ 2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/2019), Gjykata e Apelit në Manastir mbulon hapësirat e gjykatave themelore të Manastirit, të Krushevës, të Ohrit, të Prilepit, të Resnjës dhe të Strugës. Komuna e Krushevës (21.6 %) dhe e Strugës (41.7 %), sipas rezultateve të fundit nga regjistrimi i popullsisë në vitin 2002, janë komuna ku mbi 20% e qytetarëve e flasin gjuhën shqipe dhe, sipas kësaj, edhe emri i gjykatës duhet të shkruhet në atë gjuhë dhe në atë alfabet sipas nenit 9, paragrafi (7) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Fotografia 7. Tabela ekzistues e Gjykatës së Apelit - Manastir





Fotografia 8. Tabela ekzistuese e Gjykatës së Apelit - Gostivar dhe e Prokurorisë së Lartë Publike - Gostivar

Fotografia 9. Tabela ekzistuese e Gjykatës Themelore - Gostivar dhe e Prokurorisë Themelore Publike - Gostivar



4.4. Shpenzimet e përkthimit

Shpenzimet që rrjedhin nga përkthimi për palët dhe për pjesëmarrësit në procedurë, si dhe shpenzimet për përkthyes gjyqësor që rrjedhin nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, janë të rregulluara në paragrafin (8) të nenit 9, në të cilin parashihet se ato bien mbi kurriz të institucioneve të theksuara në paragrafin (1) të nenit 9 të ligjit.

Fotografia 10. Lista e shpenzimeve për shërbimin e kryer - përkthim gjyqësor

Образец МАТА/СП/001
Да се пополни и/или заокружи, како што е соодветно.

Сите наведени податоци подлежат на *Законот за заштита на личните податоци* (Сл. в. 7/05 ... 64/18).

ТРОШКОВНИК за извршена услуга **СУДСКИ ПРЕВОД**

Број _____ од ____ . ____ . 20____ г. во _____ .

ПРЕДМЕТ број: _____ суд: _____
име и презиме на надлежен судија или обвинител: _____

ДОКУМЕНТ наслов: _____ број: _____
издал: _____ датум: ____ . ____ . 20____ г.

КЛИЕНТ име и презиме или назив: _____
адреса: ул. _____ бр. _____
место: _____ ЕМБГ: _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ или ЕМБС: _ _ _ _ _ _ _

ПРЕВЕДУВАЧ име и презиме: _____ ЕМБГ: _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _
поставен во: Основен суд _____

УСЛУГА а) превод б) лекторирање
тип: 1) генерички документ 2) стручен текст 3) текст во ракопис
комбинација: од _____ јазик на _____ јазик
застапеност: 4) чест странски јазик 5) редок странски јазик
в) заверка со потпис и печат на судски преведувач, во _____ примерока
г) заверка со потпис и печат на нотар, во _____ примерока
д) во редовен рок, до: ____ . ____ . 20____ г. ѓ) итно, до: ____ . ____ . 20____ г.

Fotografia 11. Lista e shpenzimeve për shërbimin e kryer - interpretim gjyqësor

Образец МАТА/СП/002
Да се пополни и/или заокружи, како што е соодветно.

Сите наведени податоци подлежат на *Законот за заштита на личните податоци* (Сл. в. 7/05 ... 64/18).

ТРОШКОВНИК за извршена услуга СУДСКО ТОЛКУВАЊЕ

Број _____ од ____ . ____ . 20____ г. во _____ .

ПРЕДМЕТ број: _____ суд: _____
име и презиме на надлежен судија или обвинител: _____

КЛИЕНТ име и презиме или назив: _____
адреса: ул. _____ бр. _____
место: _____ ЕМБГ: _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ или ЕМБС: _ _ _ _ _ _ _

ТОЛКУВАЧ име и презиме: _____ ЕМБГ: _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _ _
поставен во: Основен суд _____

УСЛУГА
а) симултано во судница б) консекутивно во судница в) консекутивно на терен
комбинација: од _____ јазик на _____ јазик
застапеност: 1) чест странски јазик 2) редок странски јазик
г) со уредна најава, _____ дена пред рочиштето
д) на итен повик, _____ часа пред рочиштето
ѓ) подготовка е) откажан ангажман во рок од 48 часа
ж) викенд и празници з) дежурство
ѕ) надвор од местото на живеење

4.5. Procedurat para noterit

Në pajtim me nenin 10, paragrafi (1) të ligjit, në procedurat para noterit, dokumentet dhe vërtetimet noteriale mund të lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

Fotografia 12. Vula katrore për konfirmimin e marrjes së shkresave



30 декември 2016 Службен весник на Република Македонија Бр. 226 - Стр. 19

Образец бр.21

ШТЕМБИЛ ЗА ПОТВРДУВАЊЕ НА ПРИЕМ НА СПИСИ

П Р И М Е Н О

Датум на прием на писмено

Н О Т А Р

(име и презиме на нотар - град)

Формат (50x27 мм)

Fotografia 13. Vula katrore për vërtetimin e librave afaristë të noterëve

ПРИЛОГ

Образец бр.1

ШТЕМБИЛ ЗА ЗАВЕРКА НА НОТАРСКИ ДЕЛОВНИ КНИГИ

Нотарска комора на Република Северна Македонија

Прими од _____
(име и презиме и седиште – адреса)
на ден _____ 20__ година овој/оваа _____
(назив на уписникот или книгата)
и по прегледот издаде:

ПОТВРДА

Се потврдува дека овој/оваа _____
(назив на уписникот или книгата)
Има _____ страници,
(број со зборови)
на ден _____ 20____ година ја потпиша и ја заверi и на
ден _____ 20 ____ година ја предаде на
нотарот _____ од _____
(име и презиме) (место)

Број: _____
Во _____, _____ 20__ година
(место)

Претседател,

_____

(формат 110x100 мм)

Fotografia 14. Vula katrore e lëshimit të aktvendimit për urdhërpagesë noteriale

Образец бр.20

ШТЕМБИЛ ЗА ИЗДАВАЊЕ НА РЕШЕНИЕ ЗА НОТАРСКИ ПЛАТЕН НАЛОГ

Република Македонија
НОТАР
_____
Ул.,, _____ " број _____

НПН.бр._____/_____

Нотарот _____ именуван за подрачјето на Основен суд
(име и презиме)
_____, на ден _____ година го донесе следното

РЕШЕНИЕ
за издавање на нотарски платен налог

I. Се усвојува предложениот нотарски платен налог врз основа на веродостојна исправа.

II. Се задолжува должникот во рок од 8 дена од приемот на решението да ги намири пристигнатите побарувања на доверителот како и одмерените трошоци на постапката во вкупен износ од денари, од кои: трошоците пред нотарот во износ од денари и нотарската награда во износ од денари, трошоците на адвокатот во износ од _____ денари и наградата на адвокатот во износ од _____ денари и судските такси во износ од _____ денари.

III. Против ова решение и против одлуката за трошоците должникот има право да поднесе приговор, во рок од 8 (осум) дена од приемот на решението, преку овој нотар до Основниот суд _____.

IV. Доколку должникот не поднесе приговор или не го плати долгот во определениот рок, ќе следи присилно извршување.

НОТАР

_____
(потпис и печат)

Напомена: Доколку должникот вложи приговор должен е заедно со приговорот да достави доказ во оригинал (уплатница) за платена судска такса за приговор во износ од _____ денари, на сметка 100000000063095, примач Буџет на РМ, банка на примач НБРМ, уплатна сметка 840-(општина)-03359, приходна шифра 722213 (за физички лица) или уплатна сметка 840-(општина)-03338, приходна шифра 722211 (за правни лица), во спротивно нотарот ќе преземе дејствија за присилна наплата преку УЈП, согласно законските прописи.

Формат (160x240 мм)

4.6. Procedurat para përmbaruesit

Në pajtim me nenin 10, paragrafi (2) të ligjit, në procedurat para përmbaruesit, nëse pjesëmarrës është personi i cili e flet gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, urdhëresat, konkluzionet, procesverbalet, shënimet zyrtare dhe aktet e tjera të përmbaruesve lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në alfabetin e saj.

Fotografia 15. Konkluzioni për ndalimin e ekzekutimit



3 мај 2019 СЛУЖБЕН ВЕСНИК на Република Северна Македонија Бр. 88 - Стр. 7

ИЗВРШИТЕЛ
_____
именуван за подрачјето
на Основниот суд
_____

Образец бр.4

И.бр._____

Извршителот _____ од _____ врз основа на барањето за спроведување на извршување од доверителот _____ од _____ со ЕМБГ/ЕМБС/ЕДБ _____ и живеалиште/ престојувалиште/седиште на _____, засновано на извршната исправа _____ од _____ на _____, против должникот_____ од _____ со ЕМБГ/ЕМБС/ЕДБ _____ и живеалиште/престојувалиште/ седиште на _____, за спроведување на извршување во вредност _____, на ден _____ година го издава следниот:

ЗАКЛУЧОК
за запирање на извршување
(врз основа на член 29 став (1) и член 93 од Законот за извршување)

СЕ ЗАПИРА извршувањето спрема должникот _____, поради повлекување на барањето за извршување од доверителот/поради тоа што доверителот побара одлагање повеќе од двапати/ извршната исправа е правосилно укината, преиначена, поништена, ставена вон сила, потврдата за извршност е укината/ извршителот е изземен од натамошното извршување.

ИЗВРШИТЕЛ

(потпис и печат)

Д.-на:_____

Правна поука: Против овој заклучок може да се поднесе приговор до Основниот суд_____ согласно одредбите на член 86 од Законот за извршување.

Забелешка: Овој заклучок се применува и во случаи кога побарувањето е намирено во целост, кога должникот е во ликвидација.

Fotografia 16. Fletëdorëzim

Образец бр.8

(Образец за формата и содржината на доставницата со која извршителот ќе врши достава на неговите акти)

(врз основа на член 40 од Законот за извршување)

ИЗВРШИТЕЛ

_____
(име и презиме)
_____
(град)

И.бр._____

ДОСТАВНИЦА

Примач:
_____
_____
_____

Назив на актот на извршителот што се доставува:_____
_____
_____

Број на прилозите_____

Потврдувам дека горе назначениот акт го примив на ден (со букви)_____ **20**___ **година, во** _____**часот, на (адреса) ул.**_____.

_____ _____

(Потпис на примачот) **(Потпис на лицето кое извршило достава)**

Доставувањето на актите на извршителот се врши според одредбите на Законот за извршување.

Службена белешка (во случај на неуспешна достава): _____

Упатство за изработка на доставницата

Доставницата се изработува во А5 формат од квалитетна бела хартија а печатениот текст во доставницата треба да биде со црни букви

Fotografia 17. Procesverbal për sigurimin e provave materiale

ИЗВРШИТЕЛ

_____

именуван за подрачјето
на Основниот суд

_____

Образец бр.12

И.бр._____

Извршителот _____ од _____ врз основа на барањето за обезбедување на материјални докази од _____ суд за потребите на предмет бр. _____ на ден _____ година го составува следниот:

ЗАПИСНИК
ЗА ОБЕЗБЕДУВАЊЕ НА МАТЕРИЈАЛНИ ДОКАЗИ
(врз основа на член 40 став (1) алинеја 17 од Законот за извршување)
од ден _____ год.

По објавувањето на почетокот на дејствија за обезбедување на материјални докази, што се врши на адреса _____ во просториите/домот на должникот/доверителот/третото лице _____, во _____ часот, присутни се:

_____

_____

За време на превземање на дејствијата за обезбедување на материјални докази, во однос на постоењето на права што го спречуваат обезбедување на докази на начин и по вид определен од судот, странките/учесниците/третите лица изјавија:

_____

_____

Во текот на обезбедување на доказите ставени се следните забелешки:

_____

_____

Завршено во _____часот.

Препис од овој записник да се достави до судот.
Присутни лица :

_____

_____

_____

ИЗВРШИТЕЛ

_____

(потпис и печат)

Fotografia 18. Kërkesë për informacione dhe të dhëna për shkak të zbatimit të ekzekutimit

И З В Р Ш И Т Е Л
_____
именуван за подрачјето
на Основниот суд
_____

Образец бр.14

И.бр. _____

Извршителот _____од _____ врз основа на барањето за спроведување на извршување од доверителот _____ од _____ со ЕМБГ/ЕМБС/ЕДБ _____ и живеалиште/ престојувалиште/ седиште на _____ засновано на извршната исправа _____ од _____ на _____, против должникот _____ од _____ со ЕМБГ/ЕМБС/ЕДБ _____ и живеалиште/престојувалиште/седиште на _____ за спроведување на извршување во вредност_____, на ден _____ година, до _____ поднесува:

Б А Р А Њ Е

за информации и податоци поради спроведување на извршување
(врз основа на член 41 став (1) од Законот за извршување)

Поради спроведување на извршувањето против должникот потребно е во рок од ____ дена да ми ги доставите следните информации/податоци:
_____
_____
_____
_____

И З В Р Ш И Т Е Л
_____
(потпис и печат)

Д.-на:_____

4.7. Ekzekutimi i sanksioneve

Në nenin 11 është rregulluar çështja për përdorimin e gjuhëve në sferën e ekzekutimit të sanksioneve.

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe vetë institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve janë të obliguara që në komunikim dhe në procedura ta përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% qytetarëve dhe në alfabetin e saj nëse personi për të cilin bëhet fjalë, flet gjuhë që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Institucionet përgjegjëse për menaxhimin e institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe institucionet përgjegjëse për ekzekutimin e sanksioneve janë të obliguara që, personave të cilët gjenden në këto institucione, t'u mundësojnë të drejtohen edhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Република Северна Македонија
Министерство за правда
Управа за извршување на санкции



2

[2] Fotografia është marrë nga www.mia.mk

5. Rregullimi normativ i përdorimit të gjuhëve në legjislacionin material dhe procedural në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, në afat prej një viti dispozitat e ligjeve të tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji, dhe në pajtim me paragrafin (5) të të njëjtit nen, në rast të mosharmonizimit të dispozitave të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve me dispozitat gjuhësore të një ligji tjetër, organet janë të detyruara t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Ligji hyri në fuqi më 14 janar të vitit 2019 dhe nga kjo periudhë filloi të rrjedhë afati për një vit për harmonizimin e dispozitave gjuhësore të ligjeve të tjera me dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Në vazhdim është dhënë një përmbledhje e dispozitave gjuhësore[3] nga ligjet e përzgjedhura që janë të vlefshme në rendin juridik dhe përmbajnë dispozita për përdorimin e gjuhëve jo vetëm në sektorin publik, por edhe në atë privat. Në këtë kontekst, përsëri duhet të merret parasysh Ligji i Përdorimit të Gjuhëve dhe fushëveprimi i tij i përdorimit të gjuhëve, i cili është përcaktuar në nenin 1, paragrafi (3) të ligjit dhe i përfshin të gjitha organet e pushtetit shtetëror të Republikës së Maqedonisë së Veriut, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridike që ushtrojnë kompetenca publike sipas ligjit, si dhe institucione të tjera. Në nivel lokal, fushëveprimi i zbatimit të ligjit është rregulluar në paragrafin (4) të nenit 1 të ligjit sipas të cilit në

[3] Rishikimi përmban një korpus ligjesh të përzgjedhura dhe nuk përfshin dispozita gjuhësore që kanë të bëjnë me ligjet për ratifikimin e akteve ndërkombëtare, publikimet e shpalljeve/konkurseve/thirrjeve publike në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve e as dispozita lidhur me përmbushjen e kushteve për njohjen e gjuhës/ve për shkak të përzgjedhjes/emërimit të funksionit publik ose punësimit, përveç në pjesët 5.22. dhe 5.26 që ka të bëjë me përzgjedhjen e bartësve të funksioneve publike në organet gjyqësore.

njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve është gjuhë zyrtare, përveç maqedonishtes dhe alfabetit të saj cirilik, ndërkaq sa i përket përdorimit të gjuhëve dhe alfabeteve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

5.1. Ligji i Gjykatave [4]

Neni 27, paragrafi (3) - Në gjykatat, selia e të cilave është në territorin e njësive të vetëqeverisjes lokale ku, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj është gjuha që e flasin së paku 20% qytetarëve, vula e gjykatës, emri dhe selia e gjykatës janë të shkruara, respektivisht të theksuara edhe në atë gjuhë dhe në alfabetin e saj.

Neni 50, paragrafi (4) - Gjykatësi dhe gjykatësi - porotë deklaratën solemne e japin në gjuhën maqedonase dhe e nënshkruajnë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 50, paragrafi (5) - Me rastin e përzgjedhjes së gjykatësit dhe gjykatësit - porotë në gjykatën që gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, gjykatësi dhe gjykatësi - porotë që i përket asaj bashkësie, deklaratën solemne e jep në gjuhën maqedonase dhe e nënshkruan në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe në alfabetin e asaj bashkësie.

[4] Ligji i Gjykatave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 58/2006, 35/2008, 150/2010, 83/2018 dhe 198/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/2019).

5.2. Ligji i Procedurës Kontestimore[5]

Neni 6, paragrafi (1) - Procedura kontestimore zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 6, paragrafi (2) - Në procedurën kontestimore, gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, përdoret në pajtim me këtë ligj.

Neni 6, paragrafi (3) - Pjesëtari i bashkësisë, i cili si palë ose pjesëmarrës tjetër në procedurë nuk e kupton dhe nuk e flet gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, ka të drejtë për përkthyes.

Neni 6, paragrafi (4) - Shpenzimet e përkthimit i bartë gjykata.

Neni 6, paragrafi (5) - Gjykata është e obliguar ta udhëzojë palën, respektivisht pjesëmarrësin tjetër në procedurë për të drejtën e paraparë sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni. Kryetari i këshillit ose gjykatësi është i detyruar ta shënojë në procesverbal, respektivisht audioincizimin, udhëzimin e gjykatës dhe deklaratën e palës, përkatësisht të pjesëmarrësit tjetër në procedurë.

Gjuha në procedurë

Neni 93, paragrafi (1) - Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, qytetarë të Republikës së Maqedonisë, gjuha e të cilëve nuk është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik, ndërkaq nuk është as gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja dhe nga alfabeti i saj cirilik, në procedurë kanë të drejtë gjatë pjesëmarrjes në seanca dhe gjatë ndërmarrjes së veprimeve të tjera procedurale me gojë para gjykatës ta përdorin gjuhën e tyre.

[5]Ligji i Procedurës Kontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015).

Këtyre palëve dhe pjesëmarrësve në procedurë do t'u sigurohet përkthim me gojë në gjuhën e tyre të asaj që paraqitet në seancë, si dhe përkthim me gojë të dokumenteve që përdoren në seancë për dëshmim.

Neni 93, paragrafi (2) - Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën sipas paragrafit (1) të këtij neni, do të udhëzohen për të drejtën që procedurën me gojë para gjykatës ta ndjekin në gjuhën e tyre me ndërmjetësimin e përkthyesit. Ata mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit nëse pretendojnë se e dinë gjuhën në të cilën zhvillohen procedurat. Në procesverbal, përkatësisht audioincizim, do të shënohet se janë udhëzuar për atë të drejtë, si dhe deklaratat e palëve, përkatësisht pjesëmarrësve.

Fletëdorëzimi

Neni 143, paragrafi (7) - Teksti i fletëdorëzimit është i shkruar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 143, paragrafi (8) - Në gjykatat që gjenden në rajonin e njësive të vetëqeverisjes lokale në të cilat, përveç gjuhës maqedonase, gjuhë zyrtare është edhe gjuha e pjesëtarëve të bashkësisë të cilën e flasin së paku 20% qytetarëve, teksti i fletëdorëzimit sipas paragrafi (7) të këtij neni është i shkruar edhe në atë gjuhë dhe në atë alfabet.

Dëshmitë dhe paraqitja e dëshmive

Neni 205, paragrafi (3) - Nuk mund të refuzohet dëshmia e faktit sepse është shkruar në gjuhën e bashkësive të palëve ose të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, shtetas të Republikës së Maqedonisë.

Neni 205, paragrafi (4) - Shpenzimet e përkthimit për dëshmitë e tilla mbulohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 230, paragrafi (1) - Dëshmitari i cili nuk e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, do të dëgjohet nëpërmjet përkthyesit gjyqësor.

Neni 230, paragrafi (3) - Gjykata do ta paralajmërojë përkthyesin gjyqësor, respektivisht interpretuesin, për detyrën që me besnikëri t'ia përcjellë pyetjet e bëra dëshmitarit dhe deklaratat që do t'i japë dëshmitari.

Neni 343, paragrafi (2) pika 15 - Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë, nëse gjykata i ka shkelur dispozitat për përdorimin e gjuhës në procedurë.

5.3. Ligji i Procedurën Jashtëkontestimore[6]

Neni 256 - Nëse trashëgimlënësi nuk e njeh gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë ose është memec, gjykata do të thërrasë përkthyes, respektivisht interpretues që e ka dhënë betimin.

Neni 257 - Dëshmitarët gjatë përpilimit të testamentit dhe përkthyesi, respektivisht interpretuesi, duhet të jenë mjaft të aftë, të dinë shkrim-lexim dhe ta njohin gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë dhe gjuhën e trashëgimlënësit, nëse ky përdor gjuhë tjetër, respektivisht nëse ai është memec, shenjat nëpërmjet të cilave kuptohet me interpretuesin.

Neni 260 - Nëse trashëgimlënësi nuk e di gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë ose është memec ose i shurdhër, gjykatësi nëpërmjet, respektivisht interpretuesi që e ka dhënë betimin, do t'ia lexojë testamentin, ndërkaq trashëgimlënësi

[6] Ligji i Procedurës Jashtëkontestimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 9/2008).

nëpërmjet përkthyesit, respektivisht interpretuesit deklaron se testamenti është i tij.

5.4. Ligji i Kundërvajtjeve[7]

Zbatimi i dispozitave të ligjeve të tjera

Neni 2, paragrafi (2) - Nëse me dispozitat e këtij ligji nuk është përcaktuar ndryshe, gjykatat në procedurën kundërvajtëse i zbatojnë dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale që u referohen parimeve themelore: gjuhës, kompetencës lokale, pasojave nga moskompetenca, konfliktit të kompetencave, përjashtimit, të pandehurit, mbrojtësit, parashtresave, procesverbaleve, afateve, kërkesës pronësore-juridike, miratimit dhe shpalljes së vendimeve, dorëzimi i mjeteve juridike me shkrim dhe të rregullta dhe të jashtëzakonshme.

Mbajtja

Neni 94

(2) I pandehuri që mbahet ka të drejtë që menjëherë të informohet në gjuhën e tij amtare ose në gjuhën që e kupton, për shkaqet e mbajtjes, si dhe të udhëzohet se nuk është i detyruar të deklarojë asgjë, se ka të drejtën e ndihmës juridike të mbrojtësit të cilin lirshëm mund ta zgjedhë, dhe se organi kompetent me kërkesë të tij është i obliguar që për mbajtjen e tij t'i njoftojë të afërmit, respektivisht punëdhënësin, ndërkaq nëse është shtetas i huaj, me kërkesë të tij edhe përfaqësinë diplomatike të vendit të tij.

[7] Ligji i Kundërvajtjeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 96/2019).

Arrestimi i personave të hasur gjatë kryerjes së kundërvajtjes

Neni 97

(3) Kryerësi që është arrestuar duhet menjëherë të informohet në gjuhën e tij amtare ose në gjuhën që e kupton për arsyet e arrestimit, si dhe të udhëzohet se nuk është i detyruar të deklarojë asgjë, se ka të drejtën e ndihmës juridike të menjëhershme të mbrojtësit, të cilin lirshëm mund ta zgjedhë dhe për faktin se me kërkesë të tij organi kompetent është i obliguar t'i informojë të afërmit e tij për arrestimin.

5.5. Ligji i Familjes [8]

Neni 177-d, nënparagrafi 5 - Kujdestari i fëmijës, viktimë e trafikimit me njerëz, në mbrojtje të fëmijës, është i detyruar të sigurojë që fëmija t'i marrë të gjitha informacionet në gjuhën e tij amtare.

5.6. Ligji i Trashëgimisë [9]

Cili mund të jetë dëshmitar gjatë përpilimit të testamentit gjyqësor

Neni 70 - Gjatë përpilimit të testamentit gjyqësor mund të jenë dëshmitarë personat madhorë, të cilëve nuk u është hequr aftësia

[8] Ligji i Familjes (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 80/1992, 9/1996, 38/2004, 33/2006, 84/2008, 67/2010, 156/2010, 39/2012, 44/ 2012, 38 / 2014, 115/2014, 104/2015 dhe 150/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 53/2021).

[9] Ligji i Trashëgimisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 47/1996).

afariste dhe të të cilët dinë të shkruajnë dhe të lexojnë dhe që e kuptojnë gjuhën në të cilën është përpiluar testamenti.

Neni 77 - Testamenti mund të shkruhet në çfarëdo gjuhe, me dorë ose në ndonjë mënyrë tjetër.

5.7. Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative [10]

Përdorimi i gjuhëve dhe i alfabeteve

Neni 3, paragrafi (1) - Në procedurën administrative gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Neni 3 paragrafi (2) - Në procedurën administrative që zhvillohet në organin e administratës shtetërore, organet e tjera shtetërore, organet e komunës, e Qytetit të Shkupit dhe e komunave në qytetin e Shkupit, personat juridikë dhe personat e tjerë të cilëve me ligj u është besuar kryerja e autorizimeve publike, gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj, përdoret në pajtim me Ligjin e Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë edhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale.

Neni (3), paragrafi (3) - Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë, të cilët nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe që nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, kanë të drejtë për përkthyes.

[10] Ligji i Procedurës së Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 124/2015).

5.8. Ligji i Noterisë[11]

Dëshmitari i hartimit të aktit noterial

Neni 60, paragrafi (1) - Dëshmitar i përpilimit të aktit noterial duhet të jetë person madhor i cili di të lexojë dhe të shkruajë dhe e di gjuhën zyrtare në të cilën është përpiluar akti.

Përkthyesit

Neni 64, paragrafi (1) - Nëse ndonjëri nga pjesëmarrësit nuk e njeh gjuhën zyrtare, përveç dëshmitarëve të aktit, duhet patjetër të thirret edhe përkthyesi gjyqësor i cili e njeh gjuhën e pjesëmarrësit. Në aktin noterial do të theksohet se kështu është vepruar.

Neni 64, paragrafi (2) - Përkthyes mund të jetë edhe personi i punësuar te noteri, i cili duhet t'i ketë të gjitha cilësitë e tjera të dëshmitarit në aktin noterial.

Neni 64 (3) - Nuk nevojitet përkthyes nëse noteri dhe dy dëshmitarët e aktit e dinë gjuhën e pjesëmarrësit.

Neni 64, paragrafi (4) - Nëse ka nevojë për përkthyes, noteri nëpërmjet përkthyesit do ta përcaktojë vullnetin real dhe serioz të pjesëmarrësit dhe sipas kësaj në gjuhën zyrtare do ta përpilojë aktin noterial, të cilën përkthyesi do t'ua përkthejë gojarisht pjesëmarrësve dhe ajo do të theksohet në vetë aktin.

Neni 64, paragrafi (5) - Noteri duhet t'i udhëzojë pjesëmarrësit që të mund të kërkojnë përkthim me shkrim. Në dokumentin origjinal duhet të theksohet se pjesëmarrësit janë udhëzuar për këtë të drejtë, si dhe nëse kanë hequr dorë nga kjo e drejtë. Nëse pjesëmarrësit e kërkojnë atë, përkthyesi do të bëjë përkthim me

[11] Ligji i Noterisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2016, 142/2016 dhe 233/2018).

shkrim të aktit në gjuhën e pjesëmarrësit dhe aktin e përkthyer do ta kapë me aktin noterial dhe certifikatat që u lëshohen pjesëmarrësve.

Verifikimi i shkresave

Neni 83, paragrafi (6) - Nëse noteri nuk e kupton gjuhën në të cilën është përpiluar dokumenti, shkresën do ta vërtetojë vetëm nëse ka bërë transkriptim, respektivisht fotokopje të atij dokumenti.

Verifikim i nënshkrimit ose i dorëshkrimit

Neni 86, paragrafi (6) - Nëse pjesëmarrësi është i verbër ose nuk di të lexojë, noteri do t'ia lexojë dokumentin me shkrim para se t'ia verifikojë nënshkrimin ose dorëshkrimin. Nëse pjesëmarrësi nuk e di gjuhën në të cilën është shkruar dokumenti, atëherë dokumenti me shkrim do t'i lexohet atij nga përkthyesi gjyqësor dhe kjo do të theksohet në vërejtje nga regjistruesi.

Shqiptimi i gjobës ose marrja e përkohshme e të drejtës për ta kryer shërbimin noterial

Neni 140, paragrafi (1), nënparagrafi 9 - Masa disiplinore me gjobë në shumë prej 2.000 deri në 2.500 euro në kundërvlerë denari ose marrja e përkohshme e të drejtës për kryerjen e shërbimit noterial në kohëzgjatje prej tre deri në gjashtë muaj, do t'i shqiptohet për përpilimin e dokumenteve noteriale ose verifikimin e dokumenteve private në gjuhën, në kundërshtim me dispozitat e këtij ose të ndonjë ligji tjetër që e rregullon përdorimin e gjuhës.

5.9. Ligji i Ekzekutimit[12]

Zbatimi i dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore

Neni 10, paragrafi (2) - Dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, zbatohen edhe gjatë ekzekutimit.

5.10. Ligji i Ekzekutimit të Sanksioneve[13]

Neni 177, paragrafi (2) - Personat e dënuar mund të përdorin libra dhe shtyp ditor në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën dhe në alfabetin e pjesëtarëve të bashkësive etnike ose në gjuhën e shtetit të cilën personi i dënuar e flet.

5.11. Ligji i Procedurës Penale [14]

Gjuha zyrtare dhe alfabeti

Neni 8, paragrafi (1) - Në procedurën penale gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

[12] Ligji i Ekzekutimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2016, 142/2016 dhe 233/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 14/2020).

[13] Ligji i Ekzekutimit të Sanksioneve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 99/2019 dhe 220/19).

[14] Ligji i Procedurës Penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 150/2010, 100/2012, 142/2016 dhe 198/2018).

Neni 8, paragrafi (2) - Gjuhë tjetër zyrtare të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj në procedurë përdoret në pajtim me ligjin.

E drejta e përkthyesit, respektivisht interpretuesit

Neni 9, paragrafi (1) - I akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, kanë të drejtë që në procedurë ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre.

Neni 9, paragrafi (2) - Palët, dëshmitarët dhe pjesëmarrësit në procedurën para gjykatës kanë të drejtë në ndihmën pa pagesë të përkthyesit, respektivisht interpretuesit, nëse nuk e kuptojnë ose nuk e flasin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

Neni 9, paragrafi (3) - Organi që e zhvillon procedurën do të sigurojë përkthim me gojë të asaj që personi dhe të tjerët e thonë, si dhe të dokumenteve dhe të provave të tjera me shkrim. Organi që e zhvillon procedurën do të sigurojë se materiali i shkruar që ka lidhje me procedurën ose me mbrojtjen e të pandehurit të përkthehet me shkrim.

Neni 9, paragrafi (4) - Personi do të udhëzohet për të drejtën e përkthyesit, respektivisht interpretuesit. Në procesverbal do të shënohet se është dhënë udhëzimi dhe deklarata e personit.

Neni 9, paragrafi (5) - Përkthimin e bën përkthyesi gjyqësor, respektivisht interpretuesi.

Dorëzimi me shkrim

Neni 10, paragrafi (1) - Paditë, ankesat dhe parashtresat e tjera dorëzohen në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

Neni 10, paragrafi (2) - Qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, parashtresat mund t'i dorëzojnë në

gjuhën dhe alfabetin e tyre. Parashtresa të tilla përkthehen dhe u dorëzohen palëve në procedurë.

Neni 10, paragrafi (3) - Personat e tjerë që nuk e flasin ose nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, parashtresat mund t'i dorëzojnë në gjuhën dhe në alfabetin e tyre. Në ato raste veprohet sipas paragrafit (2) të këtij neni.

Neni 10, paragrafi (4) - Të pandehurit, i cili nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, do t'i sigurohet përkthimi i aktakuzës në gjuhën të cilën e ka përdorur në procedurë.

Neni 10, paragrafi (5) - Shtetasi i huaj i privuar nga liria ose i paraburgosur, parashtresën mund ta dorëzojë në gjuhën e tij, ndërkaq në raste të tjera në kushte reciprociteti.

Dorëzimi me shkrim

Neni 11, paragrafi (1) - Fletëthirrjet, vendimet dhe dokumentet e tjera me shkrim dorëzohen në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

Neni 11, paragrafi (2) - Qytetarëve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, fletëthirrjet, vendimet dhe dokumentet e tjera me shkrim do t'u dorëzohen edhe në atë gjuhë.

Neni 11, paragrafi (3) - Të pandehurit, i cili është në paraburgim, në vuajtje të dënimit ose në trajtim të detyrueshëm psikiatrik dhe në mbajtje në institucionin shëndetësor, do t'i sigurohet përkthimi i parashtresave sipas paragrafit (1) të këtij neni në gjuhën të cilën e ka përdorur në procedurë.

Neni 11, paragrafi (4) - Të pandehurit, i cili nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, do t'i sigurohet përkthimi i aktgjykimit në gjuhën të cilën e ka përdorur në procedurë.

Të drejtat e të dëmtuarit

Neni 57, paragrafi 1, pika 2) - Në procedurën penale i dëmtuari i ka këto të drejta: ta përdorë gjuhën dhe alfabetin e tij, si dhe të drejtën e ndihmës nga përkthyesi, respektivisht interpretuesi nëse nuk e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

Të drejtat e personit të thirrur, të arrestuar ose të privuar nga liria

Neni 69, paragrafi (1) - Personi i thirrur, i arrestuar ose i privuar nga liria duhet të informohet menjëherë, në gjuhën që ai e kupton për arsyet e thirrjes, të arrestimit ose të privimit nga liria për çdo dyshim lidhur me kryerjen e veprës penale kundër tij, si dhe për të drejtat e tij, dhe nga personi nuk mund të kërkohet deklaratë.

Të drejtat e të pandehurit

Neni 70, paragrafi (1), nënparagrafi 1 - Çdo i pandehur i ka këto të drejta themelore: të informohet në kohë dhe në mënyrë të hollësishme, në gjuhën që ai e kupton, për veprat për të cilat akuzohet dhe për provat kundër tij.

Marrja e të dhënave personale nga i pandehuri

Neni 205, paragrafi (1) - Kur i pandehuri merret në pyetje, për herë të parë do të pyetet nëse e kupton gjuhën në të cilën zhvillohet procedura, për emrin dhe mbiemrin, për pseudonimin nëse ka, për emrin dhe mbiemrin e prindërve, për emrin e vajzërisë së nënës, vendlindjen, vendbanimin, ditën, muajin dhe vitin e lindjes, numrin e vetëm të amzës, për përkatësinë e komunitetit, shtetësinë, profesionin, rrethanat familjare, arsimin, gjendjen pronësore, nëse, kur dhe pse është dënuar, nëse dhe kur e ka vuajtur dënimin e shqiptuar, nëse ndiqet penalisht për ndonjë vepër tjetër penale, ndërkaq nëse është i mitur cili është përfaqësuesi i tij ligjor.

Udhëzim për të drejtat e të pandehurit

Neni 206, paragrafi (1), pika 6 - Para çdo marrjeje në pyetje i pandehuri patjetër do të informohet dhe do të udhëzohet: se ka të drejtë në ndihmën falas të përkthyesit, respektivisht interpretuesit, nëse nuk e kupton ose nuk e flet gjuhën e përdorur gjatë marrjes në pyetje.

Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale

Neni 415, paragrafi (1), pika 12 - Shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale ekziston: kur gjykata ka shkelur dispozitat për përdorimin e gjuhës në procedurën e përcaktuar me këtë ligj.

5.12. Ligji i Kontabilitetit të Buxhetit dhe i Shfrytëzuesve Buxhetorë [15]

Neni 7, paragrafi (1) - Buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetorë librat afaristë i mbajnë në gjuhën maqedonase me numra arabë dhe vlera të shprehura në denarë. Nëse përdoren shkurtesa, kode, shenja apo simbole, kuptimi i tyre duhet të shpjegohet qartë.

Raporti financiar

Neni 22, paragrafi (7) - Raportet themelore financiare sipas paragrafit (1)[16] të këtij neni përpilohen për vitin fiskal në gjuhën maqedonase dhe në denarë.

[15] Ligji i Kontabilitetit të Buxheteve dhe të Shfrytëzuesve Buxhetorë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 61/2002, 98/2002, 81/2005, 24/2011, 145/2015 dhe 170/2017 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 122/2021).

[16] Buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetorë janë të detyruar të përgatisin raporte themelore financiare, siç vijon: bilanc të gjendjes, bilanc të të hyrave dhe të shpenzimeve, si dhe bilanc të konsoliduar. Bilanci i konsoliduar si raport

5.13. Ligji i Emetimit të Pullave Administrative dhe Gjyqësore [17]

Neni 6 - Teksti i pullës administrative dhe gjyqësore shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

5.14. Ligji i Ekzekutimit të Vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut[18]

Procedura pas marrjes së vendimit të gjykatës

Neni 14, paragrafi (1) - Në afat prej një muaji nga dita e shpalljes së aktgjykimit të gjykatës, byroja përgatit përkthim zyrtar të tij në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 14, paragrafi (2) - Burimi i vendimit të Gjykatës dhe përkthimi zyrtar i aktgjykimit në gjuhën maqedonase publikohen në ueb-faqen e Ministrisë së Drejtësisë.

Masat e veçanta dhe të përgjithshme

Neni 22, paragrafi (2) - Me njoftimin për aktgjykimin e dorëzuar te subjekti sipas paragrafit (1) të këtij neni, dorëzohet edhe përkthimi i aktgjykimit në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

---

financiar nuk përgatitet në kontabilitetin e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kontabilitetin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes lokale.

[17] Ligji i Emetimit të Pullave Administrative dhe Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 65/1992, 49/1993 dhe 50/2001).

[18] Ligji i Ekzekutimit të Vendimeve të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/2009 dhe 43/2014).

5.15. Ligji i Avokatit të Popullit [19]

Neni 14, paragrafi (1) - Në procedurën para Avokatit të Popullit, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik.

Neni 14, paragrafi (2) - Në procedurën e zhvilluar para Avokatit të Popullit, gjuhë zyrtare është edhe gjuha tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

Neni 14, paragrafi (3) - Dispozitat e Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve zbatohen në mënyrë të duhur edhe në procedurën para Avokatit të Popullit.

Neni 15 - Çdo person në komunikim me Avokatin e Popullit mund të përdorë njërën nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërkaq Avokati i Popullit përgjigjet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e sajcirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin zyrtar që përdor parashtruesi.

[19] Ligji i Avokatit të Popullit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 60/2003, 114/2009, 181/2016, 189/2016 dhe 35/2018).

5.16. Kodi Zgjedhor [20]

Mënyra e punës së organeve zgjedhore

Neni 23, paragrafi (3) - Me rastin e mbajtjes së zgjedhjeve në punën e komisioneve komunale zgjedhore, përkatësisht të Komisionit zgjedhor të qytetit të Shkupit dhe këshillave zgjedhore, në komunat ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, në përdorim zyrtar është edhe gjuha dhe alfabeti që e flasin së paku 20% e qytetarëve në atë komunë.

Neni 31, paragrafi (5) - Formularët dhe i gjithë materiali zgjedhor për komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, shtypen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin zyrtar që e flasin së paku 20% e qytetarëve në atë komunë.

Neni 31, paragrafi (6) - Formularët dhe i gjithë materiali zgjedhor për njësitë zgjedhore numër 7, 8 dhe 9 të këtij ligji, në të cilat së paku 20% e votuesve të regjistruar në atë listë zgjedhore për atë zonë zgjedhore flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonisht, shtypen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që e flasin së paku 20% e votuesve të regjistruar në listën zgjedhore të asaj njësie zgjedhore.

[20] Kodi Zgjedhor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 40/2006, 136/2008, 44/2011, 51/2011, 142/2012, 31/2013, 34/2013, 14/2014, 196/2015, 35/2016, 97/2016, 99/2016, 136/2016, 142/2016, 67/2017, 125/2017, 35/2018, 99/2018, 140/2018, 208/2018 dhe 27/2019 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 98/2019, 42/2020, 74/2021 dhe 215/2021).

Paraqitja dhe këqyrja në listën zgjedhore për votim jashtë vendit

Neni 50-a, paragrafi (3) - Njoftimi sipas paragrafit (1) të këtij neni do të publikohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, në gjuhët dhe në alfabetet e bashkësive të shënuara në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe në gjuhën zyrtare të shtetit përkatës në ueb-faqen e PKD-së, përkatësisht të zyrave konsullore.

Parashtruesi i listës

Neni 58, paragrafi (2) - Gjatë zgjedhjeve lokale, parashtruesi i listave sipas paragrafit (1) të këtij neni në njësinë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, parashtruesi i listave të kandidatëve, përkatësisht lista e kandidatëve për kryetar komune bëhet në gjuhën dhe në alfabetin që e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëqeverisjes lokale.

Neni 58, paragrafi (3) - Gjatë mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, parashtruesi i listave sipas paragrafit (1) të këtij neni në njësitë zgjedhore ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, parashtrimi i listave të kandidatëve mund të bëhet, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, edhe në gjuhën dhe në alfabetin të cilin e përdorin qytetarët në atë njësi të vetëqeverisjes lokale.

Publikimi i listave të përcaktuara

Neni 69, paragrafi (2) - Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve listat e vetme të përcaktuara të kandidatëve për deputetë në njësitë zgjedhore do t'i publikojë në shtypin ditor, ku njëra është në gjuhën e bashkësisë që e flasin së paku 20% e qytetarëve të

Republikës së Maqedonisë, më së voni 23 ditë para ditës së përcaktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 69, paragrafi (6) - Listat e përcaktuara të kandidatëve në komunat ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, do të publikohen, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, edhe në gjuhë zyrtare dhe në alfabetin që e përdorin qytetarët në atë komunë.

Prezantimi mediatik

Neni 75, paragrafi (1) - Radiodifuzerët, respektivisht Servisi Publik i Radiodifuzionit, shoqëritë tregtare të radiodifuzionit dhe mediet elektronike (portalet e internetit) që kanë vendosur ta mbulojnë procesin zgjedhor, janë të detyruar ta bëjnë këtë në mënyrë të drejtë, të balancuar dhe të paanshme në programin e tyre të plotë. Servisi Publik i Radiodifuzionit dhe radiodifuzerët nacionalë janë të detyruar ta bëjnë këtë në format dhe në gjuhë të qasshme dhe të arritshme, si dhe në gjuhën e shenjave.

Neni 75, paragrafi (2) - Radiodefuzerët, pa marrë parasysh gjuhën në të cilën e transmetojnë shërbimin e tyre programor, janë të obliguar që gjatë fushatës zgjedhore t'u ofrojnë kushte të barabarta pjesëmarrësve në fushatë për qasje në të gjitha format e prezantimit zgjedhor mediatik - lajme, programe të veçanta informative (intervista, debate, ballafaqime TV/radio, lajme aktuale, emisione aktuale informative me qasje dokumentare dhe me programe të specializuara tematike informuese), prezantim politik falas dhe reklamim politik me pagesë.

Neni 75, paragrafi (3) - Radiodifuzerët, pa marrë parasysh gjuhën në të cilën e transmetojnë shërbimin e tyre programor, janë të obliguar që, reklamat politike të paguara gjatë fushatës zgjedhore, pjesëmarrësve në fushatë t'u ofrojnë kushte të barabarta për qasje në të gjitha format e prezantimit zgjedhor mediatik, të përllogaritur çdo 12 orë program të transmetuar,

duke përfshirë përfaqësimin politik falas të pjesëmarrësve në fushatën zgjedhore.

Neni 75-a (1) - Radiodifuzerët do të sigurojnë mbulim të balancuar të procesit zgjedhor në të gjitha format e mbulimit mediatik zgjedhor, ndërkaq radiodifuzerët nacionalë duhet të ofrojnë mbulim të balancuar të zgjedhjeve në të gjitha format e prezantimit mediatik zgjedhor në gjuhë dhe format të qasshëm dhe të arritshëm, si dhe në gjuhën e shenjave në këto mënyra:

Neni 75-e, paragrafi (5) - Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të votimit, radiodifuzerët, mediet e shkruara dhe mediet elektronike (portalet e internetit) mjetet financiare të të cilave për reklama politike me pagesë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, transmetojnë në mënyrë të obligueshme, përkatësisht publikojnë pa pagesë fushata informative dhe edukative të KSHZ-së për qytetarët lidhur me procesin zgjedhor në format dhe në gjuhë e qasshme dhe të arritshme, si dhe në gjuhën e shenjave, në kohëzgjatje prej 30 sekondash çdo tri orë.

Neni 76, paragrafi (7) - Fushatat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve për edukimin e votuesve për realizimin e të drejtës së votës dhe për zgjedhje të ndershme dhe demokratike nuk konsiderohen reklama politike me pagesë. Nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e përfundimit të votimit, radiodifuzerët, mediet e shkruara dhe mediet elektronike (portalet e internetit) mjetet financiare të të cilave për reklama politike me pagesë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë, transmetojnë në mënyrë të obligueshme, respektivisht publikojnë pa pagesë fushata informative dhe edukative të KSHZ-së për qytetarët lidhur me procesin zgjedhor duke përdorur format dhe gjuhë të qasshme dhe të arritshme, si dhe gjuhën e shenjave në kohëzgjatje prej 30 sekondash çdo tri orë. Ato duhet të ndahen

nga pjesa tjetër e programit si transmetim falas dhe porositësi i tyre duhet të jetë i shënuar qartë.

Neni 76-a, paragrafi (4) - Servisi Publik i Radiodifuzionit është i obliguar të sigurojë informim dhe edukim të rregullt për procesin zgjedhor në format dhe në gjuhë të qasshme dhe të arritshme, si dhe në gjuhën e shenjave.

Neni 90, paragrafi (1) - Udhëzimet e votimit vendosen në vend të dukshëm në paravanin e votimit dhe në vende të tjera të dukshme në vendvotimet në pajtim me udhëzimin e lëshuar nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve. Udhëzimi është i shtypur në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhët dhe alfabetet e bashkësive të theksuara në preambulën e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë.

Fleta e votimit

Neni 93, paragrafi (1) - Fleta e votimit shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 93, paragrafi (2) - Emri i parashtruesit të listës, emri dhe mbiemri i kandidatit, përkatësisht bartësit të listës, shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 93, paragrafi (3) - Për pjesëtarët e komuniteteve, emri i parashtruesit të listës dhe emri e mbiemri i kandidatit, përkatësisht bartësit të listës, shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e komunitetit të cilit i përkasin.

Neni 93, paragrafi (4) - Në komunat ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, fletët e votimit për zgjedhje shtypen, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, edhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që e përdorin qytetarët në atë komunë.

5.17. Ligji i Evidencës së Amzës[21]

Neni 3-a, paragrafi (1) - Librat e amzës mbahen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 3-a, paragrafi (2) - Në zonat e njësive të vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, formulari i librave të amzës shtypet dhe të dhënat brenda tij shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 3-a, paragrafi (3) - Certifikatat që lëshohen në bazë të librave të amzës sipas paragrafit 2 të këtij neni, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që e përdor qytetari.

5.18. Ligji i Policisë Financiare[22]

Thirrja e qytetarëve dhe grumbullimi i informacioneve

Neni 15, paragrafi (3) - Polici financiar i merr njoftimet e nevojshme nga qytetarët vetëm pasi paraprakisht të ketë bërë identifikimin e personit dhe ajo do t'i sqarohet në gjuhën që e kupton për të drejtat e tij, në pajtim me Ligjin e Procedurës Penale.

[21] Ligji i Evidencës së Amzës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 8/1995, 38/2002, 66/2007, 98/2008, 67/2009, 13/2013, 43/2014, 148/2015, 2 2016 dhe 64/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 14/2020).

[22] Ligji i Policisë Financiare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 12/2014, 43/2014, 33/2015, 27/2016, 83/2018 dhe 198/2018).

5.19. Ligji i Policisë [23]

Neni 34 - Gjatë zbatimit të kompetencave policore, thirrja, privimi nga liria, arrestimi dhe ndalimi, nëpunësi policor duhet ta informojë menjëherë personin në gjuhën që ai kupton për arsyet e thirrjes, privimit nga liria, arrestimit ose ndalimit dhe në mënyrë të qartë ta udhëzojë për të drejtën për të heshtur, të drejtën për t'u konsultuar me avokatin, të drejtën për avokat gjatë procedurës policore, të drejtën për ndihmë mjekësore nëse kërkohet nga personi, si dhe të drejtën që të informohet ndonjë anëtar i familjes së tij ose i ndonjë person të afërm.

5.20. Ligji i Shërbimit në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut[24]

Neni 5 - Gjuhë zyrtare në armatë është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Betimi

Neni 7, paragrafi (2) - Personi i cili flet gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, e nënshkruan betimin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe në alfabetin e saj.

[23] Ligji i Policisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 114/2006, 6/2009, 145/2012, 41/2014, 33/2015, 31/2016, 106/2016, 120/2016, 120/2016, 201821 , 21/2018 dhe 64/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 294/2021).

[24] Ligji i Shërbimit në Armatën e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 36/2010, 23/2011, 47/2011, 148/2011, 55/2012, 29/2014, 33/ 2015, 193/2015, 193/2015 dhe 71/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 101/2019, 275/2019 dhe 14/2020).

5.21. Ligji i të Punësuarve në Sektorin Publik[25]

E drejta e aftësimit profesional

Neni 28, paragrafi (2) - Sipas nevojës, aftësimi profesional mund të bëhet në gjuhët e bashkësive që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

5.22. Ligji i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut [26]

Deklaratë solemne

Neni 33, paragrafi (4) - Anëtarët e zgjedhur dhe anëtari i këshillit sipas funksionit, deklaratën solemne e japin dhe e nënshkruajnë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 33, paragrafi (5) - Anëtarët e zgjedhur të këshillit, pjesëtarë të bashkësive që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, që e flasin së paku 20% e qytetarëve, deklaratën solemne e japin në pajtim me dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

[25] Ligji i të Punësuarve në Sektorin Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018 dhe 198/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 143 /2019 dhe 14/2020).

[26] Ligji i Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 150/2007 dhe 100/2011 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/2020).

Përfaqësim i drejtë dhe adekuat në zgjedhjen e prokurorëve publikë

Neni 41 - Kur këshilli zgjedh prokurorë publikë në Prokurorinë Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe të Korrupsionit, prokuror publik themelor ose prokuror publik në prokurori publike themelore, të themeluar për një zonë prej dy ose më shumë gjykatave, prej të cilave të paktën një gjykatë është me seli në rajonet e njësive të vetëqeverisjes lokale në të cilën, krahas gjuhës maqedonase, gjuhë tjetër zyrtare është edhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve që jetojnë në zonën e asaj vetëqeverisjeje lokale dhe prokurori i lartë publik ose prokurorët publikë në atë prokurori që gjendet në zonën e njësisë së vetëqeverisjes lokale ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, vendos në pajtim me nenin 39 të këtij ligji, me shumicë votash nga pjesëtarët e pranishëm që u takojnë komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

5.23. Ligji i Barnave dhe i Pajisjeve Mjekësore[27]

Neni 2, paragrafi (1), pika 44) - Disa terma të përdorur në këtë ligj kanë këtë kuptim: Udhëzuesi për pacientin është informacion për përdoruesin, i cili në formë të shkruar i bashkëngjitet barit, ndërkaq përmban informacione bazë për barin dhe përdorimin e tij të duhur dhe duhet të shkruhet në gjuhë të kuptueshme dhe të qartë për pacientin - përdoruesin.

[27] Ligji i Barnave dhe i Pajisjeve Mjekësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 106/2007, 88/2010, 36/2011, 53/2011, 136/2011, 11/2012, 147/2013, 164/2013, 27/2014, 43/2014, 88/2015, 154/2015, 228/2015, 7/2016, 53/2016, 83/2018, 113/2018 dhe 245/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 28/2021 dhe 122/2021).

Etiketimi i barnave dhe i udhëzimit për pacientin

Neni 83 - Çdo bar që vendoset në treg, në ambalazhin e jashtëm, duhet të shënohet me të dhëna në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik ose kur nuk ka ambalazh të jashtëm, në ambalazhin kontaktues. Të njëjtat të dhëna mund të jepen në një ose më shumë gjuhë të huaja.

Neni 84 - Çdo bar që lëshohet në treg duhet të përmbajë udhëzime për pacientin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e tij cirilik në pajtim me raportin përmbledhës për veçoritë e barit, përveç nëse të gjitha të dhënat në pajtim me këtë ligj janë dhënë në anën e jashtme ose nëse nuk ka ambalazh të jashtëm në ambalazhin e kontaktit.

Neni 85 - Me përjashtim sipas nenit 83 të këtij ligji, agjencia mund të lejojë që ambalazhi i jashtëm dhe i kontaktit, si dhe udhëzimi për pacientin të jenë në gjuhë të huaj, me kusht që të gjitha të dhënat e nevojshme në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik të vendosen në etiketën e ambalazhit dhe të vendoset edhe udhëzim për pacientin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 131-a, paragrafi (1), pika 11) - Për kryerjen e importit paralel të pajisjeve mjekësore, tregtia me shumicë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht institucioni shëndetësor sipas nenit 131-b, paragrafi 1 të këtij ligji, i paraqet kërkesë agjencisë me dokumentacioni dhe të dhënat në vijim: licencë për shitje me shumicë të personit juridik nga i cili është blerë pajisja mjekësore në shtetin nga ku kryhet importi paralel, e lëshuar nga organi kompetent, me përkthim nga përkthyes gjyqësor i tekstit në gjuhën maqedonase dhe në alfabeti e saj cirilik.

Neni 131-a, paragrafi (1), pika 12) - Për kryerjen e importit paralel të pajisjeve mjekësore, tregtia me shumicë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht institucioni shëndetësor sipas nenit 131-b,

paragrafi 1 të këtij ligji, paraqet kërkesë te agjencia me dokumentacionin dhe të dhënat si në vijim: udhëzim për përdorim i cili miratohet në shtetin nga ku kryhet importi paralel me përkthim nga përkthyes gjyqësor i përmbajtjes së tekstit në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 131-a, paragrafi (1), pika 12) - Për kryerjen e importit paralel të pajisjeve mjekësore, tregtia me shumicë sipas paragrafit 1 të këtij neni, përkatësisht institucioni shëndetësor sipas nenit 131-b, paragrafi 1 të këtij ligji, paraqet kërkesë te agjencia me dokumentacionin dhe të dhënat si në vijim: afishe shtesë që e përmban shënimin e ambalazhit në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Etiketimi i pajisjeve mjekësore

Neni 132, paragrafi (1) - Pajisjet mjekësore që janë në treg duhet të jenë të shënuara në përputhje me dispozitat e këtij ligji, në ambalazhin e jashtëm dhe të kontaktit në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe duhet të përmbajnë udhëzime për përdorim.

Neni 132, paragrafi (3) - Udhëzimet për përdorimin e pajisjes mjekësore duhet të jenë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

5.24. Ligji i dokumenteve të udhëtimit për shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut[28]

Neni 28, paragrafi (1) - Formularët e dokumenteve të udhëtimit dhe të vizave shtypen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, me përkthim në gjuhën angleze dhe atë franceze dhe në alfabetin e tyre.

Neni 28, paragrafi (2) - Të dhënat që shënohen në dokumentin e udhëtimit, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në alfabetin elementar latin (I CAO DOC 9303), përveç shenjave (kodeve) internacionale, që shkruhen në pajtim me standardet ndërkombëtare të vërtetuara në I CAO DOC 9303.

Neni 28 (3) - Formularët e dokumenteve të udhëtimit të qytetarëve që e flasin gjuhën e së paku 20% të qytetarëve dhe alfabetin e saj cirilik, shtypen në rrugë zyrtare, dhe të dhënat në to shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 28, paragrafi (4) - Formularët e dokumenteve të udhëtimit të qytetarëve që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja dhe që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesë të tyre, shtypen edhe në gjuhën dhe në alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 28, paragrafi (5)- Për qytetarët, sipas paragrafit 4 të këtij neni, me kërkesë të tyre personale, të dhënat që vendosen në

[28] Ligji i Dokumenteve të Udhëtimit për Shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/1992, 20/2003, 46/2004, 19/2007, 84/2008, 51/2011, 135/2011, 154/2015 dhe 55/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.302/2020 dhe 122/2021).

dokumentin e udhëtimit, shkruhen edhe në gjuhën dhe në alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 28, paragrafi (6) - Për qytetarët, sipas paragrafit 4 të këtij neni, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që vendosen në dokumentin e udhëtimit, shkruhen edhe në gjuhën dhe në alfabetin që e përdor qytetari.

5.25. Ligji i Mbrojtjes së të Dhënave Personale[29]

Njoftimi i subjektit të të dhënave personale për cenimin e sigurisë së të dhënave personale

Neni 38, paragrafi (2) - Në njoftimin e subjektit të të dhënave personale, sipas paragrafit (1) të këtij neni, në gjuhë të qartë dhe të thjeshtë përshkruhet natyra e rrezikimit të sigurisë së të dhënave personale dhe shkruhen të paktën informacionet dhe masat e shënuara në nenin 37, paragrafi (3), nënparagrafët (b), (c) dhe (ç) të këtij ligji.

[29] Ligji i Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.42/2020 dhe 294/2021).

5.26. Ligji i Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut[30]

Përfaqësimi i drejtë dhe adekuat në përzgjedhjen e gjykatësve dhe të kryetarëve të gjykatave

Neni 50, paragrafi (1) - Kur këshilli përzgjedh gjykatës dhe kryetar të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit që gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, vendos sipas nenit 49 të këtij ligji, ku patjetër duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Përzgjedhja dhe shkarkimi i gjykatësve të porotës

Neni 53, paragrafi (3) - Kur këshilli përzgjedh gjykatës të porotës në gjykatë që gjendet në rajonin e njësisë së vetëqeverisjes lokale, ku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, vendos sipas nenit 49 të këtij ligji, ku patjetër duhet të ketë shumicë votash nga anëtarët e pranishëm që u përkasin komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

[30] Ligji i Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.102/2019).

5.27. Ligji i të Drejtave të Komuniteteve që janë më pak se 20% e popullatës në Republikën e Maqedonisë së Veriut[31]

E drejta e arsimit

Neni 6 - Pjesëtarët e komuniteteve, sipas ligjit, kanë të drejtë të arsimimit në gjuhën dhe në alfabetin e tyre në të gjitha nivelet.

E drejta e informimit

Neni 7 - Pjesëtarët e komuniteteve, sipas ligjit, kanë të drejtë të pranimit dhe të bartjes së informacioneve në gjuhën dhe në alfabetin e tyre nëpërmjet medieve elektronike dhe të shtypura,.

E drejta e përdorimit të gjuhës dhe të alfabetit amë

Neni 9 - Pjesëtarët e komuniteteve, sipas ligjit, kanë të drejtë të përdorimit të gjuhës dhe të alfabetit të tyre.

[31] Ligji i të Drejtave të Komuniteteve që janë më Pak se 20% e Popullatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.18/2020).

5.28. Ligji i Sigurisë së Trafikut në Rrugë [32]

Neni 188, paragrafi (3) - Shenjat sinjalizuese të trafikut dhe tabelat shtesë që janë pjesë përbërëse e shenjave të trafikut dhe të cilat e përcaktojnë më afër domethënien e shenjës së trafikut, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në anglisht dhe në frëngjisht, si dhe në alfabetin e tyre, ndërkaq në rajonet e njësive të vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, shënohen edhe në atë gjuhë zyrtare dhe në alfabetin e saj.

Neni 188, paragrafi (4) - Shenjat e trafikut, sipas paragrafit (3) të këtij neni, janë të shkruara fillimisht në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, e më pas edhe në gjuhët e tjera sipas paragrafit (3) të këtij neni.

Test prove

Neni 282, paragrafi (1) – Aftësim të kandidatit për ngasës për drejtim praktik të automjetit në rrugë, autoshkolla kryen pasi paraprakisht të bëjë kontroll nëse kandidati për ngasës ka njohuri të nevojshme për rregullat e komunikacionit në rrugë dhe për shenjat e trafikut.

Neni 282, paragrafi (2) – Kontrollin, sipas paragrafit (1) të këtij neni, e zbaton me shkrim ligjëruesi i autoshkollës, me test prove të përpunuar paraprakisht nga Ministria e Punëve të Brendshme në pajtim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

[32] Ligji i Sigurisë së Trafikut në Rrugë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 169/2015, 226/2015, 55/2016, 11/2018 dhe 83/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 98/2019, 302/2020 dhe 122/2021).

Neni 282, paragrafi (3) – Testi, sipas paragrafit (2) të këtij neni, përpunohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, ndërkaq për qendrat e autorizuara të provimeve, sipas nenit 291, paragrafi (2) të këtij ligji, që gjenden në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, shkruhet edhe në atë gjuhë zyrtare dhe në alfabetin e saj.

Neni 294, paragrafi (2) - Pjesa teorike e provimit për ngasës, sipas paragrafit (1) të këtij neni, jepet në mënyrë elektronike në test të përgatitur paraprakisht nga Ministria e Punëve të Brendshme në pajtim me Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

Neni 294, paragrafi (3) – Testi, sipas paragrafit (2) të këtij neni, përpunohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, ndërkaq për qendrat e autorizuara të provimeve, që gjenden në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20 % e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, shkruht edhe në atë gjuhë zyrtare dhe në alfabetin e saj.

Neni 306, paragrafi (1) - Leja e ngasësit lëshohet në formular ku forma, përmbajtja, ngjyra, lloji dhe cilësia e materialit janë të njëtrajtshme për territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 306, paragrafi (2) - Formulari i lejes së ngasësit shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën angleze dhe në alfabetin e saj.

Neni 306, paragrafi (3) - Të dhënat në formularin e lejes së ngasësit shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në alfabetin elementar latin (ICAO Doc.9303).

Neni 306, paragrafi (4) – Qytetarëve, të cilët flasin gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, sipas detyrës zyrtare, formulari i lejes së ngasësit shtypet dhe të dhënat në të

shkruhen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 306, paragrafi (5) - Qytetarëve të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, me kërkesën e tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në lejen e ngasësit, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari dhe në alfabetin elementar latin (ICAO Doc.9303).

Neni 306, paragrafi (6) - Në formularin e lejes së ngasësit, numrat rendorë me të cilat numërohen rubrikat ku shënohen të dhënat dhe shenjat (kodet) ndërkombëtare për kategoritë e automjeteve për të cilat vlen leja e ngasësit, kufizimet e mundshme për arsye shëndetësore për ngasësin, si dhe shenja (kodi) ndërkombëtar i Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtypen në alfabetin elementar latin (ICAO Doc.9303).

Neni 307, paragrafi (1) - Gjatë lëshimit të lejes së ngasësit, Ministria e Punëve të Brendshme ngasësit i jep librezë për shënimin e pikëve negative për shkeljet e bëra, si dhe sanksion kundërvajtës - ndalesë për drejtimin e automjetit motorik, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 307, paragrafi (2) - Libreza e ngasësit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, lëshohet në formular ku forma, përmbajtja, ngjyra, lloji dhe cilësia e materialit janë të njëtrajtshme për territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 307, paragrafi (3) - Formulari i librezës së ngasësit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe të dhënat në të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 307, paragrafi (4) - Për qytetarët që e flasin gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, formulari i librezës së shoferit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, shtypet dhe të dhënat në të shkruhen edhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 307, paragrafi (5) - Për qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, që e flasin së paku 20% e qytetarëve, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në librezën e ngasësit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin që e përdor qytetari.

5.29. Ligji i Pronësisë Industriale [33]

Mënyra e paraqitjes së aplikimit

Neni 18, paragrafi (1) - Aplikimi për marrjen e të drejtës për pronësi industriale paraqitet në formë të shkruar personalisht, me postë ose në mënyrë elektronike.

Neni 18, paragrafi (2) – Aplikimi, sipas paragrafit (1) të këtij neni, paraqitet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 18, paragrafi (3) - Aplikimi për marrjen e të drejtës për pronësi industriale mund të paraqitet edhe në gjuhë të huaj, nëse përmban emërtim të llojit të mbrojtjes që kërkohet dhe të dhëna kontakti me paraqitësin, në gjuhën maqedonase.

[33] Ligji i Pronësisë Industriale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 21/2009, 24/2011, 12/2014, 41/2014, 152/2015, 53/2016 dhe 83/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 31/2020).

Neni 18, paragrafi (4) - Nëse aplikimi është paraqitur në gjuhë të huaj, paraqitësi patjetër duhet në afat prej 90 ditëve, nga paraqitja e aplikimit në gjuhë të huaj, të dorëzojë përkthim të paraqitjes në gjuhën maqedonase, përndryshe do të konsiderohet se aplikimi është tërhequr dhe merret vendim për ndërprerjen e procedurës.

Përmbajtja e aplikimit për leje

Neni 43, paragrafi (1), pika 7) - Paraqitja e lejes duhet të përmbajë: përkthim në gjuhën maqedonase, nëse aplikimi është paraqitur në gjuhë të huaj.

Kontrolli formal i aplikimit

Neni 54, paragrafi (1), pika 2) - Pas regjistrimit të aplikimit për leje në Regjistrin e aplikimeve për leje, enti kontrollon: nëse është dorëzuar përkthim i aplikimit në gjuhën maqedonase, nëse aplikimi është bërë në gjuhë të huaj.

Dëshmia dhe procedura pas dëshmisë nga kontrolli i plotë

Neni 62, paragrafi (3) - Paraqitësi i aplikimit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, obligohet në afat prej gjashtë muajve nga data kur e ka marrë dëshminë e kontrollit sipas nenit 64 të këtij ligji, pranë entit ta dorëzojë dëshminë dhe përkthimin e dëshmisë në gjuhën maqedonase.

Aplikime që paraqiten nëpërmjet entit si ent pranues në pajtim me PKD-në

Neni 116, paragrafi (1) - Ndaj aplikimeve që ndërkombëtarisht paraqiten nëpërmjet entit si ent pranues, zbatohen dispozitat e PKD-së[34] dhe dispozitat e këtij ligji.

Neni 116, paragrafi (2) – Aplikimet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, paraqiten në gjuhë angleze.

Paraqitja e aplikimeve europiane

Neni 120, paragrafi (1) - Aplikimet europiane, përveç aplikimeve të ndara europiane, paraqiten në çfarëdo gjuhe.

Të drejtat e lejeve europiane

Neni 122, paragrafi (2) - Bartësi i lejes europiane obligohet në afat prej tre muajve nga data e publikimit të pranimit në EEL ndaj aplikimit për pranimin e lejes pranë entit të dorëzojë edhe përkthim në gjuhën maqedonase të lejeve, kërkesave dhe drafteve, nëse aplikimi përmban drafte dhe t'i paguajë taksat dhe shpenzimet e parapara të procedurës.

Gjuha e lejeve europiane

Neni 123, paragrafi (1) - Nëse përkthimi i kërkesave të lejeve në gjuhën maqedonase sipas neneve 121, paragrafi (2) dhe 122, paragrafi (2) dhe (3) të këtij ligji, jep mbështetje me vëllim të ulët në raport me mbrojtjen e aplikimeve europiane ose leje europiane të gjuhës së procedurës, përkthimi i gjuhës maqedonase do të

[34] Patent Cooperation Treaty (PCT) – Kontratë bashkëpunimi në fushën e lejeve, e nënshkruar më 19 qershor 1970 në Uashington, SHBA. Hyri në fuqi më 24 janar 1978.

zbatohet në të gjitha procedurat, përveç në procedurën e ankimimit pranë EEL-së [35].

Neni 123, paragrafi (2) - Paraqitësi, përkatësisht bartësi i lejes europiane mund t'i dorëzojë korrigjimet e përkthimit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, deri në përfundimin e procedurës së pranimit para EEL-së.

Konversimi i aplikimit nacional

Neni 125, paragrafi (1) - Aplikimi europian, për të cilën kërkohet mbrojtje në Republikën e Maqedonisë, mund të konvertohet në aplikim nacional, nëse ai konsiderohet si i tërhequr në pajtim me nenin 77, paragrafi (5) nga KEP-ja[36] ose nëse përkthimi i kërkesave të lejeve në pajtim me nenin 14, paragrafi (2) të KEP-it nuk është paraqitur në afatin e nenit 90, paragrafi (3) të KEP-it.

Neni 125, paragrafi (2) - Paraqitësi i aplikimit, sipas paragrafit (1) të këtij neni, obligohet pranë entit të dorëzojë përkthim të aplikimit në gjuhën maqedonase dhe t'i paguajë taksat dhe shpenzimet e parapara.

Aplikimi i rregullt

Neni 149, paragrafi (1), pika 3) - Aplikimi i dizajnit industrial është i rregullt nëse është: dorëzuar përkthimi i aplikimit në gjuhën maqedonase, nëse aplikimi është përpiluar në gjuhë të huaj.

[35] Enti europian i lejeve për zbatimin e procedurës për pranimin e lejeve europiane në pajtim me KEP-in.

[36] European Patent Convention (EPC), e njohur edhe si Convention on the Grant of European Patents. Konventa Evropiane e Lejeve (KEP), e nënshkruar më 5 tetor 1973 në Munih. Hyri në fuqi më 7 tetor 1977.

Nënvizimi tregtar
Lënda e mbrojtjes

Neni 175, paragrafi (1) - Me nënvizimin tregtar mbrohet shenja që mund të tregohet në mënyrë grafike dhe që është i përshtatshëm për dallimin e mallrave ose të shërbimeve të një pjesëmarrësi në qarkullim nga mallrat ose nga shërbimet e pjesëmarrësit tjetër në qarkullim.

Neni 175, paragrafi (2) - Me nënvizim tregtar mbrohen shenjat e përshtatshme për dallim, siç janë: fjalët, shkronjat, numrat, fotografitë, vizatimet, kombinimet e ngjyrave, format tredimensionale, përfshirë edhe format e mallrave ose paketimet e tyre, si dhe kombinimet e të gjitha shenjave të përmendura.

Neni 175, paragrafi (3) - Fjalët dhe shkronjat, sipas paragrafit (2) të këtij neni, mund të shkruhen në çfarëdo gjuhe dhe me çfarëdo alfabeti.

E drejta e unionit për përparësi

Neni 187, paragrafi (1) - Personit juridik apo fizik i cili në ndonjë nga vendet - anëtare të Unionit të Parisit[37] ose OBT-së[38] me rregull ka paraqitur aplikim, në Republikën e Maqedonisë do t'i pranohet e drejta e përparësisë nga dita e paraqitjes së aplikimit të parë, nëse këtë e kërkon në afat prej gjashtë muaj nga dita e paraqitjes së aplikimit të parë.

Neni 187, paragrafi (2) - Ai që ka për qëllim të shfrytëzojë të drejtën e përparësisë sipas paragrafit (1) të këtij neni, obligohet në aplikimin e paraqitur në Republikën e Maqedonisë t'i shënojë të

[37] Unioni i Parisit është union i themeluar në Paris Convention for the Protection of Industrial Property – Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale, i nënshkruar në Paris, Francë, më 28 mars 1883.

[38] Organizata Botërore e Tregtisë.

gjitha të dhënat e aplikimit për të cilën thirret (shteti, data dhe numri i aplikimit) dhe në afat prej 90 ditëve nga paraqitja e aplikimit të dorëzojë kopje nga aplikimi i parë i verifikuar nga organi kompetent i vendit - anëtar të Unionit të Parisit ose OBT-së, ku është paraqitur aplikimi i parë, si dhe përkthimi i aplikimit të parë në gjuhën maqedonase.

Aplikimi i personit të huaj

Neni 237- Personat e huaj që e paraqesin aplikimin në shtojcë të kërkesës për pranimin e emrit gjeografik, përkatësisht kërkesës për pranimin e të drejtës për shfrytëzim, dorëzojnë kopje të dokumentit publik apo të ndonjë aktit tjetër juridik në gjuhën zyrtare të vendit të prejardhjes, të lëshuar nga organi kompetent i vendit të prejardhjes, si dëshmi se emri gjeografik mbrohet në atë vend, përkatësisht se është pranuar e drejta e shfrytëzuesit të autorizuar në pajtim me legjislacionin nacional në vendin e prejardhjes, si dhe përkthim të verifikuar në gjuhën maqedonase.

5.30. Ligji i Sigurimit Shëndetësor [39]

Dëshmimi i cilësisë së personit të siguruar

Neni 27 - Për qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, me kërkesën e tyre personale shtypet formulari dhe të dhënat në të shkruhen edhe në gjuhën dhe alfabetin që e përdor qytetari.

5.31. Ligji i Mbikëqyrjes së Sigurimit[40]

Përmbajtja e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të polisave dhe njoftimet për polisat

Neni 52 - Teksti i kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të polisave dhe njoftimi sipas neneve 50 dhe 51 të këtij ligji, duhet të përpilohen në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme në gjuhën maqedonase.

[39] Ligji i Sigurimit Shëndetësor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 25/2000, 96/2000, 50/2001, 11/2002, 31/2003, 84/2005, 37/2006, 18/2007, 36/2007, 82/2008, 98/2008, 6/2009, 67/2009, 50/2010, 156/2010, 53/2011, 26/2012, 16/2013, 91/2013, 187/2013, 43/2014, 44/2014, 97/2014, 112/2014, 113/2014, 188/2014, 20/2015, 61/2015, 61/2015, 98/2015, 129/2015, 150/2015, 154/2015, 192/2015, 217/2015, 27/2016, 37/2016, 120/2016, 142/2016 и 171/2017 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019, 77/2021 и 285/2021).

[40] Ligji i Mbikëqyrjes së Sigurimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/2002, 79/2007, 88/2008, 67/2010, 44/2011, 112/2011, 188/2013, 43/2014, 112/2014, 153/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 198/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 101/2019 dhe 31/2020).

Mënyra e dhënies së informacioneve nga përfaqësuesi i sigurimit dhe brokeri i sigurimit

Neni 154-b, paragrafi (1), pika 3) - Të dhënat, sipas nenit 154-a të këtij ligji, kontraktuesit të sigurimit i jepen: në gjuhën maqedonase, përveç nëse nuk është pajtuar ndryshe.

5.32. Ligji i Evidencave në Fushën e Punës [41]

Neni 59 - Gjatë realizimit të të drejtave dhe obligimeve sipas këtij ligji, në komunikim me njësitë rajonale të organeve, do të zbatohen dispozitat e rregullit që do t'i përcaktojë çështjet për përdorimin e gjuhëve.

5.33. Ligji i Inspektimit Administrativ [42]

Kompetencat

Neni 2, paragrafi (1) - Inspektimi administrativ përfshin mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme

[41] Ligji i Evidencave në Fushën e Punës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 16/2004, 102/2008, 17/2011, 166/2012 dhe 147/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 18/2020).

[42] Ligji i Inspektimit Administrativ (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 69/2004, 22/2007, 115/2007, 51/2011, 164/2013, 41/2014, 33/2015, 156/2015, 193/2015, 53/2016 dhe 11/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2021).

Administrative, Ligjit të Mbikëqyrjes së Inspektimit dhe ligjeve të tjera që përmbajnë dispozita për procedurën administrative.

Neni 2, paragrafi (4), nënparagrafi 13 – Mbikëqyrja, sipas paragrafit 1 të këtij neni, përfshin mbikëqyrje mbi: përdorimin e gjuhëve të palëve në procedurë administrative, ndihmën juridike mes organeve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë administrative dhe gjëra të tjera të vërtetuara me Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative dhe ligjet e tjera.

5.34. Ligji i Sigurisë dhe i Shëndetit në Punë [43]

Neni 1, paragrafi (1) - Çdo punëdhënës duhet të përgatitë dhe të zbatojë deklaratë sigurie për çdo vend pune, duke e saktësuar mënyrën dhe masat që duhet të ndërmerren.

Neni 11, paragrafi (5) - Deklarata e sigurisë në vendin e punës përgatitet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhë tjetër që është zyrtare në rajonin e komunës.

[43] Ligji i Sigurisë dhe i Shëndetit në Punë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 92/2007, 136/2011, 23/2013, 25/2013, 137/2013, 164/2013, 158/2014, 15/2015, 129/2015, 192/2015 dhe 30/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 18/2020).

5.35. Ligji i Sigurisë së Produkteve Kozmetike [44]

Nënvizimi i produkteve kozmetike

Neni 14 - Të gjitha nënvizimet dhe udhëzimet e përdorimit duhet të jenë edhe në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, të shihen dhe të lexohen mirë, pa pasur mundësi që të fshihen.

5.36. Ligji i Sigurisë së Produkteve [45]

Masat e produkteve sipas këtij ligji

Neni 36, paragrafi (1), pika 1), nënparagrafi 1 - Nëse inspektori përkatës gjatë mbikëqyrjes konstaton se: për çdo produkt, sipas këtij ligji, që mund të paraqesë rrezik në kushte të caktuara, do të marrë masa duke marrë vendim: me të cilin do të urdhërojë që produkti të nënvizohet me paralajmërime të përshtatshme dhe të shkruara qartë dhe lehtësisht të kuptueshme në gjuhën maqedonase, që nuk e përjashton mundësinë e përdorimit të gjuhëve të tjera që janë në përdorim zyrtar në Bashkimin Europian për rreziqet që ai mund t'i shkaktojë.

[44] Ligji i Sigurisë së Produkteve Kozmetike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 55/2007, 47/2011 dhe 150/2015).

[45] Ligji i Sigurisë së Produkteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 33/2006, 63/2007, 24/2011, 51/2011, 148/2011, 164/2013, 152/2015, 53/2016 dhe 140/2018).

5.37. Ligji i Sigurisë së Ushqimit [46]

Shtesat e të ushqyerit

Neni 54, paragrafi (3) - Operatori i ushqimit duhet të kërkojë nga agjencia mendim për harmonizimin e kërkesave të parapara për përbërjen dhe nënvizimin e secilit produkt që synon ta vendosë në tregun e Republikës së Maqedonisë gjatë prodhimit ose importit të shtesave ushqimore. Operatori i ushqimit për kërkesën e paraqitur për marrjen e mendimit paguan kompensim në shumën e shpenzimeve të bëra për lëshimin e tij.

Neni 54, paragrafi (4), pika 2) - Në shtojcën e kërkesës, sipas paragrafit (3) të këtij neni, duhet të sigurohen këto dëshmi: nënvizimi i gjuhës maqedonase me të gjitha informacionet për produktin në pajtim me nënvizimin origjinal.

Ushqimi për përdorim të veçantë nutritiv

Neni 54-a, paragrafi (3) - Operatori i ushqimit duhet të kërkojë nga agjencia mendim për harmonizimin e kërkesave të parapara për përbërjen dhe nënvizimin e secilit produkt që synon ta vendosë në tregun e Republikës së Maqedonisë gjatë prodhimit ose importit të ushqimit për përdorim të veçantë nutritiv. Operatori i ushqimit për kërkesën e paraqitur për marrjen e mendimit paguan kompensim në shumën e shpenzimeve të bëra për lëshimin e tij.

Neni 54, paragrafi (4), pika 2) - Në shtojcën e kërkesës, sipas paragrafit (3) të këtij neni, operatori i ushqimit duhet t'i sigurojë

[46] Ligji i Sigurisë së Ushqimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 157/2010, 53/2011, 1/2012, 164/2013, 187/2013, 43/2014, 72/2015, 129/2015, 213/2015, 39/2016 dhe 64/2018).

këto dëshmi: nënvizimin e gjuhës maqedonase me të gjitha informacionet për produktin në pajtim me nënvizimin origjinal.

Ushqim i pasuruar

Neni 54-b, paragrafi (3) - Operatori i ushqimit duhet të kërkojë nga agjencia mendim për harmonizimin e kërkesave të parapara për përbërjen dhe nënvizimin e secilit produkt që synon ta vendosë në tregun e Republikës së Maqedonisë gjatë prodhimit ose importit të ushqimit të pasuruar, përkatësisht/ose ushqim të cilit i janë shtuar vitamina, minerale dhe substanca të tjera. Operatori i ushqimit për kërkesën e dorëzuar për marrjen e mendimit paguan kompensim në shumën e shpenzimeve të bëra për lëshimin e tij.

Neni 54-b, paragrafi (4), pika 2) - Në shtojcën e kërkesës, sipas paragrafit (3) të këtij neni, operatori i ushqimit duhet t'i sigurojë këto dëshmi: nënvizimin e gjuhës maqedonase me të gjitha informacionet për produktin në pajtim me nënvizimin origjinal.

Ushqimi dhe përbërësit e ushqimit të prodhuar me teknologji inovative

Neni 55, paragrafi (5) - Operatori i ushqimit duhet të dorëzojë kërkesë pranë agjencisë për miratimin e çdo produkti që synon ta vendosë në qarkullim në tregun e Republikës së Maqedonisë gjatë prodhimtarisë ose importit të ushqimit dhe përbërësve të ushqimit, të prodhuara m teknologji inovative.

Neni 55, paragrafi (6), pika 6) - Në shtojcën e kërkesës, sipas paragrafit (5) të këtij neni, operatori i ushqimit duhet t'i sigurojë këto dëshmi: nënvizimin e gjuhës maqedonase, në pajtim me nenin 5 të Rregullores së kërkesave të veçanta për sigurinë e ushqimit të prodhuar me teknologji inovative.

Ushqimi i prodhuar me rrezatim jonizues dhe lloje të tjera të ushqimit

Neni 57, paragrafi (9) - Operatori i ushqimit mund të mbushë apo të vendosë në qarkullim ujë natyral mineral, ujë burimi dhe ujë tjetër të ambalazhuar, që i plotëson kërkesat e veçanta për siguri, vetëm me miratim të lëshuar paraprak për produktin nga agjencia në bazë të kërkesës së dorëzuar.

Neni 57, paragrafi (10), pika 5) - Në shtojcën e kërkesës, sipas paragrafit (9) të këtij neni, operatori i ushqimit duhet t'i sigurojë këto dëshmi: nënvizimin e gjuhës maqedonase.

5.38. Ligji i Sigurisë së Ushqimit të Kafshëve[47]

Vendosja në qarkullim e lëndëve të para për ushqim kafshësh

Neni 35, paragrafi (2) - Lëndët e para për ushqimin e kafshëve nuk mund të vendosen në qarkullim nëse nuk tregohen veçoritë minimale të tyre, që duhet të jenë të dukshme, të lexueshme dhe të mos mund të fshihen, dhe për të cilat prodhuesit, paketuesit, importuesit, shitësit ose shpërndarësit me seli në Republikën e Maqedonisë janë përgjegjës, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, në dokumentin shoqërues ose ku është vendi përkatës në paketim, kontejner ose në etiketën e ngjitur.

[47] Ligji i Sigurisë së Ushqimit të Kafshëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/2010, 53/2011, 1/2012, 33/2015, 149/2015 dhe 53/2016).

Nënvizimi i detyrueshëm i theksimit të përzierjeve të tagjisë

Neni 38, paragrafi (1) - Përzierjet e tagjisë nuk mund të vendosen në qarkullim nëse nuk tregohet veçoritë minimale të tyre, që duhet të jenë të dukshme, të lexueshme dhe të mos mund të fshihen, dhe për të cilat prodhuesit, paketuesi, importuesi, shitësi ose shpërndarësi me seli në Republikën e Maqedonisë janë përgjegjës, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, në dokumentin shoqërues ose ku është vendi përkatës në paketim, kontejner ose në etiketën e ngjitur, sidomos:

Nënvizimi dhe paketimi i aditivëve të ushqimit për kafshët dhe premikset e tyre

Neni 50, paragrafi (1) - Aditivët e ushqimit të kafshëve ose premikset e aditivëve mund të vendosen në qarkullim nëse paketimi ose kontejneri i tyre është i nënvizuar me përgjegjësi nga prodhuesi, paketuesi, importuesi, shitësi ose shpërndarësi, me seli në Republikën e Maqedonisë dhe përmban informacione përkatëse, që duhet të jenë të dukshme, të lexueshme, të mos mund të fshihen, të shkruara në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

5.39. Ligji i Cilësisë dhe i Sigurisë së Plehrave, i Biostimuluesve dhe i Përmirësuesve të Veçorive të Tokës [48]

Deklarimi dhe nënvizimi

Neni 29, paragrafi (1) - Plehu që importohet dhe plasohet në treg duhet të ketë deklaratë në bazë të së cilës mund të bëhet identifikimi i tij.

Neni 29, paragrafi (2) – Deklarata, sipas paragrafit (1) të këtij neni, shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, përveç emërtimeve të mbrojtura tregtare të plehut, simbolet kimike të elementeve ushqyese, emri i prodhuesit dhe njësisë nga sistemi SI, që shtypen në alfabetin cirilik.

Kompetencat e Inspektoratit Shtetëror të Bujqësisë

Neni 49, paragrafi (2), pika 9) - Inspektorati Shtetëror i Bujqësisë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes mund të: marrë pleh, biostimulues dhe përmirësues të veçorive të tokës, që kanë afat të skaduar, nuk janë me paketim origjinal të prodhuesit, nëse deklarata nuk është në përputhje me vendimin për evidentim në listën e plehrave, deklarata nuk është shtypur në gjuhën maqedonase dhe nuk është e nënvizuar në mënyrën e duhur, nëse është konstatuar parregullsi gjatë plasimit në treg.

[48] Ligji i Cilësisë dhe i Sigurisë së Plehrave, i Biostimuluesve dhe i Përmirësuesve të Tokës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 27/2014, 154/2015 dhe 39/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.150/2021).

5.40. Ligji i Automjeteve [49]

Dhënia e lejes se qarkullimit

Neni 33, paragrafi (2) - Formulari i lejes së qarkullimit shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën angleze dhe në alfabetin e saj.

Neni 33, paragrafi (3) - Të dhënat në formularin e lejes së qarkullimit shkruhen ë gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në alfabetin elementar latin (ICAO Doc.9303).

Neni 33, paragrafi (4)- Për qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, me kërkesën e tyre personale, në formularin për lejen e qarkullimit shtypen edhe të dhënat për emrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin apo selinë e personit juridik, shkruhen edhe në gjuhën zyrtare dhenë alfabetin që e përdor qytetari.

Neni 33, paragrafi (5) - Për qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, me kërkesën e tyre personale, në formularin për lejen e qarkullimit shtypen edhe të dhënat për emrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin apo selinë e personit juridik, shkruhen edhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që e përdor qytetari dhe në alfabetin elementar latin (ICAO Doc.9303).

[49] Ligji i Automjeteve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 140/2008, 53/2011, 123/2012, 70/2013, 164/2013, 138/2014, 154/2015, 192/2015 dhe 39/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 161/2019 dhe 161/2019).

5.41. Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale [50]

Përdorimi i gjuhës

Neni 64, paragrafi (1) - Radiodifuzerët obligohen të emetojnë programin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, ndërkaq, në rastet kur programi i dedikohet komunitetit joshumicë, edhe në gjuhën dhe në alfabetin e atij komuniteti.

Neni 64, paragrafi (2) - Nëse shërbimet programore që riemetohen nëpërmjet rrjeteve publike elektronike të komunikimit titrohen në gjuhë të ndryshme nga gjuha në të cilën janë prodhuar në origjinal, patjetër duhet të titrohen në gjuhën maqedonase ose në gjuhën e komunitetit joshumicë, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, përveç teleshopingut dhe reklamave.

Neni 64, paragrafi (3) – Programet në gjuhë të huaja ose pjesët që emetohen në programet e radiodifuzerëve duhet të përkthehen në gjuhën maqedonase, përkatësisht në gjuhën e komunitetit joshumicë.

Neni 64, paragrafi (4) - Dispozitat e paragrafit (3) të këtij neni nuk kanë të bëjnë me transmetimet e ngjarjeve muzikore dhe skenike, programeve edukative për mësimin e gjuhës së huaj, si dhe pjesëve të programeve të destinuara për të huaj.

[50] Ligji i Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013, 13/2014, 44/2014, 101/2014, 132/2014, 142/2016, 132/2017, 168/2018, 248/2018 dhe 27/2019 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/2020 dhe 77/2021).

Neni 64, paragrafi (5) - Pjesët e programeve që nuk përkthehen, paralajmërohen në gjuhën maqedonase, përkatësisht në gjuhën e komunitetit joshumicë.

5.42. Ligji i Dhënies së Shërbimeve Financiare në Distancë[51]

Kontratë në distancë

Neni 6, paragrafi (1), pika 3), nënpika e - Para se konsumatori të obligohet me ofertë dhe/ose kontratë në distancë, ofruesi obligohet t'ia sigurojë informacionet në lidhje me kontratën në distancë: gjuhën ose gjuhët në të cilat janë dorëzuar kushtet e kontratës në distancë dhe informacionet e mëparshme nga ky ligj dhe gjuhën ose gjuhët në të cilat ofruesi obligohet në kontratë të komunikojë me konsumatorin gjatë kohëzgjatjes së kontratës në distancë.

5.43. Ligji i Kulturës[52]

Neni 11-a, paragrafi (2) - Qeveria e Republikës së Maqedonisë në mënyrë solemne u ndan pllakë fituesve të titullit Ambasador i Kulturës i Republikës së Maqedonisë. Titulli Ambasador i Kulturës i Republikës së Maqedonisë është titull nderi dhe pa kompensim në të holla.

---

[51] Ligji i Dhënies së Shërbimeve Financiare në Distancë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 158/2010 dhe 153/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 122/2021).

[52] Ligji i Kulturës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 31/1998, 49/2003, 82/2005, 24/2007, 116/2010, 47/2011, 51/2011, 136/2012, 23/2013, 187/2013, 44/2014, 61/2015, 154/2015, 39/2016, 11/2018 dhe 11/2018).

Neni 11-a, paragrafi (3) - Pllaka që u ndahet pjesëtarëve të komunitetit etnik që është mbi 20% në Republikën e Maqedonisë, përveç në gjuhën maqedonase, ndahet edhe në gjuhën që e flet pjesëtari i atij komuniteti.

5.44. Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit[53]

Neni 7, paragrafi (1), nënparagrafi 4 - Në realizimin e kompetencave sipas nenit 6, pika 1 dhe pika 2 të këtij ligji, byroja i kryen këto detyra: - i propozon ministri të Arsimit dhe të Shkencës programe mësimore të përshtatura dhe të përkthyera në gjuhën në të cilën realizohet mësimi në Republikën e Maqedonisë nga Qendra Ndërkombëtare e Programeve Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) për arsimin fillor dhe të mesëm, në pajtim me ligjin.

5.45. Ligji i Arsimit të Lartë[54]

Diploma dhe shtojca e diplomës

Neni 155, paragrafi (8) - Vërtetimi, legjitimacioni dhe indeksi i studentit për pjesëtarët e komunitetit që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe që vijojnë mësimet në gjuhë zyrtare të ndryshme

[53] Ligji i Byrosë së Zhvillimit të Arsimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 37/2006, 142/2008, 148/2009, 69/2013, 120/2013, 148/2013, 41/2014, 30/2016 и 64/2018).

[54] Ligji i Arsimit të Lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 178/2021).

nga maqedonishtja, lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e atij komuniteti.

Neni 155, paragrafi (9) - Diploma dhe shtojca e diplomës për pjesëtarët e komunitetit që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe të cilët mësimin e ndjekin në gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e atij komuniteti, nëse është e përcaktuar me statutin e universitetit.

Përmbajtja e programeve studimore

Neni 140, paragrafi (1), pika 1) - Programi studimor përmban së paku: emërtimin e programit studimor në gjuhën maqedonase dhe atë angleze sipas klasifikimit të Fraskatit të rajoneve, të fushave dhe të zonave shkencore. Nëse programi studimor realizohet në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, që e përdorin pjesëtarët e komuniteteve në Republikën e Maqedonisë, emri i programit studimor është në atë gjuhë, në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën angleze.

Gjuhët në të cilat realizohet mësimi

Neni 144, paragrafi (1) - Mësimi në institucionet e arsimit të lartë realizohet në gjuhën maqedonase.

Neni 144, paragrafi (2) - Pjesëtarët e komuniteteve, për të shprehur, kultivuar dhe zhvilluar identitetin e tyre dhe veçoritë e tjera, kanë të drejtë të japin mësim në institucionet e arsimit të lartë publik sipas programeve dhe përmbajtjeve përkatëse të studimit, në gjuhën e komunitetit, e ndryshme nga maqedonishtja, në pajtim me këtë ligj dhe statutin e institucionit të arsimit të lartë. Financimi nga shteti do të sigurohet për

arsimin e lartë dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e popullsisë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 144, paragrafi (3) - Mësimi në institucionet e arsimit të lartë pedagogjik publik për arsimin e edukatorëve parashkollorë dhe të arsimtarëve të arsimit fillor, si dhe lëndët didaktike-metodologjike për mësuesit e arsimit të mesëm, mund të zhvillohet në gjuhët e anëtarëve të komuniteteve të tjera që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 144, paragrafi (4) - Me përjashtim, sipas paragrafit (1) të këtij neni, arsimi në institucionet e arsimit të lartë mund të zhvillohet në një nga gjuhët botërore.

Neni 144, paragrafi (5) - Mësimi në institucionet private të arsimit të lartë mund të zhvillohet edhe në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhët botërore.

Neni 144, paragrafi (6) - Kur mësimi zhvillohet në gjuhët e pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë ose në gjuhët botërore, në pajtim me paragrafët (2), (3) dhe (4) të këtij neni, gjuha maqedonase mësohet si lëndë e veçantë dhe mësimi zhvillohet në këtë gjuhë për të paktën edhe dy lëndë të programit studimor.

5.46. Ligji i Arsimit të të Moshuarve[55]

Neni 18, paragrafi (1), nënparagrafi 2 - Programet e veçanta për arsimin e të moshuarve sipas nenit 17, paragrafi (3) të këtij ligji janë për: gjuhën amtare dhe gjuhët e huaja.

Dokumentacioni dhe evidenca

Neni 25, paragrafi (1) - Institucionet për arsimin e të moshuarve mbajnë dokumentacion dhe evidencë.

Neni 25, paragrafi (2) – Dokumentacioni, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mbahet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe alfabetin në të cilin realizohet programi për arsimin e të moshuarve. Evidenca, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mbahet në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin realizohet programi për arsimin e të moshuarve.

5.47. Ligji i Arsimit Fillor[56]

Qëllimet e arsimit fillor

Neni 7, paragrafi (1), nënparagrafi 6 - Qëllimet e arsimit fillor janë: zhvillimi i shkrim-leximit dhe aftësive të nxënësve për të kuptuar, informuar dhe shprehur në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

[55] Ligji i Arsimit të të Moshuarve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2008, 17/2011, 51/2011, 74/2012, 41/2014, 144/2014, 146/2015, 30/2016 dhe 64/2018).

[56] Ligji i Arsimit Fillor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 161/2019 dhe 229/2020).

Neni 7, paragrafi (1), nënparagrafi 6 - Qëllimet e arsimit fillor janë: zhvillimi i shkrim-leximit dhe aftësive të nxënësve për të kuptuar, informuar dhe shprehur, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, si dhe gjuhës dhe alfabetit të pjesëtarëve të komuniteteve që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja.

Përdorimi i gjuhëve në arsim

Neni 10, paragrafi (1) - Puna edukativo-arsimore në shkollën fillore realizohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 10, paragrafi (2) - Për nxënësit e pjesëtarëve të komuniteteve të cilët e vijojnë mësimin në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja dhe në alfabetin e saj cirilik, puna edukative kryhet në gjuhën dhe në alfabetin e komunitetit përkatës.

Neni 10, paragrafi (3) – Nxënësit, sipas paragrafit (2) të këtij neni, në mënyrë të obliguar mësojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik.

Arsimi i fëmijëve të shtetasve që qëndrojnë jashtë shtetit

Neni 12, paragrafi (1) - Për fëmijët e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut që qëndrojnë jashtë vendit, organizohet mësim për mësimin e gjuhës dhe të kulturës maqedonase, ndërkaq, për pjesëtarët e komuniteteve që flasin gjuhë tjetër nga maqedonishtja dhe gjuhën amtare, në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 12, paragrafi (2) - Punën edukativo-arsimore për qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që janë me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm jashtë vendit, e kryejnë mësimdhënësit të cilët, përveç kushteve të përcaktuara me këtë ligj, kanë së paku pesë vjet përvojë pune në mësimdhënie,

shquhen në punën edukative- arsimore dhe e njohin gjuhën e vendit në të cilin do të japin mësim.

Neni 12, paragrafi (3) - Fëmijët e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilët kanë qëndruar jashtë vendit dhe janë kthyer në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku e fillojnë, përkatësisht e vazhdojnë arsimin fillor, shkollat fillore janë të obliguara t'u ndihmojnë në mësimin e gjuhës amtare dhe në gjuhën në të cilën do ta ndjekin mësimet.

Neni 12, paragrafi (4) - Për përfshirje të suksesshme në procesin edukativ-arsimor të nxënësve sipas paragrafit (3) të këtij neni, shkolla fillore, ku është regjistruar nxënësi, organizon orë shtesë individuale dhe grupore për përvetësimin e gjuhës amtare dhe gjuhën në të cilën do ta ndjekë mësimin dhe për kompensimin e njohurive në lëndë të caktuara.

Arsimi i fëmijëve me shtetësi të huaj ose fëmijëve pa shtetësi

Neni 13, paragrafi (1) - Fëmijët me shtetësi të huaj ose fëmijët pa shtetësi, fëmijët refugjatë, azilkërkuesit, fëmijët me status të njohur të refugjatit, fëmijët nën mbrojtje plotësuese dhe fëmijët nën mbrojtje të përkohshme që banojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut, kanë të drejtë për arsimim fillor në kushte të barabarta si fëmijët qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 13, paragrafi (2) - Për fëmijët, sipas paragrafit (1) të këtij neni, organizohet mësimi i gjuhës maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe përkrahje për kompensimin e njohurive nga lëndë të caktuara për së paku një vit në bazë të programeve të përgatitura nga byroja dhe të miratuara nga ministri.

Neni 13, paragrafi (3) – Fëmijët, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, kanë të drejtë për arsim fillor në kushte të

barabarta si fëmijët, qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Neni 13, paragrafi (4) – Fëmijët, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, prindërit e të cilëve, përkatësisht kujdestarët, janë me qëndrim në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku kryejnë ose kanë kryer veprimtari të pavarur, përkatësisht të cilët janë të punësuar ose kanë qenë të punësuar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kanë të drejtë të marrin njohuri për gjuhën amtare dhe kulturën e vendit prej ku e kanë prejardhjen.

Neni 13, paragrafi (5) - Ministria në bashkëpunim me themeluesin e shkollës dhe vendin e prejardhjes së nxënësit, sipas paragrafit (3) të këtij neni dhe në pajtim me mundësitë, ofron mbështetje për përvetësimin e njohurive të gjuhës amtare dhe kulturës së vendit nga ku e ka prejardhjen nxënësi.

Arsimi i fëmijëve që nuk janë përfshirë në mësim

Neni 14, paragrafi (1) - Fëmijët që nuk kanë qenë të përfshirë në mësim dhe që janë mbi pragun e moshës së përcaktuar për t'u përfshirë në klasën përkatëse të arsimit fillor, kanë të drejtë për arsim fillor me kushte të barabarta si fëmijët e tjerë.

Neni 14, paragrafi (2),- Për fëmijët, sipas paragrafit (1) të këtij neni, përgatiten programe arsimore të përshtatura, që do të mundësojnë përfshirjen në klasën përkatëse të arsimit fillor.

Vendi i organizimit dhe i realizimit të arsimit fillor

Neni 15, paragrafi (6),- Arsimin fillor në institucionet shëndetësore dhe në institucionet ndëshkuese-përmirësuese dhe edukative-përmirësuese, e realizon shkolla që është më afër institucionit dhe mësimin e realizon në gjuhën amtare të nxënësit në këto

institucione, ndërkaq në kushte shtëpiake shkolla ku është regjistruar nxënësi.

Gjuha dhe alfabeti i emrit të shkollës fillore

Neni 21, paragrafi (1) - Emri i shkollës fillore shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 21, paragrafi (2) - Në shkollat fillore ku mësimi realizohet edhe në gjuhë tjetër dhe në alfabet të ndryshëm nga ai i gjuhës maqedonase, emri i shkollës shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në alfabetin në të cilin realizohet mësimi.

Akti i themelimit të shkollës fillore

Neni 24, paragrafi (1), nënparagrafi 5 - Me aktin e themelimit të shkollës fillore vërtetohen: gjuha/gjuhët në të cilën do të realizohet mësimi.

Zhvillimi i multikulturalizmit/interkulturalizmit dhe integrimi ndëretnik

Neni 46, paragrafi (1),- Drejtori i shkollës formon ekip për integrim në shkollë për periudhë trivjeçare, i përbërë nga pesë deri në shtatë anëtarë, përkatësisht kryetari i Parlamentit të Nxënësve, Avokati i Popullit të Nxënësve dhe nga radhët e bashkëpunëtorëve profesionalë dhe mësimdhënësve. Drejtori ose ndihmësdrejtori është anëtar i ekipit të integrimit të shkollës sipas funksionit. Me rastin e formimit të ekipit për integrim në shkollë, drejtori kujdeset për përfaqësimin e mësimdhënësve, nga të gjitha gjuhët në të cilat realizohet mësimi në shkollë.

Neni 46, paragrafi (2) - Ekipi për integrim në shkollë planifikon dhe organizon aktivitete që kontribuojnë në respektimin e

multikulturalizmit dhe në zhvillimin e dialogut ndërkulturor dhe zhvillimin e integrimit ndëretnik.

Neni 46, paragrafi (3),- Ekipi për integrim në shkollë në bashkëpunim me mësimdhënësit duhet të përgatisë plan për aktivitetet që do të planifikohen në programin vjetor të shkollës me qëllim të promovimit të ndërkulturalizmit, të njohjes së ngjashmërive, të pranimit të dallimeve, të luftimit të stereotipeve dhe të paragjykimeve.

Neni 46, paragrafi (4) - Kriteret bazë sipas të cilave duhet të organizohet aktiviteti, sipas paragrafit (2) të këtij neni, konsiderohet aktiviteti që ka për qëllim ndërveprimin, përkatësisht integrimin e grupeve pjesëmarrëse të përziera etnike/gjuhësore, grupe të baraspeshuara pjesëmarrëse sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe moshës, ndërveprimi mes pjesëmarrësve të grupeve të ndryshme etnike/gjuhësore (gjatë aktivitetit nxënësit e njërit grup mësimor etnik/gjuhësor bashkëpunojnë me nxënësit e grupit tjetër mësimor etnik/gjuhësor, shfrytëzimi i gjuhëve të përfaqësuara, trajtimi i barabartë i pjesëmarrësve nga të gjitha grupet etnike/gjuhësore, arritja e qëllimeve konkrete të përbashkëta (produkte të prekshme/të dukshme) me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve të përfaqësuara etnike.

<u>Realizimi i mësimit</u>

Neni 54, paragrafi (6) - Mësimin në klasën e katërt e realizon mësimdhënësi i klasës ose pedagogu, përveç mësimit në gjuhën angleze dhe mësimit në gjuhën maqedonase për nxënësit e pjesëtarëve të komuniteteve që mësimin e realizojnë në gjuhën dhe në alfabetin e ndryshëm nga maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik.

Neni 54, paragrafi (7),- Mësimin në klasën e pestë e vazhdon mësimdhënësi i klasës ose pedagogu, përveç mësimit në gjuhën

angleze dhe mësimit në gjuhën maqedonase për nxënësit nga komuniteti që mësimin e realizojnë në gjuhën dhe në alfabetin e ndryshëm nga maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik, ndërkaq në shkencat natyrore dhe në arsimin teknik përfshihen mësimdhënës të lëndëve.

Mënyra e mbajtjes së dokumentacionit pedagogjik

Neni 93, paragrafi (1) - Dokumentacioni pedagogjik, sipas nenit 92, paragrafi (2) të këtij ligji, mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 93, paragrafi (2) - Për nxënësit e komuniteteve që mësimin e realizojnë në gjuhën dhe në alfabetin e ndryshëm nga maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik, dokumentacioni pedagogjik, sipas paragrafit (1) të këtij neni, mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

Neni 93, paragrafi (3) - Ditari i klasës mbahet në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

5.48. Ligji i Arsimit të Mesëm[57]

Neni 4, paragrafi (1) - Veprimtaria edukative-arsimore në shkollën e mesme zhvillohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 4, paragrafi (2) - Për pjesëtarët e komuniteteve që e ndjekin mësimin në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja dhe alfabetin e saj cirilik, veprimtaria edukative-arsimore në shkollat e mesme publike kryhet në gjuhën dhe alfabetin e komunitetit përkatës në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara me këtë ligj.

Neni 24-c, paragrafi (1) - Shkollat mund të organizojnë aktivitete që kontribuojnë në zhvillimin dhe promovimin e multikulturalizmit, të integrimit ndëretnik dhe të tolerancës.

Neni 24-c, paragrafi (2) - Kriteret bazë sipas të cilave duhet të organizohet aktiviteti, sipas paragrafit (2) të këtij neni, konsiderohet aktiviteti që ka për qëllim ndërveprimin, përkatësisht integrimin e grupeve pjesëmarrëse të përziera etnike/gjuhësore, grupe të baraspeshuara pjesëmarrëse sipas përkatësisë etnike, gjinisë dhe moshës, ndërveprimi mes pjesëmarrësve të grupeve të ndryshme etnike/gjuhësore (gjatë aktivitetit nxënësit e njërit grup mësimor etnik/gjuhësor kontaktojnë me nxënësit e grupit tjetër mësimor etnik/gjuhësor, shfrytëzimi i gjuhëve të përfaqësuara, trajtimi i barabartë i

[57] Ligji i Arsimit të Mesëm (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 dhe 64/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 229/2020).

pjesëmarrësve nga të gjitha grupet etnike/gjuhësore, arritja e qëllimeve konkrete të përbashkëta (produkte të prekshme/të dukshme) me pjesëmarrjen e të gjitha komuniteteve të përfaqësuara etnike.

Evidenca pedagogjike dhe dokumentacioni

Neni 74, paragrafi (1) - Dokumentacioni pedagogjik në shkollat e mesme mbahet dhe publikohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 74, paragrafi (2) - Për pjesëtarët e komuniteteve që mësimin e ndjekin në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, dokumentacioni pedagogjik mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin në të cilën zhvillohet mësimi.

Neni 74, paragrafi (3) - Ditari i klasës mbahet në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin zhvillohet mësimi.

Neni 74, paragrafi (4) - Ditarin e paraleles mësimdhënësi e mban detyrimisht në formë elektronike (ditar elektronik) në baza javore, nëpërmjet ueb-aplikacionit që e administron ministria.

5.49. Ligji i Librave të Arsimit Fillor dhe të Mesëm [58]

Neni 5-a, paragrafi (1),- Në arsimin fillor dhe të mesëm për lëndët mësimore mund të përdoren libra përkatës të përshtatur dhe të përkthyer nga Qendra Ndërkombëtare e Programeve Mësimore të Kembrixhit (Cambridge International Examinations) (në tekstin e mëtejmë: libra të përshtatur nga jashtë), të përkthyer në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në Republikën e Maqedonisë.

Neni 5-a, paragrafi (2) - Në arsimin e mesëm profesional për lëndët mësimore mund të përdoren tekste përkatëse të përshtatura nga jashtë, të harmonizuara me programet mësimore të miratuara nga ministri në pajtim me nenin 22, paragrafi 1 të Ligjit të Arsimit të Mesëm dhe të përkthyer në gjuhët në të cilat realizohet mësimi në Republikën e Maqedonisë.

Neni 14-a, paragrafi (1) - Nëse konstatohet se tekstet e miratuara shkollore kërkojnë korrigjime ose plotësime të caktuara nga aspekti profesional, metodologjik, teknik, si dhe nga aspekti i përkthimit dhe i përshtatjes dhe ato nuk përfaqësojnë më shumë se 30 % të përmbajtjes së librit, shërbimi pedagogjik paraqet kërkesë te botuesit, përkatësisht autorët që të propozojnë korrigjime dhe/ose shtesa në tekstin e librit brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës.

Neni a4-a, paragrafi (6) - Nëse komisioni, sipas paragrafit (5) të këtij neni, jep mendim pozitiv, ministri merr vendim me të cilin vërteton se vazhdon të vlejë vendimi për përdorimin e librit.

[58] Ligji i Librave të Arsimit Fillor dhe të Mesëm (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 98/2008, 99/2009, 83/2010, 36/2011, 135/2011, 46/2012, 24/2013, 120/2013, 29/2014, 146/2015, 217/2015, 30/2016 dhe 21/2018).

Neni 14-a, paragrafi (7) - Në bazë të vendimit, sipas paragrafit (6) të këtij neni, botuesi obligohet ta botojë librin me korrigjimet apo me plotësimet ose të shtypë shtojcë të librit që i përmban korrigjimet, përkatësisht plotësimet në të gjitha gjuhët në të cilët është botuar libri.

5.50. Ligji i Prokurorisë Publike [59]

Neni 4, paragrafi (2) - Prokuroria Publike në kryerjen e funksioneve të saj në mënyrë përkatëse zbaton dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

Neni 4, paragrafi (4) - Deklarata solemne jepet në gjuhën maqedonase dhe nënshkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 4, paragrafi (5) - Me rastin e dhënies dhe nënshkrimit të deklaratës solemne nga ndonjë prokuror publik, pjesëtar i komunitetit, i cili flet gjuhën zyrtare të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, zbatohen dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve.

[59] Ligji i Prokurosisë Publike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 42/2020).

5.51. Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve [60]

Neni 64, paragrafi (7) - Në kopshtin e fëmijëve aktivitetet realizohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 64, paragrafi (8) - Për fëmijët e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera, aktivitetet edukative- arsimore në kopshtet e fëmijëve realizohen në gjuhën e komunitetit përkatës për një grup fëmijësh, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 64, paragrafi (9) - Nëse ka interes për realizimin e aktiviteteve në gjuhë të tjera, aktivitetet edukative-arsimore në kopshtet e fëmijëve mund të realizohen për një grup fëmijësh në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 74, paragrafi (4) - Në qendrën për zhvillimin e hershëm të fëmijëve aktivitetet realizohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 74, paragrafi (5) - Për fëmijët e pjesëtarëve të komuniteteve të tjera, aktivitetet edukative- arsimore në qendrat për zhvillimin e hershëm të fëmijëve realizohen në gjuhën e komunitetit përkatës, për një grup fëmijësh, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 74, paragrafi (6) - Nëse ka interes për kryerjen e aktiviteteve në gjuhë të tjera, aktivitetet edukative dhe arsimore në qendrat për zhvillim të hershëm të fëmijëve mund të kryhen për një grup të fëmijëve në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

---

[60] Ligji i Mbrojtjes së Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 23/2013, 12/2014, 44/2014, 144/2014, 10/2015, 25/2015, 150/2015, 192/2015, 27/2016, 163/2017, 21/2018 dhe 198/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 104/2019, 146/2019, 275/2019, 311/2020 dhe 294/2021).

Neni 195, paragrafi (7) - Dokumentacioni pedagogjik në kopshtin e fëmijëve është në gjuhën maqedonase me në alfabet cirilik.

Neni 195, paragrafi (8) - Për pjesëtarët e komuniteteve që aktivitetet edukative-arsimore i kryejnë në gjuhën e komunitetit përkatës, dokumentacioni pedagogjik është në gjuhën maqedonase duke përdorur alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën dhe alfabetin në të cilin zhvillohet aktiviteti edukativ-arsimor.

Neni 195, paragrafi (9) - Ditari i punës është në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin realizohet aktiviteti edukativ-arsimor.

5.52. Ligji i Mbrojtjes së Konsumatorëve [61]

Garancia dhe shërbimi

Neni 22, paragrafi (1) - Tregtari obligohet, sipas dispozitave teknike me të cilat përcaktohen produktet për të cilat prodhuesi, importuesi, përkatësisht përfaqësuesi i kompanisë së huaj duhet të lëshojë garanci për cilësinë, përkatësisht për funksionimin e rregullt të produktit, dokument për mënyrën e përdorimit të produktit, të sigurojë shërbim për mirëmbajtjen dhe riparimin, si dhe furnizimin me pjesë rezeve në afatin e garancisë. Tregtari obligohet të paktën për pesë vite nga dita e prodhimtarisë së produktit, por jo më pak se dy vite nga dita e skadimit të garancisë së produktit, të sigurojë pjesë rezervë. Në pajtim me konsumatorin, produkti mund të shërbehet (servisohet) të paktën

[61] Ligji i Mbrojtjes së Konsumatorëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 38/2004, 77/2007, 103/2008, 24/2011, 164/2013, 97/2015, 152/2015 dhe 140/2018).

tri herë në suazat e afatit të garancisë dhe nëse nuk riparohet produkti, konsumatori ka të drejtë të kërkojë nga tregtari ta zëvendësojë me një tjetër produkt të ri të rregullt ose t'ia kthejë shumën e paguar konsumatorit për produktin e blerë.

Neni 22, paragrafi (6) – Dokumentet, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të jenë të shkruara dhe të lexueshme në mënyrë të qartë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, që nuk e përfshin mundësinë e përdorimit edhe të gjuhëve të tjera dhe të shenjave që mund të kuptohen lehtë nga konsumatori.

Deklarata

Neni 23, paragrafi (3) - Të gjitha të dhënat në deklaratë duhet të jenë të sakta, të dukshme dhe të lexueshme, të shkruara në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, që nuk e përfshin mundësinë e përdorimit edhe të gjuhëve të tjera dhe të shenjave që mund të kuptohen lehtë nga konsumatori.

Sanksionet kundërvajtëse

Neni 136, paragrafi (1), pika 14),- Gjobë në vlerë prej 4000 eurove në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet si kundërvajtje personit juridik, përkatësisht tregtarit individual, nëse: dokumentet sipas nenit 22 paragrafi 1 të këtij ligji, nuk janë të shkruara qartë dhe të lexueshme në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik ose në gjuhë të tjera dhe me shenja që mund të kuptohen lehtë nga konsumatori (neni 22 paragrafi 5).

5.53. Ligji i Bankave [62]

Neni 32 - Raportet financiare dhe dokumentacionin tjetër për punë nëpërmjet filialit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, banka nga vendi - anëtar i BE-së i udhëheq në gjuhën maqedonase dhe i ruan në mënyrë të centralizuar në filialin e parë të hapur në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Evidenca e kontabilitetit

Neni 49 - Banka e huaj mban evidencën e kontabilitetit, raportet financiare dhe dokumentacionin e tjetër për punën e filialit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në gjuhën maqedonase.

5.54. Ligji i Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Materien Penale [63]

Gjuhët në përdorim

Neni 15, paragrafi (1) - Organi vendor kompetent dorëzon lutje ose kërkesë me dokumentacionin në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, me përkthim në gjuhën e shtetit përkatës ose në njërën nga gjuhët zyrtare që përdoren në Këshillin e Europës ose siç parashihet me marrëveshje ndërkombëtare.

---

[62] Ligji i Bankave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/2007, 90/2009, 67/2010, 26/2013, 15/2015, 153/2015, 190/2016 dhe 7/2019 dhe (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 101/2019 dhe 122/2021).

[63] Ligji i Bashkëpunimit Ndërkombëtar në Materien Penale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 77/2021).

Neni 15, paragrafi (2) - Lutjen ose kërkesën me dokumentacionin e dorëzuar nga organi i huaj kompetent, ministria e dorëzon pranë organit kompetent gjyqësor në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, përveç nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj.

Gjuha

Neni 49, paragrafi (1) - Në rastin kur Republika e Maqedonisë së Veriut kërkon ekstradim, organi vendor gjyqësor, kërkesën e ekstradimit dhe dokumentet e parapara në nenin 57 të këtij ligji, pranë ministrisë e dorëzon në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik me përkthim në gjuhën e shtetit prej ku kërkohet ekstradimi ose në njërën nga gjuhët zyrtare të Këshillit të Europës.

Neni 49, paragrafi (2) - Në rastin kur ekstradim kërkon një shtet i huaj nga Republika e Maqedonisë së Veriut, dokumentet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, ministria pranë gjykatës kompetente i dorëzon në gjuhën e shtetit të huaj me përkthim të verifikuar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Dokumentet e kërkesës për ekstradim

Neni 57, paragrafi (2) - Kërkesën e ekstradimit, ministria e dorëzon pranë organit kompetent vendor gjyqësor, me përkthim në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

5.55. Ligji i Letërnjoftimit [64]

Neni 5, paragrafi (3) - Formulari i letërnjoftimit shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën angleze dhe në alfabetin e saj.

Neni 5, p aragrafi (4) - Të dhënat në formularin e letërnjoftimit shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në alfabetin elementar latin (ICAO Doc 9303).

Neni 5, paragrafi (5)- Për qytetarët që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, formulari në letërnjoftim shtypet dhe të dhënat në të shkruhen në gjuhën zyrtare dhe alfabetin e përdorur nga qytetari.

Neni 5, paragrafi (6) - Qytetarëve që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha zyrtare, me kërkesën e tyre personale, të dhënat për emrin personal që shënohen në letërnjoftim u shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e përdorur nga qytetari.

Neni 5, paragrafi (7) - Në formularin e letërnjoftimit, shenjat (kodet) ndërkombëtare shkruhen në pajtim me standardet ndërkombëtare të përcaktuara në ICAO Doc 9303.

[64] Ligji i Letërnjoftimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 8/1995, 38/2002, 16/2004, 12/2005, 19/2007, 10/2010, 51/2011, 13/2012, 166/2012, 154/2015 dhe 55/2016).

5.56. Ligji i Regjistrimit të Bujqësisë në Republikën e Maqedonisë, viti 2006 [65]

Neni 20, paragrafi (2),- Gjatë përzgjedhjes së instruktorëve rajonalë dhe të regjistruesve do të mbahet llogari për strukturën sociale dhe nacionale të popullatës që regjistrohet, për besimin që instruktori i përzgjedhur rajonal dhe regjistruesi do ta kishte te popullata vendore, mundësia e tij për komunikim me personin që regjistrohet dhe për njohjen e gjuhës amtare në të cilën flet popullata vendore.

Përdorimi i gjuhës gjatë regjistrimit

Neni 24, paragrafi (1) - Regjistruesi obligohet t'i njoftojë personat që regjistrohen se kanë të drejtë të zgjedhin regjistrimin në gjuhën zyrtare maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik ose në një gjuhë tjetër zyrtare dhe në alfabetin e saj të cilin e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në gjuhën zyrtare maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin që, gjithashtu është zyrtar, që e përdorin së paku 20% e qytetarëve të njësive të vetëqeverisjes lokale, si dhe në gjuhën zyrtare maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e komunitetit të cilit i përkasin regjistruesit (turke, vllahe, serbe, rome dhe boshnjake).

Neni 24, paragrafi (2) - Regjistrimi bëhet në gjuhën zyrtare maqedonase dhe në alfabetin e saj.

Neni 24, paragrafi (3) - Në rastet kur regjistrimi bëhet në gjuhën zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së

[65] Ligji i Regjistrimit të Bujqësisë në Republikën e Maqedonisë, viti 2006 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 39/2006 dhe 113/2006).

Maqedonisë, formulari duhet të plotësohet në atë gjuhë dhe në atë alfabet, si dhe në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 24, paragrafi (4) - Në rastet kur regjistrimi bëhet në gjuhën turke, vllahe, serbe, rome dhe boshnjake, formulari duhet të plotësohet në gjuhën dhe në alfabetin që e zgjedh personi që regjistrohet, si dhe në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 24, paragrafi (5) - Formularët shtypen në gjuhën zyrtare maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, në gjuhën dhe në alfabetin që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik; si dhe në gjuhët dhe alfabetin turk, vllah, serb, rom dhe boshnjak dhe në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

5.57. Ligji i Regjistrimit të Popullatës, të Amvisërive dhe të Banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut[66]

Përdorimi i gjuhëve gjatë regjistrimit

Neni 34, paragrafi (2) - Regjistrimi bëhet në gjuhën që e zgjedh personi që regjistrohet ose personi që i jep të dhënat.

[66] Ligji i Regjistrimit të Popullatës, të Amvisërive dhe të Banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.19/2021 dhe 74/2021).

5.58. Ligji i Duhanit, i Produkteve të Duhanit dhe i Produkteve të Ngjashme[67]

Neni 57, paragrafi (1) - Në paketimin njësh dhe që ka qenë paketim i jashtëm i pjesës së harxhuar nga produkti i padjegur i duhanit, në anën e përparme vendoset njoftimi shëndetësor: "Ky produkt i duhanit është i dëmshëm për shëndetin dhe paraqet rrezik".

Neni 54, paragrafi (2) - pika ç) – Paralajmërimi, sipas paragrafit (1) të këtij neni, është: përveç në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik mund të shkruhen edhe në gjuhën tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj, varësisht nga vlerësimi i prodhuesit ose i importuesit.

Neni 63, paragrafi (1) - Në paketimin e konsumatorit dhe në çdo paketim të jashtëm të cigareve elektronike dhe të kontejnerëve për mbushje për disa herë vendoset njoftimi shëndetësor: "Ky produkt përmban nikotinë që çon drejt varësisë më të madhe. Nuk rekomandohet për lënien e duhanit".

Neni 63 paragrafi (2) pikat a) dhe b)- Paralajmërimi shëndetësor sipas paragrafit 1 të këtij neni rregullohet me nenin 73 paragrafi 10 të këtij ligji, ku teksti i paralajmërimit duhet të: paraqitet në dy sipërfaqet më të mëdha të paketimit njësh dhe çfarëdo paketimi të jashtëm dhe të mbulojë 30% të sipërfaqes së paketimit njësh dhe çfarëdo paketimi të jashtëm.

Neni 63 paragrafi (3)- Përqindja sipas paragrafit 2 pika b) të këtij neni mund të rritet në 32% nëse informacionet nga ky nen përveç

[67] Ligji i Duhanit, i Produkteve të Duhanit dhe i Produkteve të Ngjashme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.98/2019, 27/2020 dhe 56/2021).

në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik mund të shkruhen edhe në gjuhë tjetër, që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, varësisht nga vlerësimi i prodhuesit ose importuesit.

Neni 64 paragrafi (1)- Në paketimin njësh dhe grupor me produkt bimor për konsumim vendoset njoftimi shëndetësor: "Pirja e këtij produkti dëmton shëndetin tuaj".

Neni 64 paragrafi (2)- Teksti i njoftimit shëndetësor sipas paragrafit 1 të këtij neni duhet të:

a) të shfaqet si në sipërfaqen e përparme ashtu edhe në atë të prapme dhe ne çdo paketim grupor:
b) të përfshijë 30% nga sipërfaqja e secilës nga këto sipërfaqe, duke llogaritur sipërfaqen kur paketimi është i mbyllur;
c) të ketë fontin helvetika të zezë, i trashë me prapavijë të bardhë;
ç) madhësia e fontit të garantoj se teksti zë pjesën më të madhe të mundshme të sipërfaqes së rezervuar për të dhe
d) të paraqitet në qendër të sipërfaqes.

Neni 64 paragrafi (5) - Nëse të dhënat sipas paragrafit 2 të këtij neni, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, mund të shkruhen edhe në gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, varësisht nga vlerësimi i prodhuesit ose importuesit, ndërsa njoftimi shëndetësor duhet të mbulojë 32% të sipërfaqes përkatëse të paketimit njësh dhe të çdo paketimi të jashtëm.

<u>Njoftimet dhe mesazhet informative të produkteve të duhanit që dedikohen për pirje</u>

Neni 71 paragrafi (14) pika c)- Njoftimi i përgjithshëm dhe mesazhi informativ nga ky nen janë: njoftimi i përgjithshëm dhe mesazhi informativ përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik mund të shkruhet edhe në gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e

qytetarëve dhe alfabetin e saj, varësisht nga vlerësimi i prodhuesit ose importuesit.

Neni 72 paragrafi (2)- Mesazhi nga njoftimi i kombinuar i përfshirë në fotografi pozicionohet në anën e pasme të paketimit duke mbuluar sipërfaqe prej të paktën 40% të paketimit njësh të produktit të duhanit në të cilën janë vendosur/shtypur, duke përfshirë kornizën që nuk mund të jetë më e vogël se 3 mm e as më e madhe se 4 mm.

Neni 72 paragrafi (3)- Nëse të dhënat sipas paragrafit 2 të këtij neni janë të shkruara, përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik mund të shkruhen edhe në gjuhën tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, njoftimi i kombinuar përfshin të paktën 45% në anën e pasme të sipërfaqes përkatëse të paketimit njësh të produktit të duhanit në të cilin është vendosur.

Neni 73 paragrafi (1)- Produktet e duhanit për pirje, përveç cigareve, duhanit për cigare vetë-mbështjellëse dhe duhanit për pirjen e duhanit me llulle uji, përmbajnë njoftim të përgjithshëm dhe tekstual për shëndetin, që duhet të vendoset në sipërfaqen më të dukshme të paketimit njësh dhe në çdo paketim të jashtëm.

Neni 73 paragrafi (8)- Kur njoftimet shëndetësore sipas paragrafit 1 të këtij neni paraqiten në sipërfaqe më të madhe se 150 cm2, paralajmërimi duhet të përfshijë sipërfaqe prej 45 cm2.

Neni 73 paragrafi (9)- Sipërfaqja sipas paragrafit 8 të këtij neni rritet në 48 cm2, nëse përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë të shkruara në gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 73 paragrafi (9) pika ç)- Njoftimi i përgjithshëm dhe tekstual për shëndetin sipas paragrafit 1 të këtij neni përveç në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik mund të shkruhen edhe në ndonjë gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe

alfabetin e saj, varësisht nga vlerësimi i prodhuesit ose importuesit.

5.59. Ligji i Referendum dhe Format e Tjera të Deklarimit të Drejtpërdrejtë të Qytetarëve[68]

Neni 16 paragrafi (1)- Fletëvotimi i referendumit në nivel të shtetit shtypet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin cirilik.

Neni 16 paragrafi (2)- Në komunat dhe qytetin e Shkupit ku përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, në përdorim zyrtar është edhe ndonjë gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, fletëvotimi shtypet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që është në përdorim zyrtar në atë komunë dhe Qytetin e Shkupit.

Neni 17 paragrafi (2)- Në komunat, Qytetin e Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit ku përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik në përdorim zyrtar është edhe ndonjë gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, fletëvotimi shtypet në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën dhe alfabetin zyrtar që është në përdorim zyrtar në atë komunë, Qytetin e Shkupit dhe komunat në qytetin e Shkupit.

Neni 70 paragrafi (1)- Nënshkrimet e qytetarëve për nismën civile në nivel shtetëror lëshohen në formular para organit të administratës shtetërore, përgjegjës për regjistrimin e të drejtës së votimit, brenda orarit të punës.

[68] Ligji i Referendumit dhe Formave të Tjera të Deklarimit të Drejtpërdrejtë të Qytetarëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 81/2005).

Neni 70, paragrafi (2) – Formulari, sipas paragrafit (1) të këtij neni, përmban propozimin për të cilin mblidhen nënshkrimet e qytetarëve dhe të dhënat për numrin rendor, emrin dhe mbiemrin, numrin e vetëm të amzës së qytetarit dhe hapësirën për nënshkrimin e qytetarëve.

Neni 70, paragrafi (5) - Në komunat dhe në qytetin e Shkupit në të cilat, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, në përdorim zyrtar është edhe ndonjë gjuhë tjetër zyrtare dhe alfabeti i saj, formulari, sipas paragrafit (2) të këtij neni, shtypet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën zyrtare dhe në alfabetin që është në përdorim zyrtar në atë komunë dhe në Qytetin e Shkupit.

5.60. Ligji i Muzeve[69]

Evidenca dhe dokumentacioni i muzeut

Neni 20, paragrafi (3) - Muzetë lokale në njësitë e vetëqeverisjes lokale në rajonin e së cilës janë themeluar dhe ku, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetin cirilik, gjuhë zyrtare është edhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, libri hyrës dhe katalogu i gjësendeve të muzeut i mbajnë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut në rajonin e asaj njësie të vetëqeverisjes lokale.

[69] Ligji i Muzeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/2004, 89/2008, 116/2010, 51/2011, 88/2015, 152/2015 dhe 39/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2021).

5.61. Ligji i të Huajve[70]

Ankesa

Neni 18, paragrafi (1) - Kundër vendimit për refuzim të hyrjes, sipas nenit 17, paragrafi (3) të këtij ligji, i huaji ka të drejtë ankese që parashtrohet në formë të shkruar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, në afat prej tetë ditëve nga pranimi i vendimit në Komisionin Shtetëror të Vendimmarrjes në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Punësimit në Shkallë të Dytë, duke paguar taksë administrative të përcaktuar me ligj.

Ankesa sipas vendimit për refuzim të kërkesës për dhënien e vizës

Neni 39, paragrafi (1) - Kundër vendimit për refuzim të kërkesës për vizë, i huaji ka të drejtë ankese në afat prej tetë ditësh nga pranimi i vendimit në Komisionin Shtetëror të Vendimmarrjes në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Punësimit në Shkallë të Dytë.

Neni 39, paragrafi (2) - Ankesa kundër vendimit, sipas paragrafit (1), parashtrohet me shkrim në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik te Komisioni Shtetëror i Vendimmarrjes në Procedurë Administrative dhe në Procedurë të Punësimit në Shkallë të Dytë, në afat prej tetë ditëve nga marrja e vendimit, duke paguar taksë administrative të përcaktuar me ligj.

[70] Ligji i të Huajve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 97/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 108/2019 dhe 294/2021).

Ndarja e akreditimit

Neni 63, paragrafi (1), nënparagrafi 1-3 – Akreditimin, sipas nenit 62[71] të këtij ligji, e ndan Ministria e Jashtme, në afat prej 30 ditëve nga dorëzimi i kërkesës së akreditimit, ndërkaq në bazë të kontrollit të kryer i:- statusit aktual të ndërmjetësit tregtarë (licencë, regjistri tregtar, kontrata me bankat),

- marrëveshje ekzistuese me partnerët tregtarë të themeluara në Republikën e Maqedonisë së Veriut që ofrojmë shërbime akomodimi dhe organizojnë prenotime turistike dhe

- marrëveshje ekzistuese me kompani transporti që përfshijnë transport të organizuar deri në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe kthimin e të huajve në vendin prej ku janë bartur.

Neni 63, paragrafi (4) – Akreditimi, sipas paragrafit (1) të këtij neni, lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën angleze dhe përmban të dhëna për: ndërmjetësin tregtar të cilit i është dhënë akreditimi, përfaqësinë diplomatike-konsullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut në të cilin ndërmjetësi tregtar do të dorëzojë aplikacionet e paraqitura për viza, përfaqësuesi i ndërmjetësuesit tregtar i autorizuar për paraqitjen e kërkesave për viza, kohëzgjatja e akreditimit, nënshkrimi dhe vula e Ministrisë së Jashtme.

[71] Bashkëpunimi me ndërmjetësit tregtarë realizohet në bazë të akreditimit të ndarë nga Ministria e Jashtme për grumbullimin e kërkesave të vizave për qëllime turistike.

5.62. Ligji i Standardizimit[72]

Standardet e Maqedonisë

Neni 22, paragrafi (3) - Miratimi i ndonjë standardi ndërkombëtar, europian ose ndonjë standardi tjetër të huaj nacional si standard i Maqedonisë, mund të bëhet duke e përkthyer në gjuhën maqedonase në tërësi ose vetëm faqen e parë, ose duke e miratuar standardin në tërësi në ndonjë gjuhë të huaj.

Neni 22, paragrafi (4) - Marrja e standardeve të huaja në standardet nacionale mund të bëhet me përkthim në gjuhën maqedonase në tërësi ose vetëm faqen e parë, ose me marrje të plotë të standardit të huaj në gjuhë të huaj.

5.63. Ligji i Standardit të Studentëve[73]

Dokumentacioni dhe evidenca

Neni 31, paragrafi (5) - Libri kryesor në konviktet studentore mbahet dhe botohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 31, paragrafi (6) - Për nxënësit e komuniteteve që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, dosja mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si

[72] Ligji i Standardizimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 54/2002, 84/2012, 23/2013, 41/2014, 53/2016 dhe 83/2018).

[73] Ligji i Standardit të Studentëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 15/2013, 30/2013, 120/2013, 41/2014, 146/2015, 30/2016, 178/2016, 64/2018 dhe 20/2019 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 124/2019, 248/2020 dhe 302/2020).

dhe në gjuhën dhe në alfabetin që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

5.64. Ligji i Standardit të Nxënësve[74]

Neni 4, paragrafi (1) - Veprimtaria edukative-arsimore në konviktin e nxënësve kryhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 4, paragrafi (2) - Për pjesëtarët e komuniteteve që e ndjekin punën edukative-arsimore në gjuhë tjetër nga maqedonishtja dhe në alfabeti e saj cirilik, ajo realizohet në gjuhën dhe në alfabetin e komunitetit përkatës sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 23, paragrafi (3) - Pjesëtarët e komuniteteve që e ndjekin punën edukative-arsimore në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, e festojnë ditën tradicionale të arsimimit të komunitetit përkatës me manifestime kulturore dhe të tjera.

Neni 47, paragrafi (1) - Dokumentacioni pedagogjik në konviktet e nxënësve mbahet dhe lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 47, paragrafi (2) - Për pjesëtarët e komuniteteve që e ndjekin punën edukative-arsimore në gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, dokumentacioni pedagogjik mbahet dhe lëshohet

[74] Ligji i Standardit të Nxënësve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 52/2005, 117/2008, 17/2011, 135/2011, 15/2013, 41/2014, 146/2015, 30/2016, 64/2018 dhe 20/2019 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 248/2020 и 302/2020).

në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin zhvillohet puna edukative-arsimore.

Neni 47, paragrafi (5) - Ditari i grupit arsimor mbahet në gjuhën dhe në alfabetin në të cilin kryhet puna edukative-arsimore.

5.65. Ligji i Bankës Popullore i Republikës së Maqedonisë së Veriut[75]

Selia dhe vula

Neni 10, paragrafi (2) - Banka Popullore ka vulën ku qëndron emri i bankës, i shkruar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, si dhe stemën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

[75] Ligji i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë бр. 158/2010, 123/2012, 43/2014, 153/2015, 6/2016 dhe 83/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/2021).

5.66. Ligji i Shoqërive Tregtare[76]

Përdorimi i gjuhës maqedonase dhe i gjuhëve të tjera

Neni 50, paragrafi (1) - Kompania e shoqërisë tregtare shënohet në gjuhën maqedonase, me alfabet cirilik.

Neni 50, paragrafi (2) - Kompania e shoqërisë tregtare me seli në njësinë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% të qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, mund të jetë edhe në atë gjuhë dhe përdoret vetëm bashkë me mbishkrimin e kompanisë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Evidenca e librave tregtarë

Neni 472

(1) Tregtari i udhëheq librat tregtarë në gjuhën maqedonase, me numra arabë dhe me vlerë të shprehur në denarë. Nëse përdor shkurtesa, kode, shenja ose simbole, ai patjetër duhet ta sqarojë qartë domethënien e tyre.

(2) Tregtari me seli në njësinë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, librat tregtarë i udhëheq në gjuhën maqedonase, por mund t'i udhëheqë edhe në atë gjuhë.

[76] Ligji i Shoqërive Tregtare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 28/2004, 84/2005, 25/2007, 87/2008, 42/2010, 48/2010, 24/2011, 166/2012, 70/2013, 119/2013, 120/2013, 187/2013, 38/2014, 41/2014, 138/2014, 88/2015, 192/2015, 6/2016, 30/2016, 61/2016, 64/2018 dhe 120/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 290/2020 dhe 215/2021).

5.67. Ligji i Letrave me Vlerë[77]

Publikimi i ftesës për regjistrim, pagesës dhe prospektit

Neni 18, paragrafi (1) - Lëshuesi obligohet që ftesën për regjistrimin dhe pagesën e letrave me vlerë ta publikojë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik në njërën nga gazetat ditore që botohen në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 ditë para fillimit të regjistrimit të letrave me vlerë.

Neni 18, paragrafi (2) – Ftesa, sipas paragrafit (1) të këtij neni, mund të publikohet në të njëjtën kohë në gazetën ditore e cila botohet në territorin e Republikës së Maqedonisë Veriore në njërën nga gjuhët e komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Njoftimi për epilogun e ofertës publike

Neni 24, paragrafi (3) - Lëshuesi obligohet që më së voni në afat prej 15 ditësh nga përfundimi i ofertës t'i publikojë të dhënat, sipas paragrafit (1) të këtij neni, në njërën nga gazetat ditore në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik. Publikimi i të dhënave mund të bëhet edhe në gazeta ditore që dalin në njërën nga gjuhët e komuniteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

[77] Ligji i Letrave me Vlerë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 95/2005, 25/2007, 7/2008, 57/2010, 135/2011, 13/2013, 188/2013, 43/2014, 15/2015, 154/2015, 192/2015, 23/2016, 83/2018 dhe 83/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 31/2020 dhe 288/2021).

5.68. Ligji i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi[78]

Elementet, gjuha dhe afatet e parashtresës

Neni 24, paragrafi (3) - Dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve zbatohen në procedurë para komisionit. Gjithashtu, gjuha e shenjave mund të përdoret në komunikim të drejtpërdrejtë me komisionin.

Neni 24, paragrafi (4) - Palët që nuk e kuptojnë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik kanë të drejtë për përkthyes.

5.69. Ligji i të Drejtës së Fëmijëve[79]

Parimet themelore

Neni 3, paragrafi (1) - Në procedurën me fëmijët, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik.

Neni 3, paragrafi (2) - Dispozitat e Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale në mënyrë përkatëse zbatohen në procedurën me fëmijë.

[78] Ligji i Parandalimit dhe i Mbrojtjes nga Diskriminimi (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 258/2020).

[79] Ligji i të Drejtës së Fëmijëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 148/2013 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 152/2019 dhe 275/2019).

Neni 3, paragrafi (3) - Fëmija i shtetasit të huaj, të privuar nga liria ose të paraburgosur, parashtresat në procedurë mund t'i paraqesë në gjuhën e tij, e në raste të tjera - në kushte reciprociteti.

Neni 8, paragrafi (1) - Gjykata dhe institucionet e tjera në zbatimin e këtij ligji respektojnë dhe sigurojnë të drejtat e fëmijës pa kurrfarë diskriminimi, pa dallim gjinie, race, të ngjyrës së lëkurës, të përkatësisë në grup të margjinalizuar, të përkatësisë etnike, gjuhësore, të shtetësisë, të origjinës sociale, të fesë ose të besimit, të llojeve të tjera të besimeve, të arsimimit, të përkatësisë politike, të statusit personal ose social, të pengesës mendore dhe fizike, të moshës, të statusit martesor, të gjendjes pronësore, të gjendjes shëndetësore ose të ndonjë baze tjetër të paraparë me ligj ose me marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, prindërve/it, përkatësisht kujdestarëve/it ose anëtarëve të familjes së fëmijës.

Neni 8, paragrafi (2) - Gjykata dhe institucionet e tjera në zbatimin e këtij ligji i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtjen e fëmijës nga të gjitha llojet e diskriminimit, të sanksioneve apo të kufizimeve të tjera të të drejtave, sipas paragrafit (1) të këtij neni.

<u>Mbrojtja e fëmijës si i dëmtuar ose si dëshmitar në procedurë penale</u>

Neni 145, paragrafi (1), nënparagrafi 3 – Fëmija, viktimë e veprës penale, i ka këto të drejta: të njoftohet për të drejtat e tij në gjuhën e kuptueshme dhe përkatëse për moshën e tij, si dhe respektohet e drejta e privatësisë.

5.70. Ligji i Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar i Republikës së Maqedonisë[80]

Gjuha e procedurës

Neni 22, paragrafi (1) - Palët mund të bien dakord për gjuhën ose për gjuhët në të cilat do të zhvillohet procedura e arbitrazhit. Në mungesë të marrëveshjes së këtillë, Gjykata e Arbitrazhit do të vendosë në cilën gjuhë do të zhvillohet procedura, duke marrë parasysh veçanërisht gjuhën ose gjuhët e marrëveshjes kryesore nga e cila paraqitet arbitrazhi. Kjo marrëveshje ose ky vendim, përveç nëse parashihet ndryshe, zbatohet për të gjitha deklaratat me shkrim të palëve, për procedurën me gojë dhe për të gjitha vendimet ose njoftimet e tjera të Gjykatës së Arbitrazhit.

Neni 22, paragrafi (2) - Gjykata e arbitrazhit mund t'i urdhërojë palët që çdo prove me shkrim t'i bashkëngjisin përkthim në gjuhën ose në gjuhët për të cilat palët kanë rënë dakord ose e ka përcaktuar Gjykata e Arbitrazhit.

Neni 22, paragrafi (3) - Deri në momentin e përcaktimit të gjuhës së procedurës, padia, përgjigjja e padisë dhe parashtresat e tjera mund të paraqiten në gjuhën e kontratës kryesore.

Neni 22, paragrafi (4) - Nëse palët nuk merren vesh, e as arbritrat nuk arrijnë ta caktojnë gjuhën e arbitrazhit, gjuha e arbitrazhit do të jetë maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik.

[80] Ligji i Arbitrazhit Ndërkombëtar Tregtar i Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 39/2006).

5.71. Ligji i Vulës së Republikës së Maqedonisë dhe i Vulave të Organeve Shtetërore në Republikën e Maqedonisë[81]

Neni 5, paragrafi (2) - Teksti i vulës shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

5.72. Ligji i Përdorimit të Gjuhës Maqedonase[82]

Neni 2, paragrafi (2) - Përdorimi i gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare është e drejtë dhe detyrë e qytetarëve të Republikës.

Neni 3 - Ky ligj nuk e kufizon të drejtën e krijimit dhe të zhvillimit të lirë të identitetit kulturor, gjuhësor dhe fetar të qytetarëve të Republikës.

Neni 4 - Ky ligj nuk e kufizon të drejtën e pjesëtarëve të nacionaliteteve për përdorimin zyrtar të gjuhës dhe të alfabetit të nacionaliteteve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë dhe me ligjin.

Neni 7, paragrafi (1) - Tekstet zyrtare të pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, të vetëqeverisjes lokale, tekstet shkollore,

---

[81] Ligji i Vulës së Republikës së Maqedonisë dhe Vulave të Organeve Shtetërore në Republikën e Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 86/2008).

[82] Ligji i Përdorimit të Gjuhës Maqedonase (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 5/1998, 89/2008, 116/2010, 187/2013, 152/2015, 192/2015 dhe 193/2017).

emisionet, shtypi, përkthimet dhe tekstet e tjera, sipas nenit 5, paragrafi 1 të këtij ligji, të cilat botohen, duhet të jenë të lekturuara në gjuhën maqedonase.

5.73. Ligji i Përdorimit të Gjuhës së Shenjave[83]

Neni 3, paragrafi (3) - Sipas dispozitave të këtij ligji, personat e shurdhër mund ta realizojnë të drejtën e interpretimit nga gjuha e folur në gjuhën e shenjave, dhe nga gjuha e shenjave në gjuhën e folur.

Të drejtat e personave të shurdhër

Neni 4, paragrafi (1) - Personi i shurdhër ka të drejtën e përdorimit të gjuhës së shenjave si palë ose si pjesëmarrës në procedurat para organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes lokale, organeve gjyqësore, ndërmarrjeve publike, institucioneve, agjencive, fondeve dhe institucioneve e organizatave të tjera.

Neni 4, paragrafi (2) - Personi i shurdhër, krahas të drejtës, sipas paragrafit 1 të këtij neni, ka të drejtën e përdorimit të gjuhës së shenjave edhe për nevoja të tjera jetësore me përzgjedhje personale, nëse shurdhëria paraqet pengesë gjatë përmbushjes së nevojave të tij, por të paktën deri 30 orë në vit.

Neni 4, paragrafi (3) - E drejta, sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij ligji, përmbushet me realizimin e të drejtës së interpretuesit.

[83] Ligji i Përdorimit të Gjuhës së Shenjave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 105/2009, 150/2015 dhe 30/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2021).

Neni 7 - Organet shtetërore, organet e vetëqeverisjes lokale, organet e drejtësisë, ndërmarrjet publike, institucionet, fondet dhe institucionet dhe organizatat e tjera janë të detyruara që personit të shurdhër t'i sigurojnë interpretues me kërkesë të personit të shurdhër ose sipas rrugës zyrtare menjëherë kur personi i tillë paraqet vendim nga qendra e punës sociale, e cila e njeh të drejtën e përdorimit të interpretuesit.

Interpretuesi i gjuhës së shenjave

Neni 11, paragrafi (1) - Interpretues është ai person i cili personit të shurdhër i interpreton nga gjuha e folur maqedonase dhe gjuha e folur e pjesëtarëve të komuniteteve, në gjuhën me shenja, ndërkaq personave që dëgjojnë, u interpreton nga gjuha me shenja në gjuhën e folur maqedonase dhe në gjuhën e folur të pjesëtarëve të komuniteteve.

5.74. Ligji i Kimikateve[84]

Neni 18, paragrafi (3) - Njoftimi për kimikatet e rrezikshme nga produktet që vendosen në qarkullin në tregun vendor, duhet të qëndrojë në etiketën e paketimit, i shkruar në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Lista e sigurisë

Neni 37, paragrafi (1) - Furnizuesi gjatë vendosjes në qarkullim të kimikateve të rrezikshme, kimikate këto të cilat përmbajnë

[84] Ligji i Kimikateve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 145/2010, 53/2011, 164/2013, 116/2015, 149/2015 dhe 37/2016).

substanca të identifikuara si perzistente – bioakulumative - toksike (në tekstin e mëtejmë: PBT) ose shumë perzistente - shumë bioakumulative (në tekstin e mëtejmë: vPvB) dhe kimikate të tjera që kanë veçori nga lista e substancave që shkaktojnë shqetësim, obligohet që t'u dërgojë falas fletë të sigurisë, në formë të shkruar apo elektronike, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, të gjithë shpërndarësve ose shfrytëzuesve të mëtejshëm në zinxhirin e furnizimit.

Neni 37, paragrafi (2) - Eksportuesi obligohet t'i dorëzojë fletë sigurie importuesit, ndërkaq, nëse është e mundshme, fleta e sigurisë të jetë e shkruar në gjuhën e vendit importues.

Dispozitat kundërvajtëse

Neni 142, paragrafi (1), pika 16) - Gjobë në shumë prej 6.000 euro në kundërvlerë denari do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse: nuk dorëzon fletë sigurie gjatë vendosjes në treg të kimikateve të rrezikshme, kimikate të cilat përmbajnë substanca të identifikuara si perzistente - bioakumulative - toksike (PBT) ose shumë perzistente - shumë bioakumulative (vPvB) dhe kimikate të tjera që kanë veti nga lista e substancave që shkaktojnë shqetësim, në formë letre / të shkruar ose elektronike, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, për të gjithë shpërndarësit ose për shfrytëzuesit e mëtejshëm në zinxhirin e furnizimit (neni 37, paragrafi (1)).

5.75. Ligji i Bibliotekave[85]

Evidenca dhe dokumentacioni i fondit të bibliotekës

Neni 21, paragrafi (3) - Bibliotekat lokale në njësitë e vetëqeverisjes lokale në territorin e të cilave janë themeluar dhe në të cilat, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, zyrtare është edhe gjuha dhe alfabeti që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, evidencat dhe katalogu themelor i fondit të bibliotekës mbahen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republika e Maqedonisë së Veriut, në territorin e asaj njësie të vetëqeverisjes lokale.

5.76. Ligji i Ndërtimit[86]

Vërtetimi i harmonizimit të dokumentacionit të projektit (nostrifikimi)

Neni 55, paragrafi (1) - Projektet e bëra sipas rregulloreve të huaja harmonizohen me rregulloren e ndërtimit të Republikës së

[85] Ligji i Bibliotekave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/2004, 89/2008, 116/2010, 51/2011, 88/2015, 152/2015 dhe 39/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 122/2021).

[86] Ligji i Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 130/2009, 124/2010, 18/2011, 36/2011, 54/2011, 13/2012, 144/2012, 25/2013, 79/2013, 137/2013, 163/2013, 27/2014, 28/2014, 42/2014, 115/2014, 149/2014, 187/2014, 44/2015, 129/2015, 129/2015, 217/2015, 226/2015, 30/2016, 31/2016, 39/2016, 71/2016, 132/2016, 35/2018, 64/2018 dhe 168/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 244/2019, 18/2020 dhe 279/2020).

Maqedonisë së Veriut me përcaktimin e harmonizimit të projekteve - nostrifikimit.

Neni 55, paragrafi (2) – Projektet, sipas paragrafit (1) të këtij neni, para se të nostrifikohen, investitori i dorëzon të përkthyera në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhë tjetër zyrtare krahas maqedonishtes, në pajtim me ligjin. Përkthimit i bashkëngjitet teksti origjinal në gjuhën e huaj.

5.77. Ligji i Publikimit të Ligjeve dhe të Dispozitave dhe të Akteve të Tjera në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut[87]

Neni 8, paragrafi (1) - Të gjithat ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe shpalljet e të gjitha organeve të pushtetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjyqësori, prokuroria publike, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë autorizime publike sipas ligjit, si dhe aktet e institucioneve të tjera nga fusha e procesit zgjedhor, arsimi, shkenca, shëndetësia, kultura, veprimtaria e radiodifuzionit, noteriati, përmbarimi, evidenca e amzës, dokumentet personale, financat, ekonomia dhe fushat e

[87] Ligji i Publikimit të Ligjeve dhe Dispozitave e Akteve të Tjera në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 56/1999 dhe 43/2002 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 21/2021).

tjera që publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, publikohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 8, paragrafi (2) - Aktet që publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut lekturohen në pajtim me ligjin.

5.78. Ligji i Përmendoreve Memoriale dhe i Shënimeve[88]

Neni 22 - Regjistrat e shënimeve në komuna, në Qytetin e Shkupit dhe në komunat e qytetit të Shkupit, ku krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, zyrtare është edhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mbahen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në rajonin e këtyre komunave, në Qytetin e Shkupit dhe në komunat e qytetit të Shkupit.

[88] Ligji i Përmendoreve Memoriale dhe i Shënimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 66/2004, 89/2008 dhe 152/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2021).

5.79. Ligji i Fitofarmacisë[89]

Neni 18, paragrafi (6), pika 10) - Për t'i dëshmuar kërkesat për autorizimin e produktit të fitofarmacisë, operatori ekonomik nevojitet t'i dorëzojë këto dokumente kthyese: propozimetiketën në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik, e cila në tërësi përshtatet me dizajnin dhe me përmbajtjen e produktit të fitofarmacisë me regjistrimin e parë për të gjitha madhësitë e aktit të regjistrimit të vendit referues të BE-së, prej ku realizohet autorizimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Plasimi i farës së trajtuar në treg

Neni 24, paragrafi (2) - Deklarata e farërave të trajtuara me produkte të fitofarmacisë, krahas të dhënave të cilat patjetër duhet t'i përmbajë në pajtim me rregullat që e përcaktojnë farën, patjetër deklarata dhe dokumentet e bashkëngjitura të përmbajnë informnacione për emrin e produktit të fitofarmacisë, emrin e substancës aktive me të cilën është trajtuar fara, klasifikimin dhe nënvizimin e produktit të fitofarmacisë në pajtim me rregullat e kimikateve.

Neni 24, paragrafi (3) - Të dhënat, sipas paragrafit (2) të këtij neni, duhet të jenë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Paketimi dhe etiketimi

Neni 34, paragrafi (3) - Çdo paketim i produkteve fitofarmaceutike patjetër duhet të jetë me etiketë. Shenjat e etiketës patjetër duhet të jenë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik në mënyrë të qartë dhe të lexueshme, të cilën e mundëson përmbajtja e shkruar që të mos mund të fshihet apo të largohet.

[89] Ligji i Fitofarmacisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 302/2020).

5.80. Ligji i Armëve[90]

Neni 65, paragrafi (1) - I huaji mund të marrë armë zjarri në Republikën e Maqedonisë në pajtim me kategorizimin e armës, sipas nenit 4 të këtij ligji, në bazë të dokumentit përkatës të vlefshëm për armën, të lëshuar nga organi kompetent i shtetit të personit të huaj.

Neni 65, paragrafi (2) – Dokumenti, sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të përkthehet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e tij cirilik, dhe vërtetësinë e tij ta dëshmojë përfaqësia diplomatike-konsullore e shtetit të personit të huaj në Republikën e Maqedonisë.

5.81. Ligji i Preparateve të Veterinarisë dhe të Mjekësisë[91]

Udhëzimi i përdorimit

Neni 25, paragrafi (2) - Udhëzimi i përdorimit duhet të jetë vetëm për preparatin e veterinarisë dhe të mjekësisë në paketimin e të cilit është vendosur. Udhëzimi duhet të jetë në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

[90] Ligji i Armëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 7/2005, 47/2006, 42/2007, 86/2008, 72/2010, 158/2011, 119/2013, 164/2013, 152/2015, 193/2015, 55/2016 dhe 97/2018).

[91] Ligji i Preparateve të Veterinarisë dhe të Mjekësisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 42/2010, 136/2011, 149/2015, 53/2016 dhe 241/2018).

5.82. Ligji i Përcaktimit të Emrave të Rrugëve, të Shesheve, të Urave dhe të Objekteve të tjera të Infrastrukturës [92]

Neni 7, paragrafi (1) - Emri i rrugës, i sheshit, i urës dhe i objektit tjetër të infrastrukturës shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 7, paragrafi (2) - Në komunën, ku së paku 20% e qytetarëve përdorin gjuhë tjetër zyrtare nga maqedonishtja, emri i rrugës, i sheshit, i urës dhe i objektit tjetër të infrastrukturës, krahas gjuhën maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, shkruhet edhe në gjuhën dhe në alfabetin që e përdorin së paku 20% e qytetarëve në atë komunë.

5.83. Ligji Kushtetues i Zbatimit të Amendamenteve prej XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë[93]

Neni 2, paragrafi (3) - Shtetësia maqedonase/shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut në dokumentet personale dhe në ato të udhëtimit, shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik. Shtetësia maqedonase/shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut në dokumentet personale dhe në ato të udhëtimit të qytetarëve që flasin gjuhën të ndryshme nga maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik, shkruhet në gjuhën maqedonase dhe në

[92] Ligji i Përcaktimit të Emrave të Rrugëve, të Shesheve, të Urave dhe të Objekteve të tjera të Infrastrukturës „ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 66/2004, 55/2007, 145/2010, 136/2011, 163/2013 dhe 147/2015).

[93] Ligji Kushtetues i Zbatimit të Amendamenteve prej XXXIII deri XXXVI të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 6/2019).

alfabetin e saj dhe kjo do të vërtetohet në këtë gjuhë në të gjitha ligjet ku duhet të zbatohet.

5.84. Ligji i Kambialit[94]

Përmbajtja e kambialit

Neni 5, paragrafi (1), pika 1) - Kambiali i trasuar i përmban këto elemente të rëndësishme: shenjën se është kambial, të shtypur në vetë zbrazëtirën e kambialit, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

Neni 8, paragrafi (1), pika 1) - Kambiali individual i përmban këto elemente: shenjën se kambiali është shtypur në vetë zbrazëtirën e kambialit, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

5.85. Ligji i Çekut[95]

Përmbajtja e çekut

Neni 4, paragrafi (1), pika 1) - Çeku i përmban këto elemente të rëndësishme: shenjën se është çek dhe të shtypur në zbrazëtirën e çekut, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik.

[94] Ligji i Kambialit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 3/2002, 67/2010 dhe 145/2015).

[95] Ligji i Çekut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 3/2002, 88/2008 dhe 145/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 122/2021).

5.86. Ligji i Lundrimit të Brendshëm[96]

Neni 52, paragrafi (1) - Dokumentet dhe librat e anijeve mbahen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin cirilik.

Neni 52, paragrafi (2) - Dokumentet dhe librat e anijeve që lëshohen në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare, duhet të kenë përkthim në njërën prej gjuhëve botërore në pajtim me këtë marrëveshje.

5.87. Ligji i Kryerjes së Veprimtarisë Bujqësore[97]

Neni 23, paragrafi (1) – Kompania, në të cilën bujku individual e kryen veprimtarinë bujqësore, është në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, ndërkaq, krahas kësaj, mundet që me përkthim të jetë në gjuhë dhe në alfabet tjetër, por përmbajtja duhet të jetë e njëjtë.

Neni 23, paragrafi (2) - Nëse kompania, në të cilën bujku individual e kryen veprimtarinë bujqësore, krahas gjuhës maqedonase, është edhe në gjuhë dhe në alfabet tjetër, në regjistrin e bujqve regjistrohet edhe në gjuhën dhe në alfabetin tjetër.

---

[96] Ligji i Lundrimit të Brendshëm (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 55/2007, 26/2009, 22/2010, 23/2011, 53/2011, 155/2012, 15/2013, 137/2013, 163/2013, 42/2014, 166/2014, 146/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 64/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 122/2021).

[97] Ligji i Kryerjes së Veprimtarisë Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/2002, 89/2008, 116/2010, 53/2011 dhe 39/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 110/2021).

5.88. Ligji i Veprimtarisë Filmike[98]

Shpërndarja, përkatësisht lëshimi i filmit të huaj në Republikën e Maqedonisë

Neni 42, paragrafi (1) - Filmi i huaj mund të shpërndahet, përkatësisht të lëshohet në Republikën e Maqedonisë nëse është i përkthyer në gjuhën letrare maqedonase në pajtim me ligjin.

5.89. Ligji i Mbrojtjes Ndërkombëtare dhe të Përkohshme[99]

Mënyra e dorëzimit të kërkesës për pranimin e të drejtës së azilit

Neni 28, paragrafi (1) - Kërkesa për pranimin e të drejtës së azilit dorëzohet me shkrim apo gojarisht me procesverbal, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, ose nëse mundet, në gjuhën e vendit të prejardhjes, në njërën nga gjuhët më të pranuara të huaj ose në gjuhën për të cilën mund të supozohet se kërkuesi i të drejtës së azilit e kërkon.

E drejta e interpretuesit

Neni 31, paragrafi (1) - Kur kërkuesi i të drejtës së azilit nuk e kupton gjuhën në procedurë, Sektori i azilit këtij personi do t'i sigurojë interpretues në gjuhën e vendit të prejardhjes ose në gjuhën që e kupton.

---

[98] Ligji i Veprimtarisë Filmike (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2013, 18/2014, 44/2014, 129/2015, 152/2015, 39/2016 dhe 11/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019).

[99] Ligji i Mbrojtjes Ndërkombëtare dhe të Përkohshme (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.64/2018).

Neni 39, paragrafi (8) - Personi i autorizuar zyrtar që e udhëheq bisedën informative me qëllim të realizimit të komunikimit përkatës siguron interpretues. Në rastin kur komunikimi nuk mund të jetë në gjuhën në të cilën dëshiron kërkuesi i të drejtës së azilit, atëherë biseda informative do të zhvillohet në gjuhën për të cilën mund të supozohet se kërkuesi i të drejtës së azilit e kupton dhe mund të komunikojë.

Neni 61, paragrafi (2) - Ministria e Punës dhe e Politikës Sociale për të drejtat, sipas paragrafit (1) të këtij neni, i informon kërkuesit e të drejtës së azilit me shkrim në gjuhën që mund të supozohet se e kuptojnë ose gojarisht me ndihmën e interpretuesit.

Të drejtat e kërkuesit së azilit gjatë kufizimit të lirisë së lëvizjes

Neni 66, paragrafi (1) - Kërkuesi i të drejtës së azilit, të cilit i është shqiptuar masa e kufizimit të lirisë së lëvizjes, ka të drejtë menjëherë të informohet në gjuhën për të cilën mund të supozohet se kërkuesi i të drejtës së azilit e kupton, për të drejtën e padisë dhe të realizimit të së drejtës për ndihmë juridike falas.

Informacionet për të drejtat dhe obligimet

Neni 85 - Sektori i azilit me shkrim, mundësisht në afat sa më të shkurtë, e informon personin nën mbrojtje të përkohshme për të drejtat dhe obligimet e tij, në gjuhën për të cilën mund të supozohet se personi nën mbrojtje të përkohshme e kupton dhe mund të komunikojë.

5.90. Ligji i Ndërmjetësimit[100]

Përdorimi i gjuhës në procedurën e ndërmjetësimit

Neni 15, paragrafi (1) - Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurën e ndërmjetësimit, që flasin gjuhë tjetër të ndryshme nga maqedonishtja dhe në alfabetin e saj cirilik, kanë të drejtë ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në procedurën e ndërmjetësimit.

Neni 15, paragrafi (2) – Pala, sipas paragrafit (1) të këtij neni, dhe pala që është e shurdhër ose që është memec, para fillimit të procedurës së ndërmjetësimit, ka të drejtë të angazhojë përkthyes ose interpretues nga radhët e përkthyesve dhe të interpretuesve të autorizuar që e njohin gjuhën që e përdor pala, dhe për këtë menjëherë ta njoftojë ndërmjetësin ose të kërkojë nga ndërmjetësi të propozojë përkthyes ose interpretues në procedurën e ndërmjetësimit që e njeh dhe e flet gjuhën e palës që ka nevojë për përkthyes ose interpretues.

[100] Ligji i Ndërmjetësimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.294/2021).

5.91. Ligji i Sistemit Njësportelor për Evidencën e Regjistrit Tregtar dhe të Regjistrit të Personave të Tjerë Juridikë[101]

Përmbajtja e paraqitjes së regjistrimit

Neni 33, paragrafi (3) – Regjistri qendror, nëpërmjet sistemit njësporteor mundëson të gjithë parashtruesit e paraqitjeve për regjistrim në regjistrin tregtar, të cilët parashtrimin e kryejnë në mënyrë elektronike jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, të shfrytëzojnë opsionin e mbështetjes gjuhësore të një gjuhe tjetër të vendit anëtar të Bashkimit Europian që i përshtatet mbështetjes maqedonase për aktvendimin e njëjtë.

Punët që kryhen nëpërmjet sistemit njësportelor

Neni 4, paragrafi (6) – Regjistri qendror nëpërmjet sistemit njësportelor siguron shprehjen e të dhënave afariste dhe financiare për subjektet që janë të regjistruara në regjistrat dhe të dhënat e tjera të cilat i disponon, në gjuhën e standardizuar softuerike të pranuar ndërkombëtarisht.

[101] Ligji i Sistemit Njësportelor për Evidencën e Regjistrit Tregtar dhe të Regjistrit të Personave të Tjerë Juridikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 84/2005, 13/2007, 150/2007, 140/2008, 17/2011, 53/2011, 70/2013, 115/2014, 97/2015, 192/2015 dhe 53/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 98/2019, 122/2021 и 215/2021.

5.92. Ligji i Sistemit Hekurudhor[102]

Leja e kryerjes së transportit publik hekurudhor

Neni 15, paragrafi (6) – Leja jepet në gjuhën maqedonase dhe atë angleze.

Leja e menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore

Neni 21, paragrafi (9) - Leja jepet në gjuhën maqedonase dhe atë angleze.

Miratimi i sigurisë së menaxhimit të infrastrukturës hekurudhore

Neni 22, paragrafi (1) – Drejtuesi i infrastrukturës që të mund ta udhëheqë infrastrukturën hekurudhore, krahas lejes, sipas nenit 21 të këtij ligji, patjetër duhet të ketë edhe miratim të sigurisë. Miratimi i sigurisë me kërkesë të plotësuar, në pajtim me udhëzimin e plotësimit të kërkesës, e lëshon drejtoria. Drejtoria udhëheq regjistrin e miratimeve të lëshuara të sigurisë së udhëheqjes së infrastrukturës hekurudhore.

Neni 22, paragrafi (2) – Miratimi i paragrafit (1) të këtij neni lëshohet në gjuhën maqedonase dhe atë angleze.

Neni 23, paragrafi (4) – Udhëzimet e parashtrimit të kërkesës ku janë përshkruar dhe shpjeguar kushtet e lëshimit të certifikatave të sigurisë dhe ku janë theksuar dokumentet të cilat duhet të dorëzohen, vendosen në disponim falas të parashtruesve të kërkesës.

[102] Ligji i Sistemit Hekurudhor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 48/2010, 23/2011, 80/2012, 155/2012, 163/2013, 42/2014, 130/2014, 152/2015, 31/2016, 178/2016 dhe 64/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisës së Veriut nr. 302/2020.

5.93. Ligji i Sigurisë në Sistemin Hekurudhor[103]

Pronësia, gjuha dhe lëshuesit e lejeve dhe të certifikatave

Neni 23, paragrafi (1) – Leja lëshohet në emër të makinistit dhe e lëshon organi i sigurisë.

Neni 23, paragrafi (2) – Leja lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në atë angleze.

Neni 23, paragrafi (3) – Certifikata lëshohet nga transportuesi ose nga drejtuesi i infrastrukturës të cilin e punëson ose e angazhon makinisti. Certifikata është pronësi e transportuesit ose e drejtuesit i cili e ka lëshuar në pajtim me nenin 11, paragrafi (6) të këtij ligji, ndërkaq makinistët kanë të drejtë të marrin kopje të noterizuar.

Neni 23, paragrafi (4) – Certifikata lëshohet në gjuhën maqedonase dhe në atë angleze.

[103] Ligji i Sigurisë së Sistemit Hekurudhor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 48/2010, 23/2011, 53/2011, 158/2011, 137/2013, 163/2013, 42/2014, 166/2014, 147/2015, 193/2015, 31/2016, 52/2016, 63/2016, 71/2016, 35/2018 dhe 64/2018 Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedoniisë së Veriut nr. 22/2020 dhe 178/2021) .

5.94. Ligji i Kontratave të Transportit në Komunikacionin Hekurudhor[104]

Informimi i udhëtarëve për të drejtat e tyre

Neni 25-ç, paragrafi (1) – Gjatë shitjes së biletave të udhëtimit me tren, transportuesi, shitësit e biletave dhe operatorët turistikë i informojnë udhëtarët për të drejtat dhe detyrimet e tyre, në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

Neni 25-ç, paragrafi (2) – Transportuesi në bashkëpunim me drejtuesit e stacioneve përpilon material informues të shkruar me të cilin i informojnë udhëtarët për të drejtat dhe detyrimet e tyre, në pajtim me dispozitat e këtij ligji. Materiali informues duhet të jetë i shkruar në mënyrë të kuptueshme dhe lehtë i lexueshëm në gjuhën maqedonase, si dhe, së paku, në dy gjuhë të huaja dhe i dorëzohet çdo udhëtari.

[104] Ligji i Kontratave të Transportit në Komunikacionin Hekurudhor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 55/2007 dhe 148/2011.

5.95. Ligji i Transportit në Komunikacionin Rrugor[105]

Kushtet e kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor

Neni 4, paragrafi (2) – Licenca e kryerjes së transportit të udhëtarëve ose të mallit në komunikacionin rrugor ndërkombëtar lëshohet edhe në gjuhën angleze.

Neni 4-a, paragrafi (1) – Certifikata e licencës që e lëshon organi kompetent për lëshimin e licencave për çdo automjet të vetëm përmban të dhënat e organit që e lëshon licencën, transportuesin, numrin e vetëm të amzës së subjektit – transportuesit, numrin e licencës dhe afatin e vlefshmërisë, numrin regjistrues, numrin e shasisë dhe llojin e automjetit, llojin e transportit që mund të kryhet me automjetin në pajtim me licencën e lëshuar, datën e lëshimit dhe nënshrimin e vulën e personit të autorizuar.

Neni 4-a, paragrafi (2) – Certifikata e licencës së kryerjes së transportit të udhëtarëve ose të mallit në komunikacionin rrugor ndërkombëtar, sipas paragrafit (1) të këtij neni, lëshohet edhe në gjuhën angleze.

[105] Ligji i Transportit në Komunikacionin Rrugor (Gazeta Zyrtare në Republikën e Maqedonisë nr. 68/2004, 127/2006, 114/2009, 83/2010, 140/2010, 17/2011, 53/2011, 6/2012, 23/2013, 120/2013, 163/2013, 187/2013, 42/2014, 112/2014, 166/2014, 44/2015, 97/2015, 124/2015, 129/2015, 193/2015, 37/2016, 71/2016, 64/2018, 140/2018 dhe 163/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 257/2019.

5.96. Ligji i Transportit të Materieve të Rrezikshme në Komunikacionin Rrugor dhe atë Hekurudhor[106]

Neni 24 – Lista bartëse e transportit të materies së rrezikshme që dërgohet jashtë vendit, patjetër duhet të jetë e shkurar në gjuhën maqedonase dhe në atë angleze, frënge, ruse, gjermane.

5.97. Ligji i Veprimtarisë Botuese[107]

Të dhënat e obligueshme të publikimit

Neni 7, paragrafi (2) – Te publikimet e përkthyera, krahas të dhënave, sipas paragrafit (1) të këtij neni, kur publikimi është përkthim i veprës burimore (origjinale), patjetër duhet të përmbajë titullin dhe gjuhën në të cilën është shkruar publikimi original, ndërkaq, në rastin kur publikimi është përkthim i përkthimit të veprës origjinale, patjeter duhet të përmbajë titullin dhe gjuhën e përkthimit indirekt që është përdorur gjatë përkthimit të veprës origjinale.

[106] Ligji i Transportit të Materieve të Rrezikshme në Komunikacionin Rrugor dhe Hekurudhor (Gazeta Zyrtare e Repbulikës së Maqedonisë nr. 92/2007, 161/2009, 17/2011, 54/2011, 13/2013, 163/2013, 38/2014, 166/2014, 116/2015, 193/2015, 31/2016 dhe 64/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 288/2021)

[107] Ligji i Veprimtarisë Botuese (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/2014 dhe 152/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Repbulikës së Maqedonisë së Veriut nr. 103/2021.

Ekzemplari i obligueshëm

Neni 12, paragrafi (7) – Në rastin kur publikimi është lëshuar veçanërisht disa gjuhë, në alfabete të ndryshme, në disa botime, me faqe kopertine të ndryshuar, me kopertina të reja, me përmbajtje të plotësuar ose të ndryshuar, ekzemplari i obligueshëm dorëzohet për secilën gjuhë, shkrim dhe botim, për çdo shtypje të përsëritur, në pajtim me këtë ligj.

5.98. Ligji i Sigurisë së Përgjithshme të Prodhimeve[108]

Masat e organeve të mbikëqyrjes së tregut

Neni 18, paragrafi (1), pika 2), nënpika 1) – Organet e mbikëqyrjes së tregut gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, përveç masave në pajtim me nenin 9, paragrafët (4), (5) dhe (6), neni 10, paragrafi (3) dhe neni 12, paragrafi (1) të këtij ligji, me aktvendim mund t'i ndërmarrë dhe t'i shqiptojë masat vijuese: Për prodhimin që mund të paraqesë rrezik në kushte të caktuara: të kërkojë të jetë i theksuar me parashikime të përshtatshme, të qarta dhe lehtë të kuptueshme të gjuhës zyrtare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për rreziqet të cilat mund t'i paraqesë.

[108] Ligji i Sigurisë së Përgjithshme të Prodhimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 302/2020).

5.99. Ligji i Sigurimit të Obligueshëm në Komunikacion[109]

Përfaqësuesi i autorizuar i dëmeve

Neni 27, paragrafi (1) – Shoqëritë e sigurimit që kryejnë punë të sigurimit të përgjegjësisë automobilistike janë të detyruara të emërojnë përfaqësues të autorizuar për dëmet në vendet anëtare të Bashkimit Europian (në tekstin e mëtejmë: përfqësuesi i autorizuar i dëmeve).

Neni 27, paragrafi (4) – Përfaqësuesi i autorizuar i dëmeve duhet patjetër të jetë i aftë t'i përpunojë kërkesat e kompensimit të dëmit të gjuhës zyrtare në vendin ku është emëruar.

5.100. Ligji i Ekzemplarit të Obligueshëm[110]

Neni 7 – Në rastin kur publikimi është botuar veçanërisht në disa gjuhë, në alfabete të ndryshme, në disa botime, me faqe kopertine të ndryshuar, në kopertina të reja, me përmbajtje të plotësuar ose të ndryshuar, ekzemplari i obligueshëm dorëzohet për çdo gjuhë, shkrim dhe botim, për çdo shtypje të përsëritur, në pajtim me këtë ligj.

[109] Ligji i Sigurimit të Detyrueshëm në Komunikacion (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 88/2005, 70/2006, 81/2008, 47/2011, 135/2011, 112/2014 dhe 145/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 220/2019).

[110] Ligji i Ekzemplarit të Detyrueshëm (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 11/1994, nr. 92/2008 dhe 47/2011 .

5.101. Ligji i Medieve[111]

Mënyra dhe kushtet e shpalljes së korrigjimit

Neni 19, paragrafi (3), nënparagrafi 6) – Redaktori përgjegjës është i detyruar ta shpallë korrigjimin, përveç kur: korrigjimi është shkruar në gjuhën që nuk është identike me gjuhën në të cilën është shpallur informacioni i kontestueshëm.

5.102. Ligji i Provës [112]

Parimet themelore gjatë kryerjes së punëve provuese

Neni 7, paragrafi (4) – Është i ndaluar çdo diskrimin direkt ose indirekt, thirrje dhe nxitje e diskriminimit dhe ndihmë në veprimin diskriminues në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, llojit, përkatësisë së grupit të margjinalizuar, përkatësisë etnike, gjuhës, shtetësisë, prejardhjes shoqërore, religjionit dhe besimit fetar, llojeve të tjera të besimit, arsimit, përkatësisë politike, statusit personal ose shoqëror, aftësive të veçanta mendore dhe trupore, moshës, gjendjes familjare dhe civile, statusit të pronësisë, gjendjes shëndetësore ose cilësdo qoftë baze tjetër e cila është e paraparë me ligj ose me kontratë të ratifikuar ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë.

[111] Ligji i Medieve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 184/2013 dhe 13/2014)

[112] Ligji i Provës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 226/2015.

5.103. Ligji i Verës[113]

Emërtimi

Neni 51, paragrafi (2) – Përshkrimi dhe emërtimi i verës dhe i prodhimeve të tjera të rrushit të verës bëhet në gjuhën maqedonase.

5.104. Ligji i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve[114]

Neni 2, paragrafi (1), pika 11) – Shprehjet e caktuara të përdorura në këtë ligj kanë kuptimin vijues: "Kompetencat kyç" janë përmbledhje e kompetencave të nivelit të caktuar, të nevojshme për plotësimin e nevojave personale, shoqërore dhe profesionale të individit në procesin e mësimit të përjetshëm. Ekzistojnë tetë kompetenca kyç: komunikimi i gjuhës amtare, komunikimi i gjuhës së huaj, teknologjia informatike, sipërmarrja, mësimi i të mësuarit dhe shprehja kulturore.

[113] Ligji i Verës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 50/2010, 53/2011, 53/2011, 6/2012, 23/2013, 106/2013, 188/2013, 149/2015, 39/2016 dhe 172/2016 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 235/2019.

[114] Ligji i Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 137/2013 dhe 30/2016.

5.105. Ligji i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë [115]

Neni 42, paragrafi (5) – Deputetët të cilët flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, të cilët e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, materialet që i përpilon Instituti Parlamentar, i marrin edhe në gjuhën dhe alfabetin e tyre. Me kërkesë të deputetit, materialet përkthehen edhe në gjuhë të tjera botërore.

5.106. Ligji i Shërbimeve [116]

E drejta e informatave

Neni 7, paragrafi (1), pika 6) – Organet kompetente të Republikës së Maqedonisë janë të detyruara nëpërmjet pikës së vetme të kontaktit të dhënësve dhe të përdoruesve të shërbimeve të sigurojnë informata për: radhitjen e hapave sipas të cilave më së shpeshti kërkesa rishikohet dhe përpunohet në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme sipas mundësisë dhe gjuhës zyrtare të shtetit nga HEE, por jo si këshillë juridike, por në formë të informatës së përgjithshme për hapat në procedurën dhe në mënyrën se si ato më së shpeshti realizohen.

Informatat që dhënësi i shërbimeve duhet t'ua bëjë të qasshme pranuesve të shërbimeve

Neni 20, paragrafi (3), pika 4) – me kërkesë të pranuesit të shërbimit, dhënësit e shërbimeve janë të detyruar që t'i bëjnë të

[115] Ligji i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 104/2009 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 14/2020, 174/2021 dhe 298/2021.

[116] Ligji i Shërbimeve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 98/2019).

qasshme informatat plotësuese në vijim: kodet e sjelljes të cilave u përmbahet dhënësi i shërbimit dhe faqja e internetit në të cilën në mënyrë elektronike janë të qasshme me tregues të gjuhës në të cilën janë të shkruara.

5.107. Ligji i Mbrojtjes së të Drejtave të Pacientëve [117]

Të drejtat e pacientëve

Neni 5, paragrafi (2) – Pacienti ka të drejtën te realizimit të të drejtave të përcaktuara me këtë ligj, pa diskriminim në bazë të racës, të ngjyrës së lëkurës, të prejardhjes, të përkatësisë kombëtare ose etnike, të gjinisë, të llojit, të orientimit seksual, të identitetit të llojit, të përkatësisë së grupit të margjinalizuar, të gjuhës, të shtetësisë, të prejardhjes sociale, të arsimit, të religjionit ose të besimit fetar, të bindjes politike, të bindjes tjetër, të aftësisë së veçantë, të moshës, të gjendjes familjare ose civile (martesore), të statusit të pronësisë, të gjendjes shëndetësore, të veçorisë personale dhe të statusit shoqëror ose të cilësdo baze tjetër.

[117] Ligji i Mbrojtjtes së Pacientëve (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2008, 12/2009, 53/2011 dhe 150/2015 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 190/2019 dhe 122/2021).

5.108. Ligji i Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Maqedonisë dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Ndjekjes së Personave Përgjegjës për Shkeljet Serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ish-Jugosllavisë[118]

Neni 15, paragrafi (1) – Personi, i cili është në paraburgim ose është i privuar nga liria, patjetër duhet të informohet menjëherë në gjuhën e tij ose në gjuhën e cila për të do të jetë e kuptueshme, në pajtim me dispozitat e Ligjit të Procedurës Penale, për arsyet e paraburgimit të tij ose të privimit nga liria. Personi patjetër duhet të informohet se nuk është i detyruar të japë deklaratë që ka të drejtën e mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij dhe organet kompetente janë të detyruar ta njoftojnë familjen e tij.

5.109. Ligji i Shëndetësisë Veterinare [119]

Besueshmëria e certifikatës

Neni 47, paragrafi (4) – Certifikata përpunohet në gjuhën maqedonase, në gjuhën angleze dhe, sipas nevojës, në njërën nga gjuhët zyrtare në vendin e destinacionit përfundimtar.

[118] Ligji i Bashkëpunimit mes Republikës së Maqedonisë dhe Gjykatës Penale Ndërkombëtare e Ndjekjes së Personave Përgjegjës të Shkeljeve Serioze të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e Ish-Jugosllavisë.

[119] Ligji i Shëndetësisë Veterinare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 113/2007, 24/2011, 136/2011, 123/2012, 154/2015 dhe 53/2016 .

5.110. Ligji i Cilësisë së Prodhimeve Bujqësore[120]

(Standardi i përgjithshëm i tregut)

Neni 38

(1) Standardi i përgjithshëm i tregut të frutave dhe të perimeve të freskëta i përmban karakteristikat vijuese: nënparagrafi 4) – treguesi i prejardhjes.

5) Treguesi i prejardhjes, sipas paragrafit (1), nënparagrafi 4) të këtij neni, është emri i plotë i vendit të prejardhjes, i shkruar në gjuhën e kuptueshme të harxhuesve përfundimtarë.

(Certifikimi i prodhimit)

Neni 146

(1) Prodhimi bujqësor ose ushqimor merr shenjën e specialitetit tradicional të garantuar në bazë të specifikimit të përpunuar të prodhimit (në tekstin e mëtejmë: specifikimi).

(2) Specifikimi, sipas paragrafit (1) të këtij neni, veçanërisht përmban: titullin e nenit 143, paragrafi (2) të këtij ligji, i cili patjetër duhet të jetë në gjuhën maqedonase dhe, me kërkesë, edhe në gjuhë tjetër.

[120] Ligji i Cilësisë së Prodhimeve Bujqësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 140/2010, 53/2011, 55/2012, 106/2013, 116/2015, 149/2015, 193/2015 dhe 39/2016.

5.111. Ligji i Prodhimeve të Ndërtimit[121]

Dorëzimi i deklaratës së veçorive

Neni 10, paragrafi (7) – Deklarata e veçorive me udhëzimet teknike përpilohet në gjuhën maqedonase.

Detyrimet e prodhuesit

Neni 15, paragrafi (8) – Kur prodhuesi e lëshon prodhimin në treg, është i detyruar të sigurojë deklaratën e veçorive dhe udhëzimin teknik të cilat e përmbajnë prodhimin, të shkruara në gjuhën maqedonase.

Detyrimet e importuesit

Neni 17, paragrafi (2), nënparagrafi 6) – Para se prodhimin e ndërtimit ta lëshojnë në treg, importuesit duhet të sigurojnë se: deklarata e veçorive dhe udhëzimi teknik janë të shkruara në gjuhën maqedonase.

Detyrimet e shpërndarësit

Neni 1, paragrafi (8), nënparagrafi 1) – Shpërndarësi, me kërkesë të organit kompetent të mbikëqyrjes së tregut: i siguron të gjitha të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për vërtetimin e përshtatshmërisë së prodhimit ndërtimor, me deklaratën e veçorive dhe në pajtim me kërkesat e tjera të këtij ligji, në gjuhën maqedonase.

[121] Ligji i Prodhimeve të Ndërtimit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 104/2015, 192/2015, 53/2016 dhe 120/2018 .

5.112. Ligji i Procedurës së Tatimit[122]

Gjuha zyrtare

Neni 40, paragrafi (1) – Gjuha zyrtare e cila përdoret në procedurën e tatimit është e rregulluar në pajtim me nenet 19 dhe 61 të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative.

Neni 40, paragrafi (2) – Nëse tatimpaguesi para Drejtorisë së të Hyrave Publike dorëzon dokument në gjuhë dhe në alfabet të huaj, Drejtoria e të Hyrave Publike mund të kërkojë që tatimpaguesi të dorëzojë përkthim të noterizuar të dokumentit në gjuhën zyrtare, i theksuar në paragrafin (1) të këtij neni. Nëse tatimpaguesi nuk dorëzon përkthim të noterizuar të dokumentit, Drejtoria e të Hyrave Publike mund ta përkthejë dokumentin me shpenzimet e tatimpaguesit ose të mos e pranojë dokumentin si dëshmi.

Regjistrimi dhe evidentimet e tjera

Neni 47, paragrafi (40) – Librat afaristë dhe evidentimet e tjera patjetër duhet t'i bashkëngjiten në gjuhën zyrtare.

Neni 47, paragrafi (5) – Drejtoria e të Hyrave Publike mund të lejojë përjashtime sipas paragrafit (4) të këtij neni.

[122] Ligji i Procedurës Tatimore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 13/2006, 88/2008, 159/2008, 105/2009, 133/2009, 145/2010, 171/2010, 53/2011, 39/2012, 84/2012, 187/2013, 15/2015, 97/2015, 129/2015, 154/2015, 23/2016 dhe 35/2018 dhe Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 275/2019 и 290/2020.

5.113. Ligji i Furnizimeve Publike në Fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë [123]

Kompetenca dhe evidentimi

